

NDIKIMI I MEDIAS NË NDRYSHIMIN SOCIO - EKONOMIK NË KOSOVË

By Zenel Hajrizi



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i shkencave shoqërore bashkëkohore

Tema e Disertacionit të Doktoratës

NDIKIMI I MEDIAZ NË NDRYSHIMIN SOCIO - EKONOMIK NË KOSOVË

Kandidati:

Mr: Zenel Hajrizi

Mentori:

Prof. Dr. Agron Rustemi

Tetovë 2022

Prindërve të mi, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi ta !

DEKLARATA E AUTORËSISË

Përmes kësaj deklarate dëshmoj dhe pajtohem që ti bartë “ Universitetit të Evropës Juglindore ” në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut që punimin e doktoratës të mentoruar nga Prof. Asoc. Agron Rustemi mund ta vënë në dispozicion të studentëve dhe hulumtuesve shkencor për qëllime edukative - arsimore dhe shkencore. Ndërsa çdo pjesë e marrë nga autorë tjerë është e cituar në mënyrë të përpiktë.

Zenel Hajrizi



Deklarata e Lektorit

Unë, Melihate Zeqiri, profesor i lëndës: Gjuhë shqipe, dëshmoj se kam lekturuar temën “**NDIKIMI I MEDIAS NË NDRYSHIMIN SOCIO-EKONOMIK NË KOSOVË**”, të kandidatit **Mr. Zenel Hajrizi**, për diplomim në nivelin e ciklit të tretë – **Studimet e Doktoratës, pranë UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE.**

Table of Contents

Abstrakt	9
Abstract	10
Апстракт.....	11
Hyrje.....	12
Kapitulli I	17
1.1 HIPOTEZA KYESORE	17
1.2 HIPOTEZA NDIHMËSE.....	17
1.3 PËRCAKTIMI I PYETJEVE KËRKIMORE	17
1.4. SHQYRTIMI I LITERATURËS	18
1.5 QASJA KËRKIMORE	21
1.6 METODOLOGJIA E KËRKIMIT EMPIRIK	22
1.7 MBLEDHJA E TË DHËNAVE	23
Kapitulli II	24
2.1. METODOLOGJIJA	24
Kapitulli III	27
3.1 POLITIKAT SHËNDETËSORE	27
3.2. POLITIKAT E BANIMIT	33
3.3. POLITIKAT NË ARSIM DHE EDUKIM.....	36
3.4. POLITIKATA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	40
3.5. POLITIKAT BUJQESORE	42
3.6. POLITIKAT MJEDISORE	47
3.7. POLITIKAT E INTEGRIMIT DHE POPULLIMIT	50
3.8. POLITIKAT E MIGRIMIT	53
3.9. PROKURIMI PUBLIK	56
3.10. BUXHETI I VITIT 2018.....	59
3.11. BUXHETI I VITIT 2019.....	60
3.12. BUXHETI I VITIT 2020.....	62
3.13. BUXHETI I VITIT 2021.....	63
3.14. BUXHETI I VITIT 2022.....	64
3.15. FONDET IPA.....	66

Kapitulli IV.....	68
4.1. NOCIONI MBI POLITIKAT SOCIALE.....	68
4.2. NOCIONI MBI POLITIKAT EKONOMIKE	72
4.3. NOCIONI MBI MEDIAT	73
4.4. ROLI I MEDIAVE.....	74
4.5.SUBVENCIONET EKONOMIKE DHE SOCIALE	76
4.6. TRAJTIMI I DUKURIVE SOCIO - EKONOMIKE NË MEDIA	78
4.7. MEDIUMI PUBLIK	80
4.8. MEDIAT KOMERCIALE	83
4.9.MEDIAT SOCIALE DHE NDRYSHIMI SOCIO - EKONOMIK	86
Kapitulli V.....	93
5.1. Rastet Studimore	95
5.1.1. Studime të rastit: Përbledhje	95
5.1.1.1. Rasti studimor 1	100
Klubi “ Dëshira “, Prishtinë.....	100
5.1.1.2. Rasti studimor 2	104
SHHB “ Nëna Terezë “, Prishtinë	104
5.1.1.3. Rasti studimor 3	108
“ Organizata Komunale e Pensionistëve ”, Prishtinë	108
5.1.1.4. Rasti studimor 4	110
OJQ “ Kultura Multietnike në Kosovë ”, Fushë Kosovë	110
5.1.1.5. Rasti studimor 5	113
OJQ “ Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar i Kosovës ”, Prishtinë	113
5.1.1.6. Rasti studimor 6	115
OJQ “ Kushaveci “ Schliren, Zvicër	115
5.1.1.7. Rasti studimor 7	118
OJQ “ Miqësia Franko-Shqiptare ”, Francë	118
5.1.1.8. Rasti studimor 8	122
OJQ “ Qatar Charity “, Qatar	122
5.1.1.9. Rasti studimor 9	125
OJQ “ Lidhja e Invalidëve, Viktimave Civile dhe të Zhdukur në Kosovë ”, Drenas	125
5.1.1.10. Rasti studimor 10	127

Shoqata Kulturor-Sportive “ 17 Shkurti “ Baden, Austri	127
5.1.1.11. Rasti studimor 11	130
Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare, Prishtinë	130
5.1.1.12. Rasti studimor 12	133
SHHB “ Bereqeti “, Prishtinë	133
5.1.1.13. Rasti studimor 13	137
Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Gjilan	137
5.1.1.14. Rasti studimor 14	140
OJQ “ Rrjeti i Grave të Kosovës “, Prishtinë	140
Analiza e të dhënave nga hulumtimi empirik	144
Përfundime	169
REKOMANDIME	170
KONKLUZIONE	173
Tabela 1 Angazhimet e zyrtarëve policor në zbatim të ligjit	29
Tabela 2 Analiza laboratorike janar - mars , 2022 në QMF-1, Prishtinë	30
Tabela 3 Mosha e personave të cilët kanë marrë shërbime në QMF-1,Prishtinë	31
Tabela 4 ⁵⁰ ëma dhe numri i përfituesve të kategorive të komunitetit. (raporti i ASK-ë)	70
Tabela 5 Familjet sipas numrit të anëtarëve që pranojnë ndihma sociale burimi: ASK-ë	71
Tabela 6 Kriteret për zgjedhjen e rasteve të organizimit social në Kosovë.....	94
Tabela 7 Të dhënat për organizatat e hulumtuara	96
Tabela 8 Ndihmat nga SHHBK “ Nenë Tereza “ nga viti 1990 deri 2020 për persona dhe familje.	105
.....	
Tabela 9 Ndihmat e SHHBK “ Nëna Terezë “ në vitet sfiduese.	105
Figura 1 Faza e prokurimit	58
Figura 2Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin institucional me institucionet shtetërore?	148
Figura 3Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin me mediumet ?	149
Figura 4 Sipas jush a keni vërejtur ndryshim nga sferat e bashkëpunimit me mediumet ?	150
Figura 5 Sipas jush a ndikojnë mediat në ndryshim socio - ekonomik ?	151
Figura 6 Sipas jush a ndikojnë mediat në përafrimin e bashkëpunimit mes jush dhe institucioneve shtetërore ?	152
Figura 7 Sipas jush sa janë të pranishme në media aktivitetet e organizatës suaj ?	153

Figura 8 Sipas jush a ndikojnë mediat sociale në medien publike dhe komerciale për sensibilizimin e problemeve me të cilat merreni ?.....	154
Figura 9 A është media urë lidhëse mes subjektit tuaj dhe donatorëve (afaristë dhe persona fizik) ?	155
Figura 10 A është media urë lidhëse mes subjektit tuaj dhe donatorëve (organizatat e huaja dhe të vendit) ?	156
Figura 11 Sa ndikon media në sensibilizimin e opinionit për problemet socio - ekonomike në Kosovë ?.....	157
Figura 12 A mendoni se mediat mund të kontribuojnë edhe më shumë në çështjet socio-ekonomike në Kosovë ?	158
Figura 13 Mediumet elektronike (Radio dhe TV) në Kosovë	161
Figura 14 Lloji i mediumeve Televizive në Kosovë.....	161
Figura 15 Lloji i radiove në Kosovë	162
Figura 16 Gjuha në Mediumet Televizive	163
Figura 17 Gjuha e Mediumeve në Radio.	163
Figura 18 Buxheti i Kosovës për periudhën kohore 2018 – 2022.	168

Abstrakt

Qëllimi i disertacionit është të eksplorojë kontekstin social përmes ndikimit të mediave për ndryshim, i cili çon në zhvillimin e fenomenit social. Identifikimi i proceseve dhe faktorëve që inkurajojnë mediat të kontribuojnë në ndryshimin e zhvillimit socio - ekonomik është i rëndësishëm dhe shërben si një katalizator kundër ngadalësimit të proceseve të zhvillimit.

Studimi fokusohet në ndikimin e medias në promovimin e politikave pro aktive socio -ekonomike të mirëgenies për të gjitha kategoritë sociale dhe transformimin që prek tre sektorët tradicionalë: Publike, private dhe civile.

Të dhënat mbi kërkimin empirik janë mbledhur kryesisht në periudhën nga Qershori 2021 deri në Qershori 2022. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar intervista me përfaqësues të organizatave të përgjedhura për studime të rasteve si dhe me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të përfshira në proceset e politikë bërjes për ndikimin e mediave për ndryshimet socio - ekonomike, në fusha të caktuara të sistemeve mbështetëse.

Duke trajtuar këto fusha që secila lidhet me boshtin e temës, ndikim në ndryshimet socio - ekonomike, ndërkohë që media në këto raste ka një rol vëzhgues për të vlerësuar ecurinë e arritjeve të zhvillimit dhe evidentimin e ndryshimeve socio - ekonomike, ndërsa fokusi është tek ndryshimi si fenomen i evoluimit në shoqëri.

Ndikimi i medias në ndryshimet socio - ekonomike lidhet me statusin dhe gjendjen e medias në të cilën ajo operon dhe ka një rol korrigjues në veprimet e zyrtarëve institucionalë.

Me iniciativë dhe fokus në problemen për reflektim institucional, mediat kosovare kanë një gamë të gjerë të përkushtimit ndaj ndikimit socio - ekonomik, duke filluar nga edicionet informative dhe programet tjera të rregullta dhe speciale për socio - ekonominë.

Fjalët kyçe: *Media, ndryshimi Socio-ekonomik, institucion, OJQ,*

Abstract

The aim of the dissertation is to explore the social context through the influence of media for change, which leads to the development of the social phenomenon. Identifying the processes and factors that encourage the media to contribute to changing socio - economic development is important and serves as a catalyst against the slowdown of development processes.

The study focuses on the impact of the media on promoting pro - active socio - economic welfare policies for all social categories and the transformation affecting the three traditional sectors: Public, private and civil.

Data on empirical research were collected mainly in the period from June 2021 to June 2022. During this period, interviews were organized with representatives of selected organizations for case studies as well as with representatives of institutions and organizations involved in impact policy-making processes. of media for socio-economic change, in certain areas of support systems.

Addressing these areas that each relate to the theme axis, impact on socio-economic change, while the media in these cases has an observational role to assess the progress of development achievements and evidence of socio-economic change, while the focus is on change as a phenomenon of evolution in society.

The impact of the media on socio-economic changes is related to the status and condition of the media in which it operates and has a corrective role in the actions of institutional officials.

With initiative and focus on the problem for institutional reflection, Kosovar media have a wide range of commitment to socio-economic impact, starting from informative editions and other regular and special programs for socio - economics.

Keywords: *Media, Socio-economic change, Institutions, NGOs*

Апстракт

Целта на дисертацијата е да се истражи општествениот контекст преку влијанието на медиумите за промена, што доведува до развој на општествениот феномен. Идентификувањето на процесите и факторите кои ги поттикнуваат медиумите да придонесат за промена на социо-економскиот развој е важно и служи како катализатор против забавувањето на развојните процеси.

Студијата се фокусира на влијанието на медиумите во промовирањето на проактивни социо-економски политики за благосостојба за сите општествени категории и трансформацијата што влијае на трите традиционални сектори: Јавни, приватни и граѓански. Податоците за емпириско истражување главно беа собрани во периодот од јуни 2021 година до јуни 2022 година.

Во овој период беа организирани интервјуа со претставници на организации избрани за студии на случај како и со претставници на институции и организации вклучени во процесите на креирање политики за влијанието на медиумите врз социо-економските промени, во одредени области на системи за поддршка.

Обраќањето на овие области, секоја поврзана со оската на темата, влијанието врз социо-економските промени, додека медиумите во овие случаи имаат набљудувачка улога да го проценат напредокот на развојните достигнувања и доказите за социо-економските промени, додека фокусот е на промените како феномен на еволуција во општеството. Влијанието на медиумите врз социо-економските промени е поврзано со статусот и состојбата на медиумите во кои тие функционираат и има корективна улога во постапувањето на институционалните службеници. Со иницијатива и фокусирање на проблемот за институционална рефлексија, косовските медиуми имаат широк опсег на посветеност на социо-економското влијание, почнувајќи од информативните изданија и другите редовни и специјални програми за социо-економија.

Клучни зборови: *Медиуми, Социо-економски промени, Институции, невладини организации*

Hyrje

Situata bashkëkohore e marrjes hov të zhvillimit global të medias e përcjell me informacione të bollshme mund të konsiderohet si bazë e zhvillimit socio - ekonomik të një vendi, ndërsa informacionet e sakta në kohë dhe të verifikuara si burimi i tyre tregon seriozitetin e një medie e shkruar apo elektronike.

Sikurse e gjithë shoqëria e komuniteteve edhe Kosova në periudha të ndryshme kohore kishte rritën dhe zhvillimin e medias. Nisur nga ky fakt sikurse gjashtë republikat e Jugosllavisë, Krahina Socialiste Autonome (KSA) e Kosovës kishte të drejtën e informimit në gjuhën e popullit shumicë, gjuhën shqipe, ndërsa shqiptarët ishin shumicë në Kosovë që përbënin 90% të popullatës.

Me kushtetutën e atëhershme të Jugosllavisë popullatës shumicë por edhe kombësive tjera i mundësohej informimi në gjuhën amtare. Neni 12 i ligjit për informim i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) rregullonte të drejtën e informimit përmes mjeteve të informimit (Selimi, 2016, f.7).

Pas luftës së dytë botërore Radio Prishtina kishte nisur programin në gjuhën shqipe, ndërsa fillimisht selinë e kishte në Prizren, kurse emetonte dy orë program.¹

Radio Televizioni i Prishtinës (RTP) nisi me punë tridhjetë vjet më vonë përkatësisht më 1974 me aparaturë jo të kënaqshme dhe teknologji jo adekuate.²

Në kohë të globalizmit afarizmi i informacioneve përfiton gjithnjë e më shumë kujdes në mbrojtjen e informacionit “ *Megjithëse rëndësia e mjaftueshme e informacionit në komunikim organizativ është pranuar prej vitesh dhe tema është diskutuar në mënyrë intensive në vitet 1970 dhe 1980, ende sot, organizatat vuajnë nga probleme të pa mjaftueshme të informacionit* “ (Papa, 2008,f.38).

Zhvillimi i teknikës në fund vitet e 80-ta të shekullit të kaluar ndikoi edhe në zhvillimin e bazave multimediale si informacione nga fusha: Grafikë, fotografi, zë, animacion etj.

¹Loshaj, I. (2021). Ingjinier i cili kishte montuar radion për fillim të punës, intervistë autoriale.

²Loshaj, I. (2020). Intervistë autoriale.

Më vonë u paraqitën edhe UEB faqe të internetit në vitet e 90-a të shekullit XX ku industria e informimit arriti ndikim në jetën socio - ekonomike në shoqëri (Balle, 2019, f.79).

Duke ndjek ngjarjet në Kosovë ndalemi tek viti 1989 kur u suprimua Autonomia e Kosovës në vitin 1990, ndërsa Kosova dhe shqiptarët mbetën pa informim në gjuhën shqipe dhe për këtë Radio Televizioni Shqiptar (RTSH-ë) i doli në ndihmë Radio Televizionit të Prishtinës (RTP-ë) që edicionin informativ ta emetojnë përmes valëve të (RTSH-ë), sikurse që u mbështet Radio Prishtina nga Radio Zagrebi të ketë një edicion informativ të lajmeve në gjuhën shqipe.

Kjo nevojë e kohës pati ndryshuar në masë të madhe mediumet dhe ato sa vinin komercionalizohen edhe më shumë, por nuk duhet harruar faktin që “E drejta qytetare për të zgjedhur pre supozonte vlefshmërinë e alternativave (McNair, 2009, f. 30).

Me ndryshimin e situatës politike dhe çlirimin e Kosovës nga regjimi serb fillon edhe ri normalizimi gradual i shoqërisë për themelim të institucioneve sikurse edhe të mediave. Duke u përpjekur për të plotësuar objektivat për të cilat ishte i ngarkuar me rregulloren e UNMIK-ut e ku ndër të tjera thuhej se RTK-ë ka për detyrë “*Tu ofroj të gjitha komuniteteve në Kosovë mundësinë e shprehjes, përmes formimit të zyrës së shërbimeve programore për ti përkrahur komunitet e tilla, duke u kushtuar jo më pak se 15% të skemës programore në RTK-ë dhe duke përfshirë kohën kryesore të lajmeve në gjuhën e komuniteteve, përveç gjuhës së popullatës shumicë në televizion dhe në transmetimet e kombinuara të radio - frekuencave të RTK-ë*” (UNMIK/REG/2001/13).³

Krahas zhvillimit të medias publike, u themeluan edhe media komerciale si radio dhe televizione të ndryshme sikurse edhe përfaqësi të agjencive të huaja në Kosovë duke përfshirë këtu edhe editimin e gazetave ditore, revista etj. që për mision kanë informimin për zhvillim në tregun e medias në Kosovë. Andaj konsiderohen mundësi të punësimit gjë që kërkesat në fillim ishin më të mëdha për tu punësuar në media.

Shoqëria njerëzore ka kaluar në procese të transformimit shoqëror, të cilat në ditët sotme nuk kanë avancuar në krijimin e ekuilibrit socio - ekonomik. Këtë fat e kishte edhe Kosova, ndërsa pas krijimit të rrethanave të reja të pas luftës të vitit 1999 mendohej që do të vjen "Epoka e Artë" e zhvillimit socio - ekonomik me ngritje të mirëqenies sociale përmes zhvillimit ekonomik dhe

³ UNMIK /reg. Rregullore 2001/13 mbi themelin e Radio Televizionit të Kosovës. Neni 1.3.d

fushave tjera, ndërsa pritej rritja e punësimit përmes së cilit proces do të uleshin shifrat e pa punësisë duke kërkuar ndryshimin social dhe zbutjen e varfërisë ekstreme si dhe përjashtimit social.

Në 20 vjetorin e fundit, ndikimi i medias në ndryshimin socio - ekonomik është i dukshëm, ndërsa çdo herë e më shumë kërkohen alternativa për ndryshim në shoqëri komunitete, shkencë, institucionale dhe politikë bërje.

Diskutohet për një domosdoshmëri që tregon potencialin e krijimit të mundësisë për të zgjidhur problemet socio - ekonomike të akumuluara dhe adresimin e nevojave të pa plotësuara dhe mënyrat novatore të lidhjes dhe përdorimit të burimeve ekzistuese për të mirën e përgjithshme publike dhe komerciale në Kosovë.

Mediat elektronike audio - vizuale, sociale shihen si katalizator në vazhdën e transformimit të shoqërisë. Mediat e shkruara me një dinamikë të shpejtë u transformuan në shtypin elektronik. Kosova në ditët e sotme ka mbetur pa asnje shtyp ditor apo revistë periodike e gjithë kjo si pasoj e pandemisë Covid-19 dhe krijimit të situatës socio – ekonomike më të brishtë deri në përmasa globale. Megjithatë i vetmi vend në rajon, pa shtyp ditor është Kosova. Ndërsa që transformimi të jetë i rrënjosishëm, mënyrat e të vepruarit në sferën sociale, nevojitet për të shtruar vizione të reja dhe krijuar një ekuilibër të ri shoqëror (Dees, 1988, f.848).

Për këtë i pakontestueshëm është roli i medias me ndikimin e saj në ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë dhe jo vetëm por gjithandej vendeve demokratike bashkëkohore.

Qëllimi i disertacioni është hulumtimi i kontekstit shoqëror përmes ndikimit të medias për ndryshim që çon në zhvillimin e fenomenit të ndërmarrë sis sociale. Identifikimi i proceseve dhe faktorëve që inkurajojnë median të kontribuoj në ndryshim për zhvillim, është i rëndësishëm dhe shërben si katalizator ndaj proceseve ngadalësuese zhvillimore.

Teza themelore e punimit:” NDIKIMI I MEDIAS NË NDRYSHIMIN SOCIO - EKONOMIK NË KOSOVË “ përqendrohet tek ndikimi i medias në nxitje të politikave pro aktive për mirëgenie socio - ekonomike për të gjitha kategoritë shoqërore dhe transformimit që prekin tre sektorët tradicional: Publik, privat dhe civil.

Në kuptim më të ngushtë, punimi përqendrohet në kontekstin e ndryshimit socio - ekonomik në Kosovë duke synuar të ofroj përbledhje të zhvillimit dhe tipareve për ndryshim socio - ekonomik përmes ndikimit të medias.

Disertacioni është i strukturuar në gjashtë kapituj, ndërsa në kapitullin e parë i cili i kushtohet shfrytëzimit të literaturës e ku i jepet përbledhje veçore kryesore duke hulumtuar autorë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombe tar për kontributin e dhënë në fushën e medias dhe kontributit të saj të shkruar, elektronik apo edhe social për ndikim në ndryshim në shoqërinë Kosovare pa dallim kategorive shoqërore.

Kapitulli i dytë paraqet aplikimin e metodologjive me theks të metodologjisë empirike të hulumtimit të përshkruar me detaje të veçanta. Ndërsa aplikimi i metodave tjera sasiore dhe cilësore begaton mozaikun e temës së hulumtuar.

Në kapitullin e tretë fokusi bie tek politikat sektoriale dhe zhvillimi (evoluimi) i tyre në fusha jetike të banorëve të Kosovës. Trajtimi i këtyre fushave e që secila ndërlidhet me temën bosht ndikimi për ndryshim socio - ekonomik, ndërsa media në këto raste ka rol të një vëzhguesi për të vlerësuar ecurinë e arritjeve zhvillimore dhe evidentimin e ndryshimit socio - ekonomik.

Në kapitullin e katërt identifikohet puna e institucioneve nga këndvështrimi i mediave duke sjellë veprimtarinë institucionale të nëpunësve pranë audiencës dhe vlerësuar situatën faktike duke nxit debat për punën e përfaqësuesve të institucioneve të formuara për interesa të komunitetit dhe përbushjen e standardeve ndërkombe tar në krijimin e mundësive për mirëqenie të qytetarëve. Ndërsa e gjithë kjo sikur të mos ishte në llupën e medias ndryshimi ndoshta do të ishte më i ngadalshëm e që është synim të realizohet përmes ndikimit të medias.

Në kapitullin e pestë kemi hulumtimin e grupeve të interesit dhe bashkëveprimit ndërinstitucional të subjekteve relevante për interesa të komunitetit. Këto subjekte janë raste studimi përmes së cilave vihet në pah angazhimi dhe interesi i këtyre grupeve të caktuara për avancim të drejtave dhe mirëqenies së komuniteteve.

Në kapitullin e gjashtë është synuar sjellja e aspektit analistik sa mund të vijmë deri te qëllimi i kërkuar, a kemi ndryshim apo jo dhe a ka ndikuar media që ndryshimi të ndodh ?

Përmes pyetjeve hulumtuese kemi synuar të arrijmë në përfundimet finale rrith hulumtimin tonë për ndryshimin socio - ekonomik për të cilin ndikim ka pasur media secila nga këndi i sajë publike, komerciale apo sociale si dhe e shkruar ose elektronike.

Mediumet duhet të jepin kontribut të shtuar për sensibilizim dhe identifikimit të pikave të dobëta, inkurajimit të punës, të arriturave dhe promovimit për investime në vend.

Motivet për të ndihmuar janë me rëndësi të veçantë në sjelljen pro sociale, ndërsa realizimi është i ndikuar nga faktorë tjerë të cilët lidhen me situatën apo me elemente unike të personaliteteve.

Ndërsa për të për afruar dhe parë më konkretisht se cili ishte dhe vazhdon të jetë interesimi për ushtrimin e veprimtarisë audio - vizuale në Republikën e Kosovës ligji Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM).

Kapitulli I

1.1 HIPOTEZA KYESORE

Fokusi i mediave në politika pro aktive për ndryshim dhe ngritje të mirëqenies socio - ekonomike.

1.2 HIPOTEZA NDIHMËSE

Roli i mediave në mbështetje të zërit kritikë për institucionet dhe shoqërinë.

Kontributi i medias në sensibilizim të situatës socio - ekonomike.

Konstruktivi teti i medias, dhe puna transparente veprim i cili ndihmon institucionet dhe komunitetin bazuar në bashkëpunim.

Zbardhja e rasteve, publikimi dhe roli pro - aktiv i parandalimit të dukurive negative.

Prezantimi i vlerave me theks atyre të remitencave me qëllim dhe shumë dimensione.

1.3 PËRCAKTIMI I PYETJEVE KËRKIMORE

Qëllimi i disertacionit është të analizojë ndikimin e medias në ndryshimin socio -ekonomik në Kosovë si një koncept i ri. Hulumtimi i punimit mbështetet në disa pyetje të bazuara në hipotezë kryesore dhe ndihmëse të cilat do të shërbejnë për të arritur në një përfundim i cili arsyeton hulumtimin për temën bosht se sa media ndikon në ndryshimin socio - ekonomik jo vetëm në aspektin individual por edhe të komunitetit.

Është e rëndësishme të përcaktohet se cilët faktorë në kontekst të veçantë mundësojnë dhe lehtësojnë zhvillimin dhe cilat procese e kufizojnë dhe ngadalësojnë rrugën primare të hulumtimit në disertacion.

Ndikimi domethënës në përcaktimin e pyetjeve kërkimore të disertacionit është përvoja e autorit në fazat e studimit paraprak dhe punës profesionale të aspektit socio - ekonomik dhe hulumtimit drejt avancimit dhe mirëqenies. Për më tepër, interes i autorit për tema që synonin të vinin në dyshim stabilitetin socio - ekonomik dhe ekuilibrin është thelbësore ndërsa pyetjet kërkimore janë të lidhura me karakterin hulumtues i cili ndërlidhet me ndikimin e medias në ndryshim socio - ekonomik:

Cilat janë format e financimit për zhvillim të përgjithshëm në Kosovë ?

Cilat janë linjat buxhetore të zhvillimit socio - ekonomik ?

Cilat janë mbështetjet ndërkombëtare për zhvillim socio - ekonomik ?

Kush janë indikatorët vendor të zhvillimit socio - ekonomik ?

Cili është aktiviteti i OJQ-e vendore, me institucione vendore dhe ndërkombëtare ?

Në çfarë mase është arritur progresi i zhvillimit socio - ekonomik në Kosovë ?

Cili është ndikimi i medias në ndryshim, mbështetur në pyetjet e lartë shënuara ?

Të gjitha pyetjet e ngritura si çelës i hulumtimit kanë për qëllimi hulumtimin mbi kontributin e medias në ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë.

1.4. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Shqyrtimi i literaturës përfshin procesin e identifikimit të teksteve shkencore dhe profesionale për fushën e kërkimit dhe studimi i tyre. Ndihamon në identifikimin e polemikave dhe drejtimet e diskutimeve të lëndës së hulumtimit në komunitetin kërkimor dhe arrijet e kërkimit empirik. Studimi i literaturës me bazën e nevojshme teorike mundëson të kuptuarit dhe lidhjen e njohjeve

të rëndësishme për identifikimin e përgjigjeve të mundshme në pyetjet e kërkuar (Creswell, 2003,f.76).

Njëherësh ndihmon për të stimuluar me pyetje të reja tek studiuesit për të gjetur përgjigje në pyetjet e hapura(Strauss, 1988,f.23).

Fushat e njohurive të rëndësishme për realizimin e temës së disertacionit, u zhvilluan dhe plotësuan gjatë punës kërkimore, ku përveç grumbullimit të njohurive teorike të mbledhura, përvoja e studimit empirik të dukurive ndikon në mprehjen e imazhit të studimit sipas pyetjeve të kërkimit dhe gjërësinë e aspekteve që përgjigjet duhet të përfshijnë.

Në përkushtim për të gjetur përgjigje në pyetjet kërkimore, njohuritë përkatëse janë shtrirë në fushat e institucioneve të shtetit të mirëqenies, shoqërisë civile dhe medias si sektorë i veçantë i ndikimit në ndryshimin e mirëqenies dhe proceseve bashkëkohore nëpër të cilat po kalon shoqëria Kosovare. Megjithatë hulumtimi i literaturës i kontribuon thellimit të hulumtimit duke u mbështetur në përvojat e studiueseve të cilët kanë eksploruar problemin përkatës në kohë më të hershme.

Për ndikimin në ndryshimin socio - ekonomik përveç mediumit të shkruar apo elektronik në hulumtime shkencore përmes literaturës hasim në ndryshimin e ndodhur dhe faktorët të cilët kanë ndikuar në ndryshim. Një hap i domosdoshëm për të zvogëluar konfliktinështë kontakti në mes partnerëve, dihet se afërsia, ndërveprimi i partnerëve dhe ekspozimi i shpeshtë e shtojnë pëlqimin. Ndërsa armiqësia ndikon në shmangjen e kontaktit të rivalëve, prandaj nxitja e kontakteve mund të ndryshoj qëndrimet e njerëzve(Dragoti, 2004,f.472).

Për arritjen e qëllimit të ndryshimit ndikim të rëndësishëm ka bashkëpunimi i cili mund të arrihet përmes modeleve të ndryshme të bashkëveprimit. Gjithashtu edhe ujdia i kontribuon ndryshimit social sikurse p.sh në analogji burri me gruan, opozita me pozitë etj. Ndërsa nëse nuk mund të arrihet ujdia, atëherë nevojitet pala e tretë e cila ndërmjetëson dhe lehtëson marrëveshjen e tyre (Dragoti, 2004,f.474).

Në raste dhe analogji kontributi i medias eshtë i rëndësishëm përmes së cilit mund të ndikohet në ndryshimin e kërkuar. Ekziston një histori klasike e dy motrave që grindeshin për një portokall(Follet, 1940) Më në fund ato arrijnë të bien në ujdi për ta ndarë portokallin për gjysmë, njëra e shfrytëzon gjysmën e vet për të marrë lëngun, ndërsa motra tjetër e mori gjysmën tjetër për

të marrë tulin e gjysmës së vet për të bërë kek. Psikologët e sugjerojnë se me ndihmën e ndërmjetësit mund të arrihej një marrëveshje integriteti në qoftë se njëra motër do të merr gjithë lëngun e portokallit dhe tjetra të gjithë tulin e tij, atëherë përfitimi, i çdo pale do të ishte më i madh.⁴

Nga shembulli klasik në shembullin bashkëkohor dhe pragmatik mund të konsiderohej ndarja e hapësirës së medias për subjekte garuese në zgjedhje të një vendi të caktuar në mënyrë të barabartë nga mediumi përkatës i cili i kontribuon ndryshimit përmes ndikimit për ndarje korakte të kohës në prezantim të planit dhe objektivave të subjektit përkatës.

Ndikimi i medias për ndryshim ndërlidhet me argumente dhe shembuj të ndryshëm në jetën bashkëkohore dhe sfidave të kohës. Në kohë pandemie me Covid-19 interesimi i gjetjes së modaliteteve për të lehtësuar sfidat socio - ekonomike njëri ndër ta ishte shfrytëzimi i një pjese të trustit të pensionit 10% nga qytetarët të cilët në llogarit e tyre në trust kanë mjete në mënyrë që të zbusin situatën socio - ekonomike, kurse kontributi i medias ishte sensibilizimi i cili shkon deri në shqyrtim nga ana e deputetëve të cilët njëherësh e votojnë dhe kështu krijohet një mundësi që nga mjetet e tyre në trustin e pensioneve secili që ka interes mund të tërheq 10% të mjeteve të tij për lehtësim të situatës momentale për një mirëqenie pa e ngarkuar buxhetin shtetëror.⁵

Për katër muaj sa zgjati aplikimi për tërheqje të 10 % të shumës së kursyer nga fondi i pensioneve nga qytetarët, vlera e tërhequr ishte mbi 197 milionë €, fond e që pritet të rimbushët në afat prej 5 viteve të ardhshme.⁶

Ende pa u rimburësuar parat e tërhequra mundësia për edhe një tërheqje tjetër nga trusti transmetohet në media, e që do t'i mundësonte qytetarëve të merrnin deri në 30% nga fondi i pensioneve të tyre. “ *Në ligjin për pandeminë në Pakon e Rimëkëmbjes, është propozuar amendamentin për tërheqjen e 30% të kursimeve nga Trusti.*⁷ Personat që kanë kursime te pensionet në shumën më pakë se 10.000 €, kanë drejtë t'i tërheqin 30% të kursimeve të tyre të

⁴ibid

⁵www.rtklive.com,Transmetim i Drejtpërdrejtë, Kuvendi i Kosovës, 20.07.2020. (qasur më 20.07.2020).

⁶<https://www.epokaere.com/a-do-te-lejohet-terheqja-e-30-per-qindeshit-nga-trusti/> 04 nëntor 19:35, 2021. (qasur më 20.05.2022)

⁷ <https://gazetablic.com/terheqja-e-30-shit-bekim-haxhiu-zbulon-per-expose-formulen-e-miratimit-te-projektligjit-per-trustin/>.(qasur më 25.05.2022)

pensioneve nga Fondi i Kursimeve të pensioneve të Kosovës. Personat që kanë kursime të pensioneve në shumën prej 10.000 €, kanë drejtë t'i tërheqin deri 25% të kursimeve të tyre nga pensionet në FPKK-ë.⁸ Personat që kanë kursime të pensioneve në shumën se 20.000 € e deri në 29.999 €, kanë drejtë t'i tërheqin 20 % të kursimeve të tyre nga pensionet në FPKK-ë.⁹

1.5 QASJA KËRKIMORE

Bazohet në pyetje të përcaktuara për të cilat studiuesi kërkon përgjigje përmes bërjes së pyetjeve të hapura, të pa strukturuara, diskutimeve dhe ndërveprimeve me njerëzit tjerë, duke dëgjuar përgjigjet e bashkëbiseduesve. Studiuesi mbledh kuptimet subjektive të përvojave të subjektit kërkimor, dhe ato janë në shumë dimensione që kanë për qëllim pranimin e kompleksi tetit të qenit në gjendje t'i shohin ato në vend se sa të ngushtojnë mirëkuptimin e ideve dhe kategorive.(Creswell, 2003,f.2nd ed).

Shpesh është e kombinuar me një qasje interpretuese, e cila përfshin një interpretim eksplorues të kuptimit që individët dhe grupet kanë marrë para sysh ndikimin e trashëgimisë kulturore, sociale, historike në formimin e pikëpamjeve të tillë.

Pragmatizmi është aplikuar gjithashtu, si një qasje kërkimore që përqendrohet në problemin, jo në metodat kurse studiuesi aplikon të gjitha metodat e mundshme. Përmes pragmatizmi studiuesi merr lirinë për kombinim të metodave të hulumtimit në një masë më të madhe.¹⁰.

⁸ <https://www.epokaere.com> (qasur më 10.05.2022)

⁹ <https://www.epokaere.com>. (qasur më 10.05.2022)

¹⁰ Po aty..

1.6 METODOLOGJIA E KËRKIMIT EMPIRIK

Në pjesën empirike të hulumtimit u aplikuan kryesisht metoda cilësore. Nga natyra e tyre, ato janë "hetuese" dhe të përshtatshme për hulumtimin e fenomeneve. Metodat cilësore paraqesin seri teknikash që synojnë të përshkruajnë, deshifrojnë, dhe interpretojnë kuptimin e fenomeneve të caktuara në shoqëri.¹¹

Studimi bazohet në hulumtime eksploruese bazuar në metodën e studimit të çështjeve të zgjeruara. Andaj studimi i rasteve është një metodë cilësore e fenomeneve sociale. Përparësitë e studimit të rastit janë që kjo metodë mund të përdoret për të studuar fenomenet bashkëkohore në kontekstin e jetës reale, kur kufiri në mes fenomenit dhe kontekstit është fare i padukshëm.(Bob.2010,f.89).

Burimet e të dhënave mund të janë të shumta të cilat përfshijnë regjistra arkivorë, intervista, vëzhgime me pjesëmarrje, artefakte fizike etj. Megjithatë nuk është e nevojshme të përdoren të gjitha për secilin studim.

Kjo metodë është veçanërisht e dobishme në studimin e fenomeneve shoqërore në zhvillim, sepse lejon krijimin e koncepteve analitike të intervalit mesatar. Përveç studimit të rastit është aplikuar edhe metoda e intervistës së gjysmë strukturuar duke lënë hapësirë për përgjigje të mundshme të anketuarve, ndërsa kjo formë e intervistës jep rast për fushat që mungojnë në projekt të planifikuar kërkimor duke ndihmuar edhe në pyetjen themelore të hulumtimit.

Kjo metodë është e dobishme në rastin e hulumtimit. Të dhënat e marra përmes studimeve të rasteve dhe intervistave janë analizuar sipas fushave kryesore duke u përdor metoda analitike, krahasuese, historike dhe përshkruese. Të dhënat statistikore të krahasuara përmes të dhënave të institucioneve relevante si Agjencia e Statistikave e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Odat Ekonomike, Sindikatave, Ministriive, Drejtoreve etj. si burime potenciale për një periudhë kohore.

¹¹ Po aty .

1.7 MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Të dhënët rreth studimit tonë janë mbledhur në periudhë kohore Qershori 2021 deri më Qershori 2022. Gjatë kësaj periudhe, janë organizuar intervista me përfaqësues të organizatave të zgjedhura për studim të rasteve, si dhe me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave të përfshira në proceset e krijuar të politikave dhe ndikimin e medias në ndryshimin socio – ekonomik.

Pjesa dërmuese e intervistave janë kryer enkas gjatë vizitës personale në organizata përkatëse, ndërsa për shkaqe të arsyeshme të intervistuarve disa intervista janë kryer në mënyrë elektronike duke ia dërguar pyetjet subjektit të caktuar dhe komunikuar edhe përmes pyetësorit në formë elektronike për shkak të situatës së herë pas hershme më të vështirësuar nga pandemia Covid-19.

Para kryerjes së intervistës, studiuoi ua ka shpjeguar me hollësi të anketuarve qëllimin dhe rëndësinë e hulumtimit, si dhe kohën e parashikuar për kohëzgjatjen e intervistës. Ndërsa Intervistat kanë zgjatur mesatarisht rreth një orë deri një orë e gjysmë.

Gjatë periudhës së përgatitjes së disertacionit, shumica e organizatave janë kontaktuar disa herë për të verifikuar të dhënët, mbledhë informacione dhe për të siguruar informacionet shtesë për ndonjë ndryshim të mundshëm gjatë fazës së përgatitjes së temës.

Në intervista kryesisht ishin pjesëmarrës zyrtarë institucional, presidentë, nënkyetarë të shoqatave ose menaxherë të projekteve. Para dhe paralelisht me intervistat, janë grumbulluar materiale shtesë, dokumente, statute, raporte, broshura dhe materiale promovimi, si dhe artikuj nga mediat elektronike dhe të shtypura elektronike që ndërlidhen me aktivitetet e organizatave të përfshira në studimet e rastit.

Gjatë intervistës kryesisht janë përdorë regjistrime, përkatesisht shënime me shkrim, ndërsa intervistat janë arkivuar dhe janë në dispozicion të autorit. Kurse bashkëpunimi për dhënien dhe plotësimin e të dhënave për kompletim të informacioneve të zbërthimit të qëllimit përmes intervistës ishte përbajtjesore për të cilin trajtohej hulumtimi.

Kapitulli II

2.1. METODOLOGIJA

Në Këtë hulumtim janë përdorë katër teknika kryesore hulumtuese:

Në përbajtje është analizuar hapësira e medias në Republikën e Kosovës ku janë analizuar mediumet të cilat funksionojnë si TV dhe Radio të licencuara në bazë të ligjit Nr.04/L-44.

Në këtë vazhdë është zhvilluar bisedë gjysmë e strukturuar me menaxher dhe kryeredaktor të institucioneve për të parë se si dhe sa mendojnë që ndikojnë mediumet në zhvillimin socio - ekonomik në Republikën e Kosovës.

Metodologjia e hulumtimit te rastet studimore që merren me çështjen socio -ekonomike në Republikën e Kosovës është kërkuar ndikimi i mediumit me funksionimin e tij. Ndërsa përgjedhja `e këtyre subjekteve është bërë duke pasur para së shumtë kategoritë e ndryshme shoqërore si p.sh.: Persona me aftesi të kufizuara, pensionistë, të rijnë, komunitete të ndryshme, çështje gjinore sikurse edhe përfaqësues të institucioneve të pushtetit lokal për mirëqenie sociale dhe shëndetësore.

Për arritjen e hulumtimit në rastet konkrete është përdorë pyetësori i strukturuar përmes së cilil janë nxjerrë synimet përmes përfaqësuesve të këtyre subjekteve sa i përket ndryshimit socio - ekonomik dhe rolit të medias në Republikën e Kosovës.

Përqendrimi i punimit të temës bazohet në aplikimin e metodave të përziera përmes së cilave zbërthehet kompleksi teti i temës së disertacionit i ngritur në hipotezën bazë dhe ato mbështetëse të hulumtuar përmes pyetjeve dhe intervistave, hulumtimit arkivor të dokumentacioneve të ndryshme të institucioneve, publikimit të materialeve përmes botimeve dhe prezantimeve të sfidave dhe kërkimit mundësive për arritjen synimeve dhe objektivave kryesisht të OJQ-ve të cilat

janë zëri i sensibilizimit dhe kërkimit të ndryshimit socio - ekonomik të komunitetit përkatës që janë subjekte të regjistruar.¹²

Aplikimi i hulumtimit empirik duke i analizuar materialet përmes metodave analitike pa anashkaluar metodat sasiore, cilësore dhe statistikore japid shytje për tu thelluar drejt synimit të kërkuar, synim për të arritur sa më afër të vërtetës së kërkuar për identifikim dhe kërkim se cili është roli i medias në ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë.

Sa me të vërtetë, cili ishte dhe a mbetet edhe më tej roli i medias në ndryshimin socio -ekonomik në Kosovë dhe sa ka ndikuar pandemia Covid-19, kriza energjetike dhe ndërhyrja e Rusisë në Ukrainë për këtë sa do të ndikonin prodhimet vendore Kosovare për tejkalim të sfidës në aspektin e përgjithshëm por edhe socio - ekonomik.

Pandemia Covid-19, ndryshoi qasjen pro sociale të qytetarëve të Kosovës. Andaj përmes metodave krahasuese vijmë te të gjeturat se ndryshimi ka ndodhur si te personaliteti, familja dhe shoqëria apo nga distanca sociale deri te sfidat shëndetësore dhe ekonomike. Kurse për këtë roli i medias ishte i rëndësishëm që nga identifikimi i problemeve deri te gjetja dhe prezantimi formave të ndryshimit të sjelljes së argumenteve të synuara se si të mbrohem nga pandemia Covid-19, cili ishte kontributi për ndryshimin e përgjithshëm në rrethana sfiduese të kohës etj.

Dinamika e ndryshimit socio - ekonomik është gjithëpërfshirëse, ndërsa identifikimi dhe menaxhimi i ndryshimeve nuk mbetet i pa dukshëm falë punës së medias me qëllim të identifikimit, kërkimit të metodologjisë së tejkalimit të sfidës dhe krijimit të pjekurisë dhe të jetuarit të një jete bashkëkohore krahas ndryshimeve të shpejta të aspektit socio - ekonomik me theks kur këto ndryshime janë të përcjella nga media dhe ndryshimi vjen më i natyrshëm.(Vidović, 2012,f.27).

Aplikimi i metodologjive kryesisht të atyre empirike dëshmon se studimi është përqendruar në hulumtim të problemit të trajtuar, nga grupe të caktuara të interesit shoqëror të cilat përmes angazhimeve të tyre të ndryshme si konferanca për media e deri tek ngjarjet më radikale si p.sh. grevat dhe protestat vjel informacione të cilat kanë të bëjnë me aplikim të metodologjisë së punës

2

¹²https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F35546712%2FNdikimi_i_grupeve_t%25C3%25AB_interesit_n%25C3%25AB_Britanin%25C3%25AB_e_Madhe_si_vend_an%25C3%25ABtar%25C3%25AB_i_Bashkimit_Evropian (qasur më 15.05.2022)

hulumtuese drejt synimit për identifikim të problemit i cili përfundon në shqetësim socio - ekonomik nga grupe të caktuara të qytetarëve.

Përcjellja nga afër e ndryshimit nga pasoja e shkaktuar nga pandemia Covid-19, kriza energetike dhe e ndërhyrjes ushtarake e Rusisë në Ukrainë dhe krahasimi i informacioneve nëpër media bën që të ngremë hipotezë.

E përbashkëta gjatë hulumtimit dhe analizës për ndryshimin socio - ekonomik gjen hapësirë thuaja te të gjitha mediat pa dallim elektronike, publike, komerciale sikurse edhe te ato sociale. Megjithatë duhet evidentuar që përveç në edicione informative përmes formave të ndryshme të prezantimit të problemit socio - ekonomik përgatitja e emisioneve dedikuar kësaj fushe është e pranishme.

Trajtimi problematicave socio - ekonomike pa dallim ka për synim detektimin e situatës faktike dhe kërkimin e mundësive për tekalim të sfidave. Për këtë mediat kanë rol konstruktiv përmes së cilave kërkohet që të ndodh ndryshimi i kërkuar nga shoqëria të cilët kërkojnë shtigje që përmes formave të ndryshme të tekalohen sfidat socio - ekonomike.

Ndryshimi i aspektit socio - ekonomik në kontestin kohor nuk ka stabilitet për pasoj të sfidave globale dhe rajonale të cilat në mënyrë të tërthortë ndikojnë në ngecje dhe mos zhvillimin e përgjithshëm shoqëror. Në këtë vazhdë mediat duke bërë punën e tyre profesionale dhe prezantimin e dukurive dhe informuar opinionin mëtojnë të jenë gardian dhe shtytes të proceseve për mirëqenien.

Për këto çështje nuk mungojnë iniciativat e mediave elektronike apo edhe të shkruara që të kontribuojnë, ndërsa në prezantimin të problemit mediat jo domosdo janë pjesë edhe përfaqësues të institucioneve të cilët në shumicën e rasteve janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë apo indirekt me përgjigjet e tyre në kronika apo edhe emisione televizive për kontributin e dhënë në përmbushje të detyrimeve bazuar në ligjet në fuqi dhe obligimin institucional që kanë karshi qytetarëve.¹³

¹³vështrim analistik i autorit të disertacionit në emisionin autorial “ Refleksion “, Maj,2002, RTK-ë (qasur 20.05.2022).

Kapitulli III

3.1 POLITIKAT SHËNDETËSORE

Politikat për ngritje socio - ekonomike janë të ndërlidhura njëra me tjetrën ndërsa sajohen nga bashkëveprimi i institucioneve, kurse ndikim për zhvillimin e tyre në përbushje të nevojave të qytetarëve kanë mediat të cilat, cila më pak e cila më shumë në kornizat e tyre programore zhvillimore dhe përmes informimit për gjendjen faktike, njëherësh edhe duke konfirmuar përkushtimin dhe besueshmërisë tek qytetarët i përkushtohen këtij problemi madhor shoqëror.

Mileniumi i tretë dhe më konkretisht dekada e dytë kur Kosova zhvillon shtetin e pavarur nga viti 2008 prej kur e fiton pavarësinë e saj dhe me plot ambicie për zhvillim sfidat gjatë rrugës dalin. Për fat të keq me sistemin shëndetësor dhe sfidat në këtë fushë të rëndësisë së veçantë ka vend për tu dëshiruar dhe kjo mund të arrihet me ndryshimin i cili është i domosdoshëm për mirëqenien e shëndetit të qytetarëve Kosovar.

Transformimi nga një sistem shëndetësor në një tjetër i përzier publik dhe privat ka krijuar dallime esenciale te qytetarët të cilët varësish situatës së tyre ekonomike përcaktohen për trajtim shëndetësor. Ndërsa stafi shëndetësor në mungesë të ligjit, duke u bazuar në rrethana sipas ligjit aktual punon punë të dyfishtë atë publike dhe private.

Aparatura e pamjaftueshme mjekësore dhe krijimi i besimit për trajtim shëndetësor jashtë vendi bën që pacient kosovar të kërkojnë trajtim jashtë vendi (ata që kanë mjete materiale apo sponsor të ndryshëm) kjo i kushton si pacientit, familjes por edhe ekonomisë së Republikës së Kosovës për faktin që para të majme dalin jashtë vendi për trajtim të pacientëve me sëmundje të ndryshme.¹⁴

Shëndetësia në sektorin publik çalon si në shëndetësinë primare, sekondare dhe terciare e gjithë kjo në mungesë të buxhetit të pamjaftueshëm gjatë viteve dhe ndarja e mjeteve nga linjat buxhetore duke u orientuar në fusha tjera zhvillimore të vendit. Ngritja e buxhetit gjatë viteve ka avancuar, megjithatë nuk ka përbush nevojat e qytetarëve. Ndërsa mbështetjet nga shtete mike si rasti me Turqinë për të trajtuar pacientë nga fusha e kardiokirurgjisë falas 100 raste (pacient), marrëveshje

¹⁴www.rtkleve.com., “Medika” RTK-ë, emision informativ për shëndetësi (qasur më 15.04.2020).

e nënshkruar në kohë e udhëheqjes së Ministrisë së Shëndetësisë nga z. Ferid Agani sado pak e zbut situatën socio - ekonomike.

Ndër problemet të cilat duhet nënvizuar është ligji kundër Covid-19 i cili një kohë të gjatë sidomos kur pandemia ishte e ashpër mezi ariti të aprovohet dhe kjo u arrit pas 5 muaj të debateve mes përfaqësuesve politik dhe përfaqësuesve të legjislativit Kosovar në Kuvendin e Kosovës.

Megjithatë problemet të cilat e përcollën qytetarin Kosovar dhe në përgjithësi shtetin e Kosovës në kohë pandemie është përcjellja e situatës shëndetësore në glob dhe kështu duke kërkuar ndryshimin e duhur për mirëqenie shëndetësore të qytetarëve të Kosovës.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së infeksioneve⁵³ si pasojë nga pandemia Covid-19 vendimet e Qeverisë së Kosovës të bazuara nga sugjerimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik sillnin vendime të ndryshme sikurse ajo e bartjes së maskave, ndërsa për këtë angazhimi i zyrtarëve policor ishte obligim i cili duhej të mbikëqyrin zbatimin e ligjit dhe për këtë pati shqiptime të gjobave për qytetar të cilët nuk respektuan qëndrimet qeveritare për veprime kundër Covid-19 në momente të caktuara kohore¹⁵.

2

¹⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fmpms.rks-gov.net%2Fnjoftim-i-mpms-per-te-gjithe-pensionistet-e-kosoves%2F> (qasur më 22.04.2022).

Tabela 1. Angazhimet e zyrtarëve policor në zbatim të ligjit

16

Angazhimet e zyrtarëve policor në zbatim të ligjit NR. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës nga 26.08.2020 -

24.05.2021

Fletëparaqitje	
Prishtinë	52577
Gjilan	21145
Ferizaj	26144
Prizren	29738
Pejë	27846
Mit. Jug	16538
Mit.Veri	5990
Gjakovë	21794
NJKA	757
Gjithsej	202529

Me hyrjen në fuqi të ligjit kundër Covid-19 dhe me qëllim të parandalimit të shtimit të rasteve të prekur dhe për pasoj edhe shtimit të rasteve me fatalitet ishte marrë qëndrim që qytetarët të cilët nuk e respektojnë vendimin e Qeverisë të gjobiten për:

Mos bartja e maskës,

Mos respektimi i distancës,

Mosrespektimi i orarit të lëvizjes në orë të kufizuar,

Mos respektimi i tubimit në masë,

Në fushata zgjedhore apo raste tjetra.¹⁶

Ndonëse për ditë të caktuara dhe periudha të shkurta kohore pati zbutje të masave për pasoj të rënies së infektimeve nga Covid-19, informacione të përditësuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKSHPK-ë) megjithatë rikthimi i masave ndëshkuese bën që prapë të rikthehen edhe maskat por edhe angazhimi i policisë dhe inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV) të Kosovës për aplikim të masave shtesë rikthehet për biznese, dhe qytetar.

Përkushtimi i Qeverisë së Kosovës për sigurimin e vaksinave dhe në përgjithësi për vaksinimin e qytetarëve bën që një rol esencial e luajnë edhe mediat që nga emetimi i spoteve reklamuese, përgatitja e shënimive dhe kronikave, konferencat nga vende të ngjarjes si qendra vaksinimi, qendra të mjekësisë familjare, qendra spitalore etj. që të ngrehin nivelin e sensibilizimit të opinionit që vaksinimi është mundësia më e lehtë për të parandaluar infektimin nga virusi Corona dhe zbutur pasojat nga pandemia Covid-19.

Krahas vështirësive, shërbimet shëndetësore në sektorin primar, në atë dytësor dhe terciar realizohen nëpër institucione publike në nivel vendi në Kosovë.

Tabela 2. Analiza laboratorike janar - mars, 2022 në QMF-1, Prishtinë.

MUAJI	VIZITAT	SHËRBIM	VLERAT	VLERAT	JO	PAGESAT
			ET	PAT.	PAT.	
JANAR	1.022	16.004	6.134	9.870	171	(497 €)
SHKURT	1.171	12.881	8.027	4.854	158	(466 €)
MARS	915	13.373	5.613	7.760	137	(395 €)
TOTALI	3.108	42.258	19.774	22.484	466	(1.358 €)

¹⁶ www.rtklive.com,lajmet qendrore 19.30.(qasur më 18.04.2022).

Tabela 3.Mosha e personave të cilët kanë marrë shërbime në QMF-1,Prishtinë

Muaji	Totali	O -	1 - 5	6 - 9	10-	15-	20-	25-	35-	45-	55-	+65
		1		14	19	24	34	44	54	64		
Janar	1.022	14	36	44	52	58	44	122	88	165	132	267
Shkurt	1.171	11	33	41	59	62	35	138	106	149	145	392
Mars	915	7	27	43	47	51	37	111	86	123	114	269

Nga përpunimi i të dhënavë si në tabelë rezultatet faktojnë se periudha e sezonit dimërор atakon më shumë shëndetin e qytetarëve për faktorë të ndryshëm socio - ekonomik duke ia shtuar në këtë rast edhe situatën aktuale me Covid-19 dhe post Covid-19 të pacientëve ndërsa mosha më e atakuar del të jetë ajo mbi moshën 65 vjeç.¹⁷

Ndërsa në aspektin ekonomik participimet për shërbimet janë në shkallë të pakënaqshme për pasoj të skemave të shumta dhe të ndryshme sociale të shoqërisë të cilat janë të liruara nga participimi dhe janë përfitues të shërbimit shëndetësor falas.

Digjitalizimi i shëndetësisë, donatorët dhe krijimi i sigurimeve shëndetësore pa varsh mëri nga donatorët, Ministria e Shëndetësisë do të mund të krijonte kushte më të mira për qytetarët e Kosovës gjithnjë duke u bazuar në krijimin e mundësive përmes sistemit shëndetësor të krijohej sigurimi shëndetësor i cili nuk po jetësohet edhe përkundër propagandimit në secilën fushatë zgjedhore të subjekteve politike Kosovare si një prioritet pa dallim nga secili subjekt garues tash e 22 vjet nga pas lufta ose tash 15 vjet nga pavarësia e Republikës së Kosovës¹⁸.

Megjithatë mbetet për tu dëshiruar një veprim i cili konsiderohet sa i rëndësishëm po aq i domosdoshëm kur diskutohet për shëndetin e qytetarëve të vendit të cilët po sfidohen. Ndërsa mjete të konsiderueshme të qytetarëve përfundojnë nëpër poliklinika private brenda dhe

¹⁷Interviu², Kade Bejtullahu biokimiste, QMF 1, Prishtinë , Prill.2022.

¹⁸https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F40658965%2FEfektet_e_regjistrimit_te_titujve_te_pronesise_ne_regjistrat_publike (qasur më 25.04.2022).

jashtë vendit sidomos nga ana e qytetarëve të cilët janë në gjendje më të mirë financiare apo edhe të mbështetur nga donacionet humanitare të rasteve më të rënda të cilat mbështeten nga donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendi e dëmton sektorin e shëndetësisë publike.¹⁹

Pavarësimi i fondit të sigurimeve shëndetësore i cili do të jetë më profitabil për mbledhjen e mjeteve materiale dhe sigurimi i mjeteve për shërim jashtë vendi, ndërsa transparenca nga ana e shtetit për trajtim jashtë vendi mungon.²⁰

Administrimi i vaksinave mund të konsiderohet suksesi më i madh i Qeverisë së Kosovës përkatësisht Ministrisë së Shëndetësisë si rezultat i cili është inkurajues dhe forma më e mirë e parandalimit të infekzionit nga Covid-19, është vaksinimi i cili mund të konsiderohet i kënaqshëm me numrin e atyre të cilët janë të vaksinuar me dozën e parë dhe të dytë, kurse me lehtësimin e situatës sa i përket infektimit, interesimi për vaksinim me dozën e tretë apo atë përforcuese, interesimi i qytetarëve për tu vaksinuar është më i vogël²¹.

Të dhënat e përditësuara jepin shifra konkrete, ndërsa krijimi i mundësisë dhe sasisë së vaksinave është shembull i mirë i institucioneve për sigurim të vaksinave të mjaftueshme për qytetarë. Nga bashkëpunimi i MSH-ë dhe IKSHPK-ë informacionet për Covid-19 ishin të përditësuara.

³⁵ Në 24 orët e fundit janë dhënë 183 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit ¹⁶ në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1.823.626 doza të vaksinës, 821.061 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Janë dhënë 100.552 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19. Nga 928 testime, 28 qytetarë kanë rezultuar pozitiv me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit, është shënuar 1 rast i vdekjes. Sot janë shëruar 30 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 224.030. Në total numri i rasteve aktive është 541.²²

Ndërkohë mund të konstatohet se interesimi i qytetarëve për tu vaksinuar ka qenë jo konstant edhe pse në stoqë ka pasur vaksina të mjaftueshme. Përveç shëndetit si problem primar vaksinimi i qytetarëve sidomos me vaksinën e parë dhe të dytë ka ndikuar edhe për faktin që udhëtimet jashtë vendi dhe shërbimet në vende publike janë kushtëzuar me imunizimin përmes vaksinës. Ndërsa

¹⁹ <https://msh.rks-gov.net/sq/njoftimi-per-coronavirus/> (15.04.2022).

²⁰ www.ktv.com “ Java me Rronin “.(qasur më 25.12.2021).

²¹ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fmpms.rks-gov.net%2Fnjoftim-i-mpms-per-te-gjithe-pensionistet-e-kosoves%2F> (qasur më 20.04.2022)

²² <https://datastudio.google.com/.../2e546d77.../page/MT0qb>. (Të dhëna të përditësuara për datë 09 Prill.2022.)

me lehtësimin e masave bie edhe interesimi i qytetarëve për tu imunizuar me dozën përforcuese apo dozën e tretë të vaksinës kundër Covid-19 ka munguar.²³

3.2. POLITIKAT E BANIMIT

Politikat e banimit në Kosovë nga institucionet qendrore dhe lokale lënë vend për të dëshiruar ndryshimin i cili është i domosdoshëm. Institucionet e nivelit lokal dhe sidomos ato të nivelit qendror nuk kanë arritura të përbushin nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë socio - ekonomike, ndërsa kërkesat që nga paslufta ishin të shumta drejtuar institucioneve të cilat pak kishin arritur të përbushin nevojat e qytetarëve përvç në raste të veçanta kur qytetar rezident të Kosovës përfitojnë nga ngritja e objekteve të banimit social.

E ashtuquajtura “ Fusha e Pajtimit ” në Prishtinë është një prej dy lagjeve në qytet e tjetera në Hajvali lokalitet afér Prishtinës ku Komuna e Prishtinës ka ndërtuar objekte të banimit social, duke siguruar 100 banesa për raste sociale dhe 100 për familje të viktimate të luftës dhe persona me aftësi të kufizuara, ku 30 % e popullsisë vlerësohet që jetojnë në varfëri, ndërsa sigurimi i banimit social iu është i rëndësishëm.²⁴

Sipas ligjit për programe të banimit dhe financim, komunat e vendit janë të obliguara të sigurojnë strehim për familjet që kanë nevojë, ndërsa identifikohen sipas disa kriterieve si statusi i banimit, të hyrat, gjendja shëndetësore, aftësitë e kufizuara, dhe struktura familjare.²⁵

Sipas komitetit të OKB-ë për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (CESCR), të gjithë kanë të drejtë të jetojnë në siguri, paqe dhe dinjitet pa marrë parasysh të hyrat ose qasjen në burime ekonomike. Megjithatë për të ushtruar të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore, banimi është vendimtar. Deri vonë, Komunat vazhduan të operojnë në bazë të direktivave të vjetra për banim social, të specifikuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 2007.

²³ www“ Në fokus “ emision kushtuar problemeve shëndetësore, (qasur më 25.03.2022).

²⁴ <https://data.worldbank.org/country/kosovo>, (qasur 2.06.2022)

²⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkosovotwopointzero.com%2Fstuck-in-social-housing-kosovos-weak-policies-and-lack-of-commitment%2F> (qasur më 18.04.2022).

Sipas këtyre direktiva personi ka të drejtë për banim social nëse ka nevojë për të, por në momentin që punësohet, është i obliguar ta dorëzojë shtëpinë dhe kjo nuk krijonte nxitje për të kërkuar punë ndërsa ligji aktual nuk obligon njerëzit që të lirojnë banesën në rastin kur ata punësohen. Lidhur me këtë ligji aktual ka nevojë për përmirësim, në mënyrë që banimi social të kuptohet nga të gjithë vetëm si banim i përkohshëm dhe si të tillë ligji duhet të përcaktoj aspekte më efikase të ndihmojnë si në punësim po ashtu edhe në ri integrim në shoqëri.²⁶

Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale për Komunën e Prishtinës, pati vendosur për sajimin e planit strategjik të banimit social. Drejtori i drejtorisë së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në Komunën e Prishtinës, Nazim Cakolli thotë: Jemi duke krijuar kontakte dhe prodhuar ide për zgjidhje të problemit përmes diskutimeve grupore. Familjet që aplikojnë për banim social dhe e fitojnë, ata që mund të janë në varfëri të skajshme, dhe pa pronë fare. Prioritet si nënat me shumë fëmijë, viktimat civile, veteranët e luftës dhe personat me aftësi të kufizuara, mund të janë prioritet për banim social.²⁷

Numri i kërkesave të regjistruar ishte 500, ndërsa tanë mund të jetë afér 1,000. Sipas këtyre shifrave e bëjnë të qartë se banimi social në vendin tonë mungon seriozisht. Familjet që kanë nevojë janë të shumta në krahasim me strehimin në dispozicion, pasi që janë vetëm rrëth 200 banesa në Prishtinë.²⁸

Nga banimi social dhe të drejtat pronësore në Kosovë (SHPRK) beson se pjesë e problemit është fakti që nuk ka departament në Komunë të dedikuar për të trajtuar vetëm banimin social. SHPRK-ë konsideron se nevojitet të ketë departament special për shënimë cili është pranuar dhe ku do të jetojnë dhe kush nuk është pranuar, në mënyrë që të realizohet procesi i zgjedhjes.

Zgjedha e familjeve për banim social bëhet duke përmbrush kriteret kurse sistemi i pikëve është themeluar sipas ligjit për banim me qëllim të eliminimit të vlerësimit nga e kaluara e zgjedhjes kur banimi social i ndahej njerëzve me rezultate më të ulëta, derisa kishte të tillë që kishin më shumë nevojë për të.²⁹

²⁶https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.rtklive.com%2Fpages%2Ffiles%2Fraporti_vjetor_2017_AL.pdf (qasur më 21.05.2021).

²⁷www.rtklive.com Refleksion RTK-ë, emision autorial. (Shtator,2019)

²⁸Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale për Komunën e Prishtinës ,2019.

²⁹Drejtoria Komunale për Shëndetësi e Mirëqenies Sociale Prishtinë, RTK-ë lajme.2019.

Pra, vendimi përfundimtar bazohet me transparencë në zgjedhje dhe seleksionim për banim social për familjet në nevojë. Përveç që lehtëson problematikat e banimit social njëherësh krijon besim tek institucionet të cilat obligohen dhe përkujdesen për mirëqenien e qytetarëve.

Për politikat e banimit në Kosovë të organizuara në nivele Komunale në Kosovë kontribut të pakontestueshëm kanë dhënë mediat si ato elektronike, të shkruara dhe sociale duke tentuar për të informuar dhe përmes informimit sensibilizuar përfaqësuesit e institucioneve dhe njëherësh edhe motivuar mërgimtarët të cilët në vazhdimësi në forma individuale dhe grupore dhe organizatave kontribuuan për të ngrit kulme të reja për familje nevojtare me pamundësi për të siguruar kushte për banim për familjen e tyre.

Ndërsa rol esencial për sensibilizim të këtij problem madhor kanë luajtur mediat përmes kronikave dhe emisioneve socio - ekonomike duke evidentuar familjet, lokalitetet dhe kushtet jetësore të familjeve me gjendje të rëndë socio – ekonomike, ndërsa në shumë raste duke prezantuar familje pa shpresë që nuk mund të ri ngrihen pa mbështetje institucionale apo të shoqatave vendore, ndërkomëtare ose të humanistëve kryesisht shqiptar nga vende të ndryshme nga mërgimi.³⁰

Ngritura e banimeve kolektive në qytete të vendit nga buxheti i Kosovës për kategori sociale dhe grupe tjera të qytetarëve është fokusuar nga ana e mediave sikurse edhe transmetuar gala mbrëmje humanitare ku iniciativat e pushtetit lokal si rasti në Gjilan ndanë një sasi të mjetëve nga buxheti Komunal të mbështetur edhe nga donator nga mërgata dhe donator, biznese vendore etj.³¹

Përmes emisioneve me karakter socio - ekonomik, mediat Kosovare në skemat e tyre sjellin emisione speciale të këtij karakteri sikurse edhe përmes edicioneve informative dhe emisioneve tjera enkas për këto tema sikurse emisioni “ Refleksion “ në Radio Televizionin e Kosovës,(RTK-ë), emisioni “ Edhe unë jam Kosovë “ në RTV 21, TV Dukagjini, Klan Kosova etj.

³⁰www. Rtv21, “ Edhe unë jam Kosovë “,(qasur 25.11.2021)

³¹ www.rtklive.com. lajmet 19.30 & emision i drejtpërdrejtë & gala mbrëmje humanitare (qasur më26.11.2021)

3.3. POLITIKAT NË ARSIM DHE EDUKIM

Politikat në arsim dhe edukim bazohen në planifikim strategjik për të siguruar harmonizimin me prioritetet e programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës në fushën e arsimit dhe shkencës:¹

- Reformat strukturore në arsim;
- Pjesëmarrjes së barabartë në arsim;
- Garantimi dhe i cilësisë së arsimit;
- Udhëheqja e institucioneve të arsimit;
- Integrimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar;
- Promovimi i shkencës dhe i hulumtimeve;
- Rritja e financimit të arsimit dhe shkencës.

Hartimi i Politikave Sociale në Arsimin e Kosovës (PSAK) u realizuan në kontekstin e katër objektivave të përbashkëta të BE-së për të trajtuar sfidat në sistemet e arsimit dhe aftësimit deri në vitin 2020 të detajuara në “Arsimi dhe Aftësimi 2020 ”.¹

- Bërja realitet e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe mobilitetit;
- Përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe aftësimit;
- Promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive;
- Shtimi i kreativitetit dhe inovacionit, duke përfshirë ndërmarrësin, në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimit.

Aplikimi i PSAK-ut, kryesisht nga kapaciteti implementuese i komunave dhe drejtoreve të arsimit. Bartja e autorizimeve në fushën e arsimit nga niveli qendror në atë lokal ka ndodhur gjatë viteve 2008 / 2009. Deri sot nuk është arritur që të gjitha Komunat të ndërtojnë kapacitetet e duhura për t'i përmbyt shumë detyrimet e tyre në këtë fushë. Kjo ndikon në jetësimin e masave të PSAK-ut, pasi nuk është e mundur që të gjitha masat të zbatohen drejtpërdrejt nga MASHT-i, pa një mbështetje

solide nga niveli Komunal.³² Për më tepër, është me rëndësi të madhe të nxitet të kuptuarit e gjerë të faktit se kjo autonomi e rritur e nivelit lokal duhet të shoqërohet me rritjen e përgjegjshmërisë dhe me menaxhim të cilësisë.³³

1

Shkalla e ulët e përfshirjes në edukimin parashkollar segment i arsimit ka mungesë të investimeve, prandaj mungesa e infrastrukturës mbetet shkaktari kyç për përfshirjen e ulët të fëmijëve në këtë nivel. Vetëdijesimi i familjeve dhe politikë bërësve për rëndësinë e edukimit parashkollar është çështje që duhet adresuar edhe në të ardhmen.³⁴

1

Sfidë e madhe mbetet përfshirja në arsimin e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, në veçanti e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, si dhe e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE).³⁵

1

Fenomeni i braktisjes së shkollimit dhe mos-regjistrimi në arsim deri në vitin 2014, braktisja ka shënuar rënien të vazhdueshme, por në vitin 2015 dukshëm është rritur numri i fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën si rezultat i largimit të një numri të madh të familjeve drejt vendeve perëndimore. Refuzimi i lejeve të qëndrimit dhe kthimi prapa i një numri të madh të emigrantëve, lëvizjet e popullatës brenda vendit dhe mos pajisja me dokumente përkatëse kanë shkaktuar probleme në regjistrimin e fëmijëve në shkolla.³⁶

15

Kosova me 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë tejkalon shumëfish mesataren e Bashkimit Evropian.³⁷ Numri i studentëve në arsim të lartë është rritur nga rreth 40,000 studentë në vitin 2004 në 122,000 në vitin 2015. Kosova ka 6,669 studentë në 100 mijë banorë, që është, pothuajse, dyfishi i mesatares së BE-së.³⁸

2

³² <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkonsultimet.rks.gov.net%2FStorage%2FConsultations%2F14-54-14-17062022%2F1.-Draft-Strategjia-e-Arsimit-2022-2026-Sq.docx> (36 ur 25.06.2022)

³³ PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021, fq15.

³⁴ Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021, fq.42

³⁵ Po aty.

³⁶ Po 1.

³⁷ Të dhënat nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës, Eurostat dhe www.webometrics.info.(qasur më 10.10.2021).

³⁸ Të dhënat e Eurostat dhe MASHT 2015. (11.10.2021).

¹ Është rritur pjesëmarrja e femrave në arsimin e lartë në Kosovë. Tani 50.2% e popullsisë studentore janë femra. Në Kosovë ofrohet trajtim preferencial për regjistrim në arsimin e lartë për kandidatët e komuniteteve pakicë.³⁹

¹ Situata ekonomike në vend përshkruhet me ngecje në zhvillim ekonomik dhe rezulton me pamundësi për të krijuar vende pune. Ndërsa nevojat e tregut të punës mund të ndryshojnë shumë shpejtë me dinamikë shumë të madhe. Rëndësia e përmirësimit të kualitetit në arsimi dhe aftësimit dhe rritjes së nivelit të aftësive në mesin e shoqërisë, dhe e vënies së vëmendjes të mjaftueshme në mësimin gjatë gjithë jetës, nuk mund të nënveroset.⁴⁰

¹ Kosova po kalon një fazë të ndryshimeve të konsiderueshme shoqërore dhe në bazë të projekteve të popullsisë, pritet rënie e ndjeshme e numrit të nxënësve në nivelin fillor dhe të mesëm. Ulja e numrit të nxënësve ndikon në uljen e numrit të paraleleve në shkolla, zvogëlim të nevojës për mësimdhënës dhe numrin e shkollave. Në anën tjetër, migrimi nga fshati në qytet do të shkaktojë mbi ngarkesë më të madhe në shkollat urbane dhe numër të vogël të nxënësve sidomos në zona të largëta rurale. Këto ndryshime demografike ka të ngjarë të rezultojnë me nevojën për racionalizim domethënës të rrjetit të shkollave dhe mund të imponojnë nevojën për rishikim të planifikimit gjatë periudhës së zbatimit të planit të ri strategjik.⁴¹

Trajtimi i arsimit dhe edukimit në media sikurse edhe fusha të tjera për vitalitet të jetës në Kosovë ishte dhe mbetet fokus i medias. Kjo argumentohet për faktin që jo vetëm në edicione informative trajtohen këto probleme por ato kanë edhe hapësira të veçanta edituese dhe të prezantimit në të gjitha mediat elektronike e më parë edhe në mediat e shkruara sikurse edhe në media sociale. Për këtë në mediumin publik (RTK-ë) rubrikë e veçantë e arsimit është emisioni “ Kriter ” përmes së cilit prezantohet aktualiteti në arsimin e vendit në të gjitha nivelet.⁴²

Në fokus jo vetëm të institucioneve ishte dhe mbetet arsimi por edhe të medias sidomos kur kemi të bëjmë me sfidat të cilat e përcjellin arsimin sikur te rasti i mbylljes së shkollave në Komunë të Kamenicës me arsyetimin e aplikimit të reformës në arsim dhe për këtë në Komunën e Kamenicës

³⁶

³⁹ Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021 fq.29.

⁴⁰ Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021 fq.16.

⁴¹ Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021 fq.17.

⁴² www.rtk.kg. Emisioni Kriter kushtuar arsimit në Kosovë.

mbyllen 19 shkolla, kryesisht të mqediseve rurale duke aplikuar transportin deri në shkollën tjetër më të afërt për pasojë të mungesës së nxënësve dhe aplikimit të klasave të kombinuara.⁴³

Për këto dhe probleme të ngjashme pakënaqësitë ishin të pranishme tek familjar të nxënësve dhe te vetë nxënësit me rastin e mbylljes së objekteve shkollore dhe pati edhe protesta të nxënësve dhe prindërve. Një dukuri e tillë e zbrazjes së objekteve shkollore vjen si rezultat i emigrimit nga fshati në qytet, largimi nga vendi i qytetarëve të Kosovës dhe si pasoj e zvogëlimit të natalitetit.

Megjithatë edhe në Komuna tjera të Kosovës në mqedise rurale dukuria e zbrazjes së shkollave deri te mbyllja e tyre sikurse në malësinë e Gollakut në fshatin Prapashticë në lagjen Balaj shkolla është mbyllur, ndërsa në shkollën e fshatit “ Dëshmorët e vitit 1921 “ numri i nxënësve është rënë në mënyrë drastike dhe e gjithë shkolla ka 17 nxënës, dhe 24 anëtar të stafit që sipas trendit të emigrimit fshat - qytet mbyllja e shkollës është në prag.⁴⁴

Në anën tjetër në mqedise urbane kemi mbi popullim të numrit të nxënësve nëpër shkolla kryesisht në qytete më të mëdha. Në përgjithësi arsimi në vend sfidohet me probleme të evidentuara dhe pakënaqësi edhe të mësimdhënësve anëtar të sindikatës të cilët kërcënojnë institucionet me protesta, ndërprerje të procesit mësimor sidomos për shkak të pagave të pa mjaftueshme siç e thonë sindikalist të arsimit.⁴⁵

Krahas sfidave organizative në nivel qendror dhe lokal dy vitet e fundit 2020 - 2022 sfidat e situatës me infektime nëpër shkolla ka bërë që të kemi vijim të procesit mësimor me prani fizike, të kombinuar dhe nga distanca opsione këto të aplikuara sipas rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19.

I gjithë ky proces ishte i paraparë për të gjitha nivelet e arsimit në vend duke aplikuar masa e rreptë nga stafi organizativ i nivelit të arsimit të ulët, të mesëm apo të lartë.⁴⁶

Arsimimi dhe edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta do përkujdesje të veçantë për të cilën në Forumin për Aftësi të Kufizuar të Kosovës (FAFK) konsiderohet problem jetik i cili është duke u trajtuar në secilin takim dhe bashkëpunim me qeverinë e Kosovës dhe ministrinë e arsimit, në

⁴³ bisedë autoriale me Kryetarin e Komunës së Kamenicës Maj, 2021.

⁴⁴ Hulumtim autorial i trajtuar në mediumin publik RTK-ë

⁴⁵ Konferencë për shtypi SBASHKK-u. Prill, 2021.

⁴⁶ Intervistë me Dr.Sc. Behxhet Gaxhiqi, për Refleksion RTK-ë, 2021.

veçanti që të sigurohet stafi profesional i mësimdhënësve dhe përcjellësve të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla derisa viti 2022 në Kosovë është shpallur vit i aftësisë së kufizuar.⁴⁷

3.4. POLITIKATA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Ndër sektorët të cilët zënë vend në media në skemat e tyre programore është sektori i zhvillimit ekonomik i cili ndiqet hap pas hapi nga ana e medias me qëllim të prezantimit të zhvillimit të vendit si me emisione të dedikuara të kësaj fushe, programe tjera të sajaura për audiencën e gjërë dhe natyrisht edhe në edicione informative.

Media publike elektronike dhe ato komerciale më prestigjioze hiq ato të cilat emetojnë program kulturor dhe zbavitës angazhohen për të bërë publike edhe lajme që ndërlidhen me zhvillimin e Republikës së Kosovës duke prezantuar të arriturat dhe objektivat afariste zhvillimore si në planin individual po ashtu edhe në planin e organizimit si në: Oda Ekonomike dhe Aleanca të biznesit.⁴⁸

E gjithë tendencia përqendrohet te gjetja dhe inkurajimi i bizneseve për të prodhuar sa më shumë produkte për nevojat e tregut vendor dhe brenda mundësive shtuar edhe eksportin.

Emisionet si “Subvencion”, “Ekonomiks”, “Kosova prodhon”, “Refleksion” etj. në media tjera komerciale dhe përgatitja e kronikave televizive si për edicione informative po ashtu edhe për emisione enkas për zhvillimin ekonomik ndërlidhen për inkurajim të qytetarit dhe në përgjithësi të institucioneve dhe shtetit që rrita dhe zhvillimi i vendit në këtë rast Kosovës po avancon apo ka ngecje duke u ndaluar në mundësitë për të ndryshuar gjendjen socio - ekonomike në vend.

Planet dhe strategjitetë sikurse:

34
Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021, Prishtinë, janar 2016,

Plani i veprimit të strategjisë për vetëqeverisje lokale 2016-2026,

Strategjia sektoriale për shëndetësi 2017-2021, Prishtinë 2016,

⁴⁷ Intervistë me Bujar Kadriu, kryetar i Forumit të aftësisë së Kufizuar në Kosovë.

⁴⁸ Oda e Afarizmit Kosovar, Intervistë me Skender Krasniqi, Kryetar i OAK.

Programi për zhvillim rural dhe bujqësor 2014-2020 i Republikës së Kosovës etj.

Konsiderohen korniza për zhvillim të vendit të cilat i kontribuojnë objektivave zhvillimore të vendit. Krijimi i zonave industriale dhe mundësisë së investimeve duke krijuar infrastrukturë për të zhvilluar biznes si vendorët, apo përmes investimeve edhe ndërkontrollorë dhe bashkëkombës nga mërgata mundësojnë krijimin e oazave për hapjen e bizneseve të cilat njëherë duke investuar dhe punësuar zhvillojnë biznesin e tyre dhe Kosovën kur kemi para sysh që mundësia më e madhe për zhvillim të Kosovës janë investimet kapitale të biznesit privat.⁴⁹

Investimet në tregun energetik të energjisë përmes erës sikurse investimet në “ Kitkë ” është investimi i parë në Kosovë, konkretisht në Komunën e Kamenicës, nga Kompania Turke “ GURIS Holding ”²² e cila ka bërë investimin më të madh të energjisë me erë në Kosovë përbëhet prej 9 turbinave. Centrali i energjisë me erë ka filluar prodhimin nga data 11 tetor 2018 dhe është e hapur për operim komercial. Interesimi i prezantimit të mediave për këtë ngjarje si të parën e për zhvillim të energjisë së erës ishte substancial, ndërsa lajmi është prezantuar në të gjitha mediat publike dhe komerciale si elektronike edhe në të shkruara në Kosovë.⁵⁰

Investimet në energji të erës kanë vazhduar edhe në fshatin Selac të Shalës së Bajgorës. Kapaciteti i energjisë që do të prodhohet nga instalimi i 27 turbinave të erës do të jetë rreth 105 megavatesh në orë dhe pritet ti sigurojë Kosovës edhe 10% energji të ri përtritshme.²¹

Vlera totale e investimit është 170 milionë euro. Investimi po realizohet nga një kompani “ Sowi Kosovo ” me partnerët ndërkontrollorë. Ky projekt konsiderohet i rëndësishmit për sektorin e energjisë së ripërtritshme në Kosovë, janë duke marrë pjesë investitorë nga shtatë vende të ndryshme të botës, me Gjermaninë dhe Izraelin si partnerë kryesor.⁵¹

Zhvillimi ekonomik në Kosovë ka një gamë të madhe të shfrytëzimit të resurseve natyrore varësish zonave të vendit deri te turizmi rural i filluar në lartësitë mbidetare të Komunës së Artanës ish (Novo Bërd) rrëzë Kalasë si një atraksion i cili eksplorohet nga vizitor fillimisht ndërkontrollorë të pasuar edhe nga vendorët të cilët dita - ditës janë duke investuar në turizëm rural.

⁴⁹intervistë autorial me Sokol Haliti Kryetar i Vitisë, emision special “ Zonat Ekonomike mundësi për zhvillim socio-ekonomik”, RTK-ë, 2019.

⁵⁰shënim autorial, lajmet qendrore 19.30 RTK-ë, 11.10.2018.

⁵¹[https://www.syri.net/syri_kosova/ekonomi-lajme/170984/projekti-170-milionesh-ne-shale-te-bajgores-drejt-finalizimit/\(qasur më 15.10.2020\)](https://www.syri.net/syri_kosova/ekonomi-lajme/170984/projekti-170-milionesh-ne-shale-te-bajgores-drejt-finalizimit/(qasur-më-15.10.2020))

Ndërsa investime të ngjashme janë duke u shtrirë edhe në zona tjera të vendit kryesisht në ato të përshtatshme dhe atraktive për turizëm.⁵²

Investitorët potencial ndërkombe të bashkëkombës nga mërgata dhe biznesmen vendor konsiderohen mundësia më e shpejtë dhe më e mira për ngritje dhe ndryshim socio - ekonomik në Kosovë. Ndërsa prezantimi në media i kronikave të suksesit në fushën e investimeve inkurajon të rinjtë për mundësi punësimi.

3.5. POLITIKAT BUJQESORE

3

Bujqësia si degë ekonomike, e cila ka impakt direkt dhe të tërthortë në biodiversitet. Ky sektor ka kontribuar në vitin 2004 me 25% në prodhimin e përgjithshëm vendor PPV, (19% në vitin 2005). Rreth 53% (585.000 ha) janë tokë e punueshme, 42% (464.800 ha) pyje dhe toka pyjore dhe 5% tjera. Nga vlerësimet e bëra nga MBPZHR-ë (2008) del se rreth 60% e popullsisë së Kosovës jeton në vise rurale.⁵³

Bazuar në të dhënat e vitit 2008, rreth 50% e fermave janë ferma të vogla (deri në 1 ha). Struktura tepër e fragmentuar e parcelave të tokës bujqësore pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale/intensive. Ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore të degraduara nga aktivitetet minerare ku mbeturinat industriale me përbajtje të lartë të metaleve të rënda ndikojnë në cilësinë e prodhimeve bujqësore. Gjithashtu edhe mbeturinat tjera paraqesin një kërcënim të madh për humbjen e tokës bujqësore. Si rezultat i kësaj pjesa e madhe e tokës së zënë nuk përdoret për qëllime bujqësore.⁵⁴

Sikurse në secilin sektor të zhvillimit të politikave edhe në bujqësi janë një gamë e madhe e këtyre politikave të cilat kanë për synim planifikimin dhe krijimin e mundësive dhe lehtësimeve financiare në mënyrë që Kosova të ketë ndryshim të shifrave të importit duke u mbështetur në linjat buxhetore dhe mbështetjen e fermerëve.⁵⁵

⁵² shënim autorial, (dt, shtator 2021).

⁵³ Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, 2014.

⁵⁴Strategji e Kosovës për Mjedisin SMM 2013 – 2022.fq33.

⁵⁵https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F12256835%2FKonceptet_baz%C3%AB_t%C3%AB_zhvillimit_ekonomik(qasur 1.11.2021)

28

Në këtë shtrirje Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) në nivelin qendror të qeverisjes në bashkëpunim me nivelin lokal aplikon bashkërendimin institucional, ndërsa kornizat për zhvillim i bazon:

10

Propozon, krijon dhe siguron zbatueshme rinë e politikave bujqësore;

Përgatitë Programin për Pagesat Direkt (subvencionet);

Propozon, harton dhe siguron zbatimin e legjislacionit në fushën e bujqësisë;

Ministria propozon, harton dhe siguron zbatimin e procedurave dhe rregullave për prodhimtarinë bimore dhe blegtore mbështetur në standardet e cilësisë së prodhimeve bujqësore, në pajtim me legjislacionin përkatës;

Ofron mbështetje në promovimin e prodhimeve vendore, përmes organizimit të ditëve fushore, panaireve, si dhe manifestimeve tjera tradicionale;

Bashkëpunon me MTI dhe Doganën në çështjet tregtare dhe regjimin doganor të prodhimeve bujqësore dhe ushqimore;

Krijon politika dhe siguron zbatimin e standardeve për mbrojtjen e bimëve dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve dhe dëmtuesve karantinor;

Pranon dhe shqyrton dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e Bimëve (PMB-të), Plehrave Artificiale dhe Varieteteve për katër kultura bujqësore (grurë, elb, patate dhe misër);

Bën pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për licencimin e subjekteve për agro - inputet bujqësore;

Shfrytëzimi i tokave dhe regjistrimi i tyre të vendosur në skemë përkrahëse sipas dëshmisi së pagesave për njësi të sipërfaqe dhe një treg funksional të tokës.⁵⁶

Trajtimi i problematikave bujqësore në mediat Kosovare me qëllim të shpërfaqjes së objektivave për rimëkëmbje ekonomike duke u bazuar në dy asete siç është fuqia punëtore dhe toka për

26

⁵⁶<https://www.mbpzhr-ks.net/sq/departamenti-per-politika-bujqesore-dhe-tregjeve> (qasur 15.11.2021).

zhvillim të bujqësisë,⁵⁷ si mundësi më e lehtë dhe më e afërt për punësim dhe ngritje ekonomike në vazhdimësi përmes kronikave problemore dhe emisioneve të përgatitura për bujqësinë sidomos në mediumin publik dhe mediume tjera komerciale ka bërë që ky problem të trajtohet.

E për trajtimin e tij nga secili sektor i bujqësisë, “ Lajmi i keq është lajm i mirë “ ishte i pranishëm në media për faktin që kërkesat e fermerëve ishin të shumta dhe për këtë ishin organizuar edhe marshime protestuese me makineri bujqësore para objektit të Ministrisë së Bujqësisë.⁵⁸

T ‘kurja e tokave bujqësore mbetet problem i shumë folur e asnjëherë i ngritur në shkallë më të lartë të mbrojtjes nga institucionet përkatëse, ndërsa degradimi gjithnjë e më tepër i shtuar duke e ndërruar de stinimin e tokës bujqësore me privatizimin e saj edhe duke e copëzuar nga toka bujqësore në tokë për ndërtim, objekte afarizmi etj.⁵⁹

Trajtimi i problematikave të tillë dhe të shumta si në emisionin “ Bujku “, “ Agro “, “ Refleksion ” dhe në edicione të ndryshme informative kanë për qëllim sensibilizimin e problemit të politikave bujqësore në Kosovë të cilat nuk janë të favorshme dhe vit pas viti vërehen pasojat e degradimit dhe të mos arritjes së sigurimit të ushqimit primar për kulturë të grurit e misrit që janë strategjike për njerëz dhe bagëtinë të cilat në mënyrë drejtpërdrejt dhe indirekt ndikojnë në probleme shoqërore.⁶⁰

Ndër problematikat të cilat evidentohen nga mediat për mos zhvillim të bujqësisë janë in putet jo cilësore, farërat, plehrat, pajisjet agroteknike të vjetruara sikurse edhe çmimet e larta të derivateve etj.⁶¹

Problematika të tillë të kësaj natyre për zhvillimin e bujqësisë dhe dekonspirimi i rinisë për tu marrë me bujqësi për pasoj të mos perspektivës dhe humbjeve të mundshme për shkak të jo stabilitetit të tregut dhe krizave të vitit 2019, 2020, 2021 për të vazhduar edhe në vitin 2022 siç janë pandemia Covid-19, kriza energjetike dhe lufta në Ukrainë ka bërë që të ngrihet përkushtimi institucional qeveritar që të ketë mbështetje në pagesa të drejtpërdrejta për fermer në mënyrë që të

⁵⁷ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.mbpzhr-ks.net%2Fsq%2Flajmet%2Fbashkepunimi-nemes-nivelit-qendror-dhe-atij-lokal-sjell-politika-efektive-bujqesore> (qasur 16.11.2021).

⁵⁸ Kronikë televizive e përgatitur lajmet qendrore 19.30 RTK-ë.(21.10.2020).

⁵⁹intervistë, Prof.Dr. Shukri Fetahu Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë.

⁶⁰ https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkipdf.com%2Frevist-studimore-shkencore_5aad04151723ddf3554a75b3.html(qasur 12.12.2021).

⁶¹intervistë me Valon Vehapi fermer, www.rtklive.com, emisioni “ Refleksion “(7.10.2021).

inkurajohen fermerët⁶² për të punuar tokën dhe siguruar artikujt esencial ushqimor sa më shumë nga prodhimi vendor.

E gjithë kjo argumentohet për pasoj të çmimeve të larta dhe jo stabilitetit të tregut deri te bllokimi, përkatësisht ndalimi i eksportit të artikujve ushqimor esencial nga vendet me prodhim më të shtuar për vende të cilat janë importuese të produkteve ushqimore.

Ulja e hektarëve të mbjellë me grurë, numri i vogël i kërave të bagëtisë dhe shpezëve bën që Kosova të jetë vend importues. Nga 1 deri më 31 Mars 2020 me paraqitjen e pandemisë Covid-19 dhe nga paniku i qytetarëve dhe kërkeseve enorme për të siguruar miell të mjaftueshëm, importuesit Kosovar sollën rrëth 30 milion kilogram miell, drithëra të grurit dhe misrit, ndërsa në vitin 2021 u importuan 42 milion kilogram mish të shpezëve nga vende kryesish nga Amerika Latine.⁶³

Ndryshimi socio - ekonomik dhe stabiliteti i një shteti mund të bazohet me prodhim të shtuar vendor i cili ulë importin dhe në anën tjetër sigurohen prodhime të garantuara me cilësi të pa dyshimtë të cilat mundësojnë të kemi më pak probleme të caktuara edhe në shëndetësi.⁶⁴

Sipas ekspertëve të bujqësisë krijimi më i lirë i një vendi pune mund të realizohet në sektorin e bujqësisë, ndërsa interesimi është i vogël në këtë drejtim. Ngritja e fermave të lopëve qumështore, viçave për majmëri dhe ngritja e qumështoreve nuk ka arritur të përmbrush nevojat e qytetarëve derisa në tregun e Kosovës kemi qumësh dhe prodhime të qumështit nga vende të ndryshme, ndërsa prodhimet vendore edhe ato pak sa prodhohen mbeten të pa shitura si pasojë e dy faktorëve: Cilësisë së dobët të prodhimeve vendore apo mungesa e nacionalizmit në ekonomi për të konsumuar produkte vendore e që tash e 18 vjet është iniciuar edhe nga Aleanca Kosovare e Biznesit që të konsumojmë prodhime vendore duke aplikuar fushata “ Unë konsumoj prodhime vendore, po ju “.⁶⁵

⁶²<https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.facebook.com%2Fgroups%2F377724052412562%2Fposts%2F680171612167803%2F>(qasur 15.10.2021).

⁶³Doganat e Kosovës, intervistë me zëdhënësin Adriatik Stavileci, RTK-ë lajmet qendrore, (8.09.2021)

⁶⁴intervistë prof. Dr. Imer Rusinovci Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë,(8.09.2021)

⁶⁵ Agim Shahini,Aleanca Kosovare e Biznesit. Deklarim në konferencë për media,(12.09.2021)

Prodhuesit vendor të sektorit të bujqësisë ndjehen të dekurajuar, ndërsa për të shtuar shpresën që të punohet në sektorin e bujqësisë institucionet qeveritare përmes pagesave të drejtpërdrejta mbështetëse në shumë sektorë dhe nën sektorë ndajnë mjete për fermerë si:

Për një hektar rrush ndahen 1.000 € mbështetje, për një hektar grurë 474 € e shumë kultura tjera bujqësore. Kurse garantët dhe subvencionet janë bërë mollë sherri, ndërsa numër i konsideruar i zyrtarëve të bujqësisë janë të dyshuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, mito dhe korruption, ndërsa fermerët të cilët në pronësi të tyre kanë bagëti për secilën krerë të bagëtive të matrikuluar (registruar) mbështeten nga drejtoretë Komunale për bujqësi dhe zhvillim rural.

Shqetësuese në bujqësi, perime kultura dhe pemëtari mbeten sigurimet e prodhimeve bujqësore, ndërsa bujqësia konsiderohet hambar pa kulm e cila do trajtim më serioz në mënyrë që Kosova të jetë më e qëndrueshme në aspektin socio - ekonomik duke prodhuar artikuj ushqimor për njerëz dhe qenie të gjalla të saj, problem i cili është trajtuar, trajtohet dhe sensibilizohet në të gjitha mediat e Kosovës, si publike, komerciale dhe sociale.⁶⁶

Me qëllim të shtimit të produkteve bujqësore dhe uljen e shifrave të importit të produkteve bujqësore vit pas viti është shtuar buxheti i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). ³⁹ Sipas tij, konceptit të risive në programin e pagesave direkte, “ Për herë të parë që nga paslufta, fermerëve dhe bujqve tanë do t'i subvencionohet nafta në vlerë prej rreth 5 milionë euro, duke ia subvencionuar vlerën prej rreth 0.36 cent për litër naftë të përllogaritur me hektarë të poseduar të tokës së punuar ”⁶⁷.

“ Një herësh me vlerë 8 milionë euro për grurin, misrin, fasulen dhe pataten do të subvencionojmë in putet bujqësore për plehërim pranveror në vlerë prej 150 € për hektarë. Ndërsa me nga 100 € për hektarë për misrin, fasulen dhe pataten. Do të ketë edhe rritje të mbështetjes për grurë me 474 € për hektarë, 324 më shumë se vitin e kaluar, do të ketë 119 % më tepër rritje të mbështetjes për misër për dallim me vitin e kaluar, 118 % më tepër mbështetje për patate e fasule ”⁶⁸.

⁶⁶hulumtim autorial për fushën e zhvillimit në sektorin e bujqësisë, emisioni Refleksion RTK-ë,20.11.2021

⁶⁷ Qeveria e Republikës së ³⁹sovës- Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

⁶⁸ <https://teve1.info/lajmet/50-milione-euro-per-subvencione-ne-bujqesi-5-milione-prej-tyre-per-naften-e-fermer>.

3.6. POLITIKAT MJEDISORE

3

Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit (SMM) konsiderohet si pjesë e strategjisë afatgjate të zhvillimit të vendit. Zhvillimi social dhe ekonomik mund të shkoj krahas me një mjeshtësi të shëndoshë.⁶⁹

3

Strategja për Mbrojtjen e Mjedisit paraqet hap të rëndësishëm, ku për herë të parë, çështjet e mjedisit do të përcaktohen dhe planifikohen si koncept afatgjatë. Kjo është gjithashtu e përcaktuar qartë në Kushtetutë, Kapitulli II-të për të Drejtat dhe Liritë Themelore, Neni 52 thotë:

1. Natyra dhe biodiversiteti, mjeshtësi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

2. Institucionet publike angazhohen për t'i garantuar për secilin qytetar mundësinë të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjeshtësin jetësor.

3

3. Veprimet në mjeshtësin jetësor duhet të merren parasysh në procesin e marrjes së vendimeve.⁷⁰

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është përgjegjëse për hartimin e (SMM) dhe korniza ligjore është përcaktuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr.03/L-025 nen 20 dhe 21. SMM-ë bëhet për një periudhë 10 vjeçare me mundësi rishikimi çdo pesë vite, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave, si rezultat i zhvillimeve të reja sociale, ekonomike dhe politike. SMM-ë (2013 – 2022) është rishikim i Strategjisë së Kosovës për Mjeshtësin dhe zhvillimin e qëndrueshëm (2005 - 2015).⁷¹

Politikat mjeshtësore përqendrohen në ajrin, ujin dhe tokën faktorë të cilët janë esencial për zhvillimin e jetës dhe ndikojnë në jetën e njeriut, ndërsa për këtë mediat iu kanë përkushtuar sensibilizimit të problemeve mjeshtësore në hapësira të ndryshme programore të cilat kanë për qëllim sensibilizimin e opinionit publik për ruajtje të mjeshtësit duke përcjell secilin aktivitet institucional vendor ndërkontekstual ose edhe të OJQ-e.⁷²

3

⁶⁹Treguesit e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Udhëzimet dhe Metodologjitet, 2001, Nju Jork, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm.

⁷⁰Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 55,2008.

⁷¹Strategjia e Kosovës për Mjeshtësin SMM, 2013 – 2022.MMPH,Kosovë.

2

⁷²<https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkonsultimet.rks.gov.net%2FStorage%2FConsultations%2F15-21> (qasur 17.12.2020).

9

Niveli i cilësisë së ajrit në muajt e verës (Qershori, Korrik, Gusht) është pothuajse tre herë më i mirë se ai i muajve të dimrit (Nëntori, Dhjetori, Janari). Gjatë muajve të dimrit tema e ndotjes së ajrit është më e popullarizuar. Ndërsa ndotës më të mëdhenj do të konsiderohen prodhimi i energjisë elektrike nga qymyri, makinat dhe ekonomitë familjare.

Përveç matjeve të cilësisë së ajrit nga ambasada amerikane, ekzistojnë edhe matjet e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) për disa qytete. IHMK-ë ofron të dhëna më të shpeshta për Prishtinën, Obiliqin, Drenasin dhe Hanin e Elezit, vende këto me interes të veçantë për shkak të ndotësve potencial që ndodhen afér tyre.⁷³

Kur flasim për ndotjen e ajrit, e rëndësishme është të identifikohen ndotësit potencial dhe me identifikimin e tyre dhe aplikim të masave mund të kemi zvogëlim të ndotjes së ajrit. Shfrytëzimi i lëndëve fosile për ngrohje shton ndotjen dhe kjo vjen si rezultat i uljes së temperaturave dhe nevojës për ngrohje gjatë muajve të ftohtë të vitit.(Balaj, 2022,f.28).

9

Sipas një studimi të Bankës Botërore dhe EPTISA, ekonomitë familjare konsumojnë përafërsisht 48% të gjithë energjisë në Kosovë; ndërsa, 45% e kësaj energjie të konsumuar nga ekonomitë familjare vjen nga djegia e drurëve.⁷⁴

14

Gjatë stinëve të vjeshtës dhe dimrit, Kosova dhe sidomos kryeqyteti Prishtina, ishin në krye të qyteteve botërore me ndotjen më të lartë të ajrit. Përveç termocentraleve që furnizonin tregun më të madh në vend me energji e cila sigurohet përmes djegies së thengjillit, vulturat e vjetra në qarkullim ishin potencuar si shkaktari kryesor i kësaj ndotjeje. Pavarësisht këtyre faktave, deputet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe Infrastrukturë në Kuvendin e Kosovës kanë miratuar propozimin për ndryshimin e disa neneve të ligjit për automjete.⁷⁵ Importi i veturave në Kosovë

⁷³gap memo nëntor 2017 Shkaqet e ndotjes së ajrit në Prishtinë, fq.4.

9

⁷⁴(EPTISA, and World Bank. 2013. National Building Energy Efficiency Study for Kosovo siç është cituar nga Krajnc et al.. 2015. Wood Biomass Sector In Kosovo: Woodfuel Integrated Supply/Demand Overview Mapping (WISDOM),(qasur 01.03.2022).

2

⁷⁵<https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.evropaelire.org%2Fa%2Fvendi-me-ndotjen-m%25C3%25AB-t%25C3%25AB-lart%25C3%25AB-t%25C3%25AB-ajrit-synon-importin-e-veturave-t%25C3%25AB-vjetra%2F29333213.html> (qasur 01.04.2022).

14

paraqitet në nenin 44, në të cilin thuhet se të gjitha mjetet rrugore që importohen në Kosovë nuk mund të jenë më të vjetra se 10 vjet.⁷⁶

30

Ish Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, është shprehur kundër miratimit të amendamentit të ligjit për automjete, i cili përcakton vjetërsinë e importit të veturave nga 10 vjet sa ka qenë më parë në 15 vjet. Të gjitha gazrat e liruara nga termocentralet , veturat apo ngrohja në amvisëri etj. Është periudha e cila përfshinë Prishtinën.⁷⁷

19

Përveç ndotjes së ajrit, kontaminimi i tokës mund të shkaktojë kontaminim serioz mjedisor, kontaminim të lumenjve nga shkarkimi i aciditetit të lartë nga minierat dhe metalet e rënda dhe probleme serioze shëndetësore. Lokacionet e kontaminuara në Kosovë janë kryesisht të pa menaxhuara, megjithatë Kosova e ka realizuar një inventarizim fillestar të asaj që i konsideron lokacione posaçërisht të rëndësishme të quajtura “ pika të nxehta ”. lokacionet që kontaminojnë ambientin në koosvë llogaritet të jenë 200. Kostoja totale e veprimeve në lokacion për ta menaxhuar tërë kontaminimin e mbetur të tokës në Kosovë përllogaritet të jetë 345 miliona € gjatë 20 viteve.⁷⁸

19

Ndërsa njëri ndër projektet “ Ta pastrojmë Kosovën “ pati gjetur përkrahje në mediat Kosovare ku aktivist të ambientit u përcollën nëpër mjedise të ndryshme si në Vushtrri, Viti etj. ndërsa media publike dhe lokale përcollën këto aktivitete për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave.⁷⁹

Hiq më e mirë nuk qëndron situata edhe më ndotjen e lumenjve të cilët ndoten nga materie kimike të ndryshme, ndërsa lumenjtë të cilët kishin pasur më herët peshq me ndotjen e tyre japin pamje rrëqethëse të peshqve të ngordhur. Problem ky i trajtuar si nga mediat elektronike po ashtu edhe të shkruara me qëllim të sensibilizimit të problemit i cili do zgjidhje akute. Njëherësh shfrytëzimi i rërës nëpër lumenj dhe prishja e shtratit të lumenjve është konsideruar problem për të cilin

⁷⁶<https://www.evropaelire.org/a/vendi-me-ndotjen-m%C3%AB-t%C3%AB-lart%C3%AB-t%C3%AB-ajrit-synon-importin-e-veturave-t%C3%AB-vjetra/29333213.htm>, qasur 01.07.2022).

⁷⁷<https://klankosova.tv/automjetet-e-vjetra-nder-shkaktaret-kryesore-per-ndotjen-e-ajrit/>, qasur 04.03.2021).

⁷⁸<http://www.ekonomia-ks.com/sq/bujgesi/ndotja-e-ajrit-dhe-ndotja-e-tokes-ne-kosove-duhet-te-adresohen-urgjentisht>, qasur 03.03.2020).

⁷⁹shënim autorial, intervistë me Mentor Merovci, aktivist i ambientit, Vushtrri, (2021).

institucionet e vendit janë detyruar të intervenojnë në raste dhe vende të ndryshme të Kosovës. Sikurse edhe derdhja e ujërave të zeza në lumenj e përroska.⁸⁰

Ndërsa pastrimi i ambientit nga mbeturinat dhe trajtimi i tyre nuk përkon me aplikim të standardeve dhe seleksionim të mbeturinave të cilat përfundojnë në një vend të caktuar, ndërsa kompanitë të cilat merren me trajimin e tyre herë pas herë janë të zëshme për pakënaqësitë e realizimit të pagesës së borxheve nga qytetarët dhe kështu vihen në pozitë të pavolitshme duke mos pasur mundësi për sigurimin e investimeve në makineri dhe pajisje duke u krijuar probleme edhe për paga për të zënët me punë në kompanitë e tyre të pastrimit.⁸¹

Ish kryetari i Prishtinës Shpend Ahmeti, mbeturinat në Prishtinë i ka quajtur aset duke iu referuar të dhënavë shkencore për mjedisin që një banor brenda 24 orëve krijon 0.6 deri 0,8 kilogram mbeturina. Sipas Ahmetit në takim me përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KFW) u bisedua për mundësinë e bashkëpunimit në projektin për menaxhimin e mbeturinave, lidhur me dy komponentë: Ndërtimin e një deponie të re dhe investimin në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në këtë sektor.⁸²

3.7. POLITIKAT E INTEGRIMIT DHE POPULLIMIT

Bashkimin Evropian (BE) është synim për Kosovën edhe përkundër sfidave në këtë proces të rëndësishëm i cili mund ti shërben të ardhmes së vendit në familjen e madhe Evropiane në të gjitha sferat zhvillimit institucional dhe legjislativ i cili mund ti kontribuoj këtij synimi.

Sa më afér BE-së, kjo qasje vetëm sa do të sforcohet. Prandaj edhe nevoja për të adaptuar politika përkatëse të cilat do ta intensifikojnë procesin prioritet që duhet adresuar.⁸³

⁸⁰ www.rtk.live.com, shënim autorial për ngordhjen e peshqve në lumin Sitnicë në Obiliq.

⁸¹ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fpresident-ksgov.net%2Fsq%2Fzyra-dhe-funksioni> qasur 04.04.2022).

⁸² <https://gazetainfokus.com/shpend-ahmeti-kerkon-perkrahjen-e-gjermaneve-per-menaxhimin-e-mbeturinave/> qasur 19.04.2022).

⁸³ Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave Seria e analizave politike : Punimi 3,fq3.

Shpesh krijohen situatat me densitet të lartë, kur ka një numër të madh njerëzish në një zonë të vogël(Dragoti,2004,f. 77).

Megjithatë popullimi pas rrethanave të reja në Kosovë i filluar që nga pas lufta e vitit 1999 vazhdon edhe në vitet në vijim duke emigruar nga zonat rurale në ato urbane dhe kështu gradualisht krijohen mjedise urbane të popullimit dhe zbrazje të zonave rurale ku kanë mbetur fshatra të boshatisura dhe me shumë pak banorë të cilët janë të shtyrë në moshë ndërsa gjeneratat e reja janë në mjedise urbane brenda vendit dhe të emigruar edhe jashtë vendit kryesisht në vende euro perëndimore.⁸⁴

Problemet socio - ekonomike të krijuara për shkak të dëmeve të luftës dhe në mungesë të infrastrukturës i kanë shtyrë banorët e zonave rurale të emigrojnë në qytete ku mundësitetë për ekonomizim, shëndetësi dhe shkollim i kanë më të mira.

Largimi nga fshatrat drejt qyteteve ka ngritur shqetësim edhe në mes prindërve dhe pasardhësve të tyre të cilët duke u ngritur në aspekt profesional janë larguar nga mundësitetë e zhvillimit të bujqësisë dhe blektorisë. Ndërsa gradualisht me kalimin e kohës dhe gjetjes së opsjoneve për të përfituar mbështetje institucionale rikthimi në fshat është vetëm për biznes dhe turizëm duke shfrytëzuar hapësirat ekologjike dhe jo vetëm fshati është boshatisur, qytezat periferike të Kosovës në mungesë të opsjoneve për punësim banorët e tyre kryesisht rinia janë të orientuara drejt qendrave më të mëdha ku shpresojnë për kushte edukimi, punësimi dhe zhvillimit të jetës.

Kontributi i medias për të pasqyruar problemin e emigrimit është i pa diskutueshëm megjithatë ekspert të fushës emigrimin fshat qytet e shohin si problem i cili ka efektin domino edhe përkundër problematikave banesore që ata që emigrojnë jo të gjithë e kanë të rregulluar çështjen banesore dhe punësimin të cilin e shpresojnë se duke gjetur punë private më shumë informale sesa të rregullt do të mund të jetojnë në kushte më të lehta sesa nga vijnë duke e arsyetuar emigrimin si domosdoshmëri për pasardhësit e tyre për çështje të shkollimit.⁸⁵

⁸⁴https://google.com/url?sa=D&q=http%3A%2F%2Fwww.ilo.org%2Fwcmsp5%2Fgroups%2Fpublic%2F%40europ e%2F%40ro-geneva%2F%40sro-budapest%2Fdocuments%2Fpublication%2Fwcms_168326.pdf (qasur 01.06.2019).

⁸⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.dukagjini.com%2Fa-do-te-largohen-serbet-nga-institucionet-e-kosoves%2F> (qasur 01.03.2022).

Faktorët shtrëngues që i nxisin në masë të madhe, sidomos të rinxjtë, por edhe familje që të braktisin zonat rurale të tyre dhe t'ua mësyjnë qyteteve me shpresë se atje do të gjejnë të ardhme për punë, shkollim.⁸⁶

Por, faktorët atraktiv të qyteteve nuk janë ashtu siç është pritur dhe çfarë është shpresuar pas përfundimit të luftës, sepse kemi të bëjmë me një zhvillim të paqëndrueshëm të kapitalizmit në Kosovë",⁸⁷

25

Viteve të fundit, një nga sektorët që është mbështetur më shumë nga qeveria dhe pushteti komunal është bujqësia. Por, edhe ky subvencionim nuk e ka ulur shpërndarjen dhe dëshirën e qytetarëve për t'u larguar drejt qyteteve.⁸⁸

18

Sipas matjeve të popullsisë në vitin 2019, numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të këtij viti është vlerësuar gjithsej 1,782,115 banorë rezident numër i cili është marrë si e dhënë bazike për të vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2020. Sipas të dhënave preliminare numri i lindjeve të gjalla për vitin 2020,⁸⁹ qe kishin deklaruar si vendbanim rezident Kosovën ishte gjithsej 27,709 lindje. Bazuar në të dhënrat preliminare numri i rasteve të vdekjeve në vitin 2020 qe kishin deklaruar vendbanimin rezident në Kosovën ishte gjithsej 14.457 raste të vdekjeve. Nataliteti i popullsisë në Kosovës gjatë vitit 2020 është rritur për 13,252 banorë.⁹⁰

Referimi i të dhënave institucionale dhe trajtimi i tyre në media mundëson hapjen e shtigjeve për ngritje socio - ekonomike dhe orienton mundësitë për planifikim dhe zhvillim të bizneseve të cilët duke analizuar gjendjen demografike në Kosovë mund të kontribuojnë për mirëqenie, përfitimin e tyre dhe për ngritje socio - ekonomike në Republikën e Kosovës.

2

⁸⁶ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.evropaelire.org%2Fa%2Fqytetet-fshatrat-kosova%2F30081494.html> (qasur 01.03.2022).

⁸⁷ <https://www.evropaelire.org/a/qytetet-fshatrat-kosova/30081494.html> (qasur 01.06.2021).

⁸⁸ <https://www.evropaelire.org/a/qytetet-fshatrat-kosova/30081494.html>. (qasur 05.05.2022).

2

⁸⁹ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Finsajderi.com%2Fdallimet-e-natalitetit-mes-kosoves-dhe-serbis%C4%A3.> (qasur 06.05.2022).

⁹⁰ ASK - vlerësimi i popullsisë 202011

3.8. POLITIKAT E MIGRIMIT

Politikat migrimit ndryshuan situatën socio - ekonomike dhe familjare në Kosovë. Numri i anëtarëve të familjeve zvogëlohej si pasoj e migrimit i cili kryesisht ndodh për pasoj të pa punësë si problem primar dhe më pas bashkimit familjar dhe më pak për arsyet tjera si p.sh studim etj.

³² Demografi Rifat Blaku, për Radion “ Evropa e Lirë “ thotë se këto shifra tregojnë se popullsia e Kosovës po tkurret ndër vite. Duke pasur parasysh këtë gjendje, Kosova duhet ta trajtojë problemin e migracionit dhe rënien e natalitetit. “ *Largimi nga vendi dhe rënia e lindjeve, janë dy faktor dhe sfida më të rënda të shoqërisë Kosovare, meqë bëhet fjalë për tkurrjen e popullsisë si kapital më i shtrenjtë kombëtar* ”.⁹¹

“ Sipas matjeve demografike dhe në bazë të lëvizjes së popullsisë aktuale që është në manifestim, do të dalim përsëri një numër më i vogël. Në këtë situatë duhet të kërkohen formularët e rinj për regjistrimin e popullsisë dhe të hyjë edhe rubrika për kontingjentin e popullsisë në migracion, respektivisht të shfrytëzohet rasti që jo vetëm popullsia rezidente që punon dhe jeton në Kosovë, por edhe pjesëtarët e shoqërisë shqiptare në migracion, që të dihet numri i përgjithshëm ”.⁹²

⁴⁵ Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) vlerësohet se pjesa dërmuese e emigrimit në vite, kishte përfshirë grup moshat e reja kryesisht 25 - 44 vjeç.⁹³

¹³ Numri i qytetarëve të Kosovës që jeton jashtë vendit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), deri në fund të vitit 2018, vlerësohet të jetë mbi 850 mijë banorë. Në bazë të projeksjoneve demografike dhe në bazë të qarkut të emigrimit aktual në regjistrimin e mundshëm të popullsisë të viti 2021 Kosova do të kishte numër më të vogël të popullsisë nga 1.7 milion, sa ishin në regjistrimin e fundit të vitit 2011. Ikja, braktisja së bashku me rënien e lindjeve janë dy ngjarje, më të rënda të shoqërisë meqë bëhet fjalë për tkurrjen e popullsisë, kapitalit më të shtrenjtë. Andaj duhet të hyjnë planet e zhvillimit të mesëm dhe afatgjatë. Institucionet e Republikës së

⁹¹ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.evropaelire.org%2Fa%2Fkosove-ikja-e-qytetareve-%2F30393235.html>(qasur 12.07.2021).

⁹²Blaku.R. www.evropalirë.org. (qasur 15.08.2021).

⁹³[https://gazetablic.com/tkurret-ndjeshem-numri-i-popullsise-ne-kosove/.\(qasur 01.09.2022\).](https://gazetablic.com/tkurret-ndjeshem-numri-i-popullsise-ne-kosove/.(qasur 01.09.2022).)

Kosovës, duhet që dekadën 2020-2030 ta shpallin si dekadë të krizës, respektivisht të ndërgjegjësimit demografik.⁹⁴

Largimi i të rinjve jashtë vendit dhe numër i vogël i lindjeve në Kosovë ndërlidhet me gjendjen e rëndë ekonomike. Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Arsimit, këtë vit shkollor Kosova ka afro 29 mijë nxënës më pak sesa para 5 vjetëve.⁹⁵

Me qëllim të mbështetjes së lehtësimeve të procedurave kufitare dhe pritjeve të gjata gjatë ditëve kur bashkëkombësit vijnë nga kurbeti Qeveria e Kosovës merr qëndrim që nga datë 01.07.2021 deri 31.12.2021 të heq taksën për policën e sigurimeve të automjeteve të mërgimtarëve, taksë kjo prej 15.00 €. Ndërsa qeveria merr qëndrim që të mbuloj këtë taksë e cila sipas analizës së zyrtarëve neveritar të Kosovës do të jetë rreth 6 milion €. Ndërsa lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës zëra opozitar dhe shoqëria civile e kundërshtuan këtë vendim të Qeverisë së Kosovës.⁹⁶

Kontributi i mediave për prezantim të vlerave të bashkëkombësve të migruar vlerësohet të jetë shembull i mirë i bashkëveprimit institucional për të ndikuar tek qytetarët Kosovar pavarësisht pse jetojnë dhe punojnë jashtë vendi ata janë pjesë e atdheut, ndërsa motoja e institucioneve të vendit,⁹⁷ krijimi i ministrisë së diasporës nënkupton që krahas sfidave mërgata Kosovare konsiderohet krahu i djathtë i zhvillimit të vendit.

Aktivitet e diasporës je vetëm në diasporë por edhe në vend përcillen me korrektësi maksimale duke përgatitur edhe ditë të veçanta nëpër komuna të vendit si “ Ditët e Diasporës ”, ndërsa realizimi i emisioneve speciale kushtuar diasporës por edhe të rregullta në mediat vendore sikurse te mediumi publik RTK-ë emisioni “ Zëri Ynë ”, “ Linja Shqip ” dhe përcjellja e aktiviteteve edhe me edicione informative dhe programe tjera në skema programore në mediumin publik.

⁹⁴ Refleksion “, RTK-ë, Shkurt 2020.

⁹⁵lajme 365 portal informative.2020.

⁹⁶www.rtklive.com, lajmet qendrore 19.30, 24.06.2021.

⁹⁷ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Faa.com.tr%2Fal%2Fnews%2F490579--ne-kosove-shenohet-dita-nderkombetare-e-romeve-komunitetit-me-te-margjinalizuar-ne-bote\(qasur 05.05.2022\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Faa.com.tr%2Fal%2Fnews%2F490579--ne-kosove-shenohet-dita-nderkombetare-e-romeve-komunitetit-me-te-margjinalizuar-ne-bote(qasur 05.05.2022).)

Angazhimi institucional dhe vizitat e përfaqësuesve të ministrisë së diasporës dhe asaj të arsimit në diasporë kanë gjetur mbështetje te mediat për përcjelljen e aktiviteteve si në vajte ardhje dhe ekskursione me karakter mësimor “Orë e gjatë mësimi” si në vendet etnike nga e kanë prejardhjen shqiptarët në diasporë si në Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Kosovë me nxënës dhe mësimdhënës shqiptar dhe gjerman, po ashtu edhe në shkolla shqipe dhe të kombinuara edhe në Gjermani ku fëmijët shqiptarë krahas mësimit në gjuhën gjermane mësojnë edhe në mësimin plotësues në gjuhën shqipe.⁹⁸ Furnizimi me literature në gjuhën shqipe nga MASHT për nxënës dhe mësimdhënës bën që institucionet e vendit janë përkushtuar që të ruhet bërthama e gjuhës dhe kulturës shqiptare në mërgim.⁹⁹ Krahas kësaj bashkëkombësit me remitencat e tyre i kanë kontribuar ngritjes socio - ekonomike vendit duke investuar për vete, familjet e tyre, në aktivitet humanitare individualisht edhe përmes organizatave humanitare si për çështje shëndetësore, arsimore, mirëqenies, ngritjes së kushteve për banim etj.

Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) vlera e përgjithshme e parave të qytetarëve me prejardhje nga Kosova që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, nga muaji Janar - Nëntor të vitit 2020 ka arritur në rreth 900 milionë euro.¹⁰⁰ Përmes të hyrave nga jashtë vendi (qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës) kanë dërguar mjete edhe në buxhetin e Kosovës në mënyrë që të ndihmojë Qeverinë e Kosovës për ta luftuar pandeminë Covid-19.¹⁰¹

Bashkatdhetarët që kanë ardhur gjatë vitit 2021 në Kosovë, sipas hulumtimeve të bëra nga organizatat joqeveritare, kanë shpenzuar rreth 2 miliardë €, duke përfshirë edhe remitencat. Sipas ekspertëve që i kanë bërë këto hulumtime, thuhet se të hollat e derdhura në forma të ndryshme janë një mbështetje për ekonominë e Kosovës, sidomos në kohë të pandemisë. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti ka treguar se për periudhën 9 mujore, Kosova ka pranuar remitenca 956 milionë € ose 20 % më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2020. Kjo bëri që të rriten edhe kërkuesat e brendshme dhe njëkohësisht të rritet importi. Deri tash dërgesat e shumta nga diaspora nuk është

⁹⁸intervistë me Kemajl Çallaku mësues i mësimit shqip në Dortmund, Arnsberg dhe Synden të Gjermanisë për emisionin refleksion në RTK-ë, 09.12.2021.

⁹⁹ Nuhi Gashi zyraë i MASHT për mësim në gjuhën shqipe, intervistë 1.12.2021.

¹⁰⁰ ([https://ekonomiaonline.com/ekonomi/bqk-gjate-vitit-2020-rreth-900-milione-euro-remitenca/.\(qasur 01.07.2022\).](https://ekonomiaonline.com/ekonomi/bqk-gjate-vitit-2020-rreth-900-milione-euro-remitenca/.(qasur 01.07.2022).)

¹⁰¹po aty.

që janë kanalizuar në investime, pasi shpesh institucionet janë fajësuar se nuk krijuan kushte dhe ofertë të veçantë për tërheqjen e investitorëve.¹⁰²

3.9.PROKURIMI PUBLIK

Prokurimi publik proces i cili ka të bëj me mallra, kryerjen e shërbimeve dhe ekzekutimin e punëve duke i shfrytëzuar fondet publike sipas rregulloreve në fuqi për prokurim. Të gjitha prokurimet publike në Kosovë financohen nga buxheti i konsoliduar i Kosovës ose nga të hyrat që i realizojnë institucionet mbështet në ligjin 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Sipas Neni 1

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe / ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjera që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike përvendimet e tillë, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

¹⁰² <https://telegrafi.com/shpenzimet-dhe-remitancat-mergata-dha-kosoves-rreth-2-miliarde-euro-gjate-2021-se/>(qasur 01.02.2022).

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të pa anshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellën duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.¹⁰³

Sipas ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës aktiviteti i prokurimit do të thotë çdo aktivitet që ndërlidhet me fillimin ose ekzekutimin e një procedure ose një aktiviteti tjetër që shpie ose që ka për qëllim të shpie drejt dhënie së një kontrate publike.¹⁰⁴

Prokurimi publik mund të definohet si aktivitet i institucioneve publike - shtetërore lokale dhe organeve që udhëhiqen nga e drejta juridike të cilat fondet publike shpenzohen për sigurimin e të mirave për interesin publik apo të përbashkët.(Erzen,2006,f.146).

Pa marrë para sysht se cilat procedura i zbaton autoriteti kontraktues për kryerjen e ndonjë aktiviteti të prokurimit të gjitha afatet kohore për pranimin e tenderëve apo kërkesave për pjesëmarrje duhet të jenë të mjaftueshme për t'iu dhënë operatorëve ekonomik kohë të mjaftueshme për të përgatitur dhe dorëzuar ofertë të përgjegjshme(Duli,2008,f.57)·

Sipas ligjit për prokurim publik (LPP) parashihen tri lloje të rregullave për pranimin e tenderëve:

Rregullat normale për pranim të tenderëve,

Rregullat e posaçme për pranimin e tenderëve si rezultat i njoftimit indikativ dhe

Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimit të afateve kohore.¹⁰⁵

Për mbarëvajtjen e procesit të prokurimit nevojite planifikimi i prokurimit, njoftimi për kontratë, hapja e ofertave, vlerësimi i ofertave dhe nënshkrimi i kontratës e cila në momentin e nënshkrimit të kontratës nga palët kontraktuese ajo hyn në fuqi. Të gjitha komunikimet rrëth implementimit të kontratës ndërmjet palëve kontraktuese do të bëhen vetëm në formë të shkruar, në mënyrë

¹⁰³Kushtetutës e Republikës së Kosovës. (nenit 65 (1). f.10

¹⁰⁴Ligji për prokurimin publik të Kosovës nr. 2003/17 nen 4- përkufizimi, f.9

¹⁰⁵po aty.fq72/73.

elektronike përmes e-mailit, ndërsa konsiderohet i fuqizuar kur të jetë i nënshkuar nga pala kontraktuese që e ka nënshkuar (Duli, 2010,f.101).

Prokurimi publik Qeveritar i referohet blerjeve nga ana e organeve qeveritare prej ofertuesve të jashtëm të mallrave dhe shërbimeve ku këto organe duhet ti kryejnë sipas rregullit detyrat që kanë të bëjnë me shërbimet publike.



Figura 1. Faza e prokurimit

Hapja e ofertave në procesin e tenderimit në raste të herë pas hershme realizohet në prani të mediave në mënyrë që të kemi një proces të hapur dhe të mirëfilltë të përmbylljes së tenderimit.

3.10. BUXHETI I VITIT 2018

Qeveria e Republikës së Kosovës, e ka miratuar Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, i cili do të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.¹⁰⁶

Projektligji përcakton buxhetin dhe me miratimin e tij i cili do të bëhet i detyrueshëm për të gjitha institucionet që përfshihen në buxhet të Republikës së Kosovës për vitin 2018. Nga zyrtarë të financave është vlerësuar se buxheti do të siguroj qëndrueshmëri të rritjes ekonomike të vendit, mbështetje të veprimtarive ekonomike, rritje të transfereve sociale dhe rritje te investimeve kapitale. Projektbuxheti parashevë të hyra të përgjithshme në vlerën prej 1 miliard e 829 milionë €, ndërsa shpenzimet do të kapin shifrën prej 2 miliardë e 82 milionë €.

Instituti GAP në një raport të publikuar buxhetin e vitit 2018 dhe rekomandimet e Komisionit Evropian i analizon rekomandimet e Komisionit Evropian për Kosovën karshi ndarjeve buxhetore për vitin 2018. Të gjeturat e rapportit shpërfaqin rritje të buxhetit për disa institucione fusha të rekomanduara nga KE, mirëpo kjo rritje mbetet e pamjaftueshme. Rritja e numrit të ministrive dhe fragmentimi i institucioneve të pavarura ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve rrjedhëse buxhetore dhe njëherësh ka penguar kohezionin në vendim marrje. Sipas GAP, Qeveria e Kosovës mund të funksionojë në mënyrë optimale dhe të shhang problemin e shpërndarjes së kompetencave nëpër ministri të ndryshme dhe do të duhej të ulte numrin e ministrive nga 21 në 13. Sipas përllogaritjeve (të GAP), ulja e numrit të ministrive, vetëm nga shpenzimet e pagave, telefonisë mobile dhe drekave, buxhetit të Kosovës do t'i kurseheshin rreth 3.2 milionë euro në vit apo 12.9 milionë euro për një mandat qeverisës prej katër vjetësh.¹⁰⁷

Buxheti përend dhe siguri publike është rritur krahasuar me vitin e kaluar (2017), ndërsa duhet buxhet i shtuar për trajnim të prokurorëve dhe gjyqtarëve, financim të strategjisë kundër - korruption dhe në përgjithësi rritjen e kapaciteteve për luftën ndaj korruptionit. Sa i përket çështjeve sociale, për shkak të rregullimit të dobët ligjor, financimi i shërbimeve sociale nga komunat është i ulët. Probleme të financimit ka edhe në fushën e mediave dhe statistikave. Ashtu

¹⁰⁶ [https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-republikes-se-kosoves-miratoi-projektligjin-per-buxhetin-per-vitin-2018/\(nenit_65_\(1\)\)_\(qasur_më_21.07.2019\).](https://kryeministri-ks.net/qeveria-e-republikes-se-kosoves-miratoi-projektligjin-per-buxhetin-per-vitin-2018/(nenit_65_(1))_(qasur_më_21.07.2019).)

¹⁰⁷ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fkosova-ka-nevoje-per-13-ministri-e-jo-21%2F\(qasur_10.10.2020\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fkosova-ka-nevoje-per-13-ministri-e-jo-21%2F(qasur_10.10.2020).)

sikurse vitet e kaluara, ende nuk është siguruar një formë e qëndrueshme e financimit për RTK-ë, ndërsa mungesë e buxhetit është cilësuar të ketë edhe KPM-ë dhe ASK-ë.¹⁰⁸

Për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2018, Radiotelevizionit të Kosovës (RTK-ë), i ndahan njëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë (11,200,000 €), në kategorinë e shpenzimeve, subvencione dhe transferim. Para seilit gjashtë mujor RTK-ë do t'i transferohen nga thesari mjetet e buxhetore në llogarinë e përcaktuar nga RTK-ë në bankë komerciale. Me aprovimin e këtij ligji, pjesa e parë e mjeteve transferohen me fillimin e vitit fiskal.¹⁰⁹

3.11. BUXHETI I VITIT 2019

Buxheti i Kosovës për vitin 2019, sipas projektimit arrin vlerën 2.3 miliardë euro, ndërsa zyrtarë të Ministrisë së Financave në Qeverinë e Kosovës e konsiderojnë buxhet të avancuar dhe i qëndrueshëm e ruan qëndrueshmërinë fiskale. Buxheti i vitit 2019 ka prioritet sistemin e drejtësisë, arsimit dhe shëndetësisë.¹¹⁰

Kurse, investimet kapitale adresohen në nevojat për infrastrukturë rrugore, hekurudha, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave. Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, komfor programit qeverisës në këtë vit, prioritet do t'i jepej fushës së drejtësisë, sundimit të rendit dhe ligjit, shëndetësisë dhe shtresës sociale.¹¹¹

Buxheti për vitin 2019 pritet të jetë më i madhi që ka pasur Republika e Kosovës prej vitit 2000 dhe do të arrijë vlerën në 2.3 miliardë euro".¹¹²

¹⁰⁸<https://www.institutigap.org/lajme/2203>.(qasur më10.10.2020).

¹⁰⁹Projektligji për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në mbështetje të nenit 65 të paragrafëve (1) dhe (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

¹¹⁰www.evropalire.org. (qasur më 11.11.2021).

¹¹¹www.evropalire.org. (qasur më 05.11.2021).

¹¹²<https://www.evropaelire.org/a/buxheti-i-kosoves-ekonomi/29559427.html>(qasur më 18.11.2021).

Debatet parlamentare për buxhetin kanë një dinamikë tashmë tradicionale mes pozitës dhe opozitës në Kuvendin e Kosovës, ndërsa në seancë arriti të votohet buxheti duke evitar krizë institucionale sa i përket buxhetit dhe pagave në sektorin publik.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, kanë miratuar shqyrtimin e dytë të projektligjit mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019. Kështu tejkalohet problemi i mos votimit të buxhetit i cili sikur të mos votohej do të krijonte problemin si në vijim: “*Në rast se nuk kalon buxheti i vtit 2019, por kalon vendimi, na mundëson që të funksionojmë gjatë muajit shkurt dhe mars. Nëse buxheti edhe pas muajit mars nuk aprovohet, atëherë më 1 prill shteti i Kosovës mund të bëjë pagesa vetëm për borxhin e jashtëm, ndërsa asnjë pagesë tjetër nuk mund të bëhet*”.¹¹³

Në kuadër të shpenzimeve kapitale që kapin shumën mbi 700 milionë €, sipas Lulzim Rafunës, këshilltar i ministrit të Financave Bedri Hamza, do të ketë projekte që do të zhvillohen në koherencë me reformat në shëndetësi dhe arsim, rrjedhimisht në përmirësimin e infrastrukturës në këta dy sektorë.¹¹⁴

Me miratimin e buxhetit, kryeministri Ramush Haradinaj thotë se Kosova hyn në etapë të re zhvillimore. “ E përvihendës miratimin në lexim të dytë të Projektligjit për Buxhetin 2019 të Republikës së Kosovës. Me 2 miliardë e 370 milionë €, ky është buxheti më i madh dhe më zhvillimor i deritanishëm i Kosovës, që do t'i paraprijë rritjes ekonomike prej 4.7 %.

Arsimi me rreth 300 milionë € dhe shëndetësia me 234 milionë, janë sektorët që përfitojnë më së shumti. Institucionet e sundimit të ligjit dhe mbrojtjes marrin mbështetje të shtuar financiare prej 6% krahasuar me buxhetin e vitit të kaluar. Investimet kapitale rriten për 11%, apo 75 milionë në raport me vitin 2018, duke mundësuar realizimin e shumë projekteve ekzistuese dhe të reja, si nxitje e madhe për zhvillim ekonomik dhe për sektorin privat.

Janë akomoduar mjetet për rritjen e pensioneve bazike 20%, për ato kontribut-dhënëse 15%, si dhe pensionet mujore prej 230 € për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.¹¹⁵

¹¹³Lulzim Rafuna,www.rtk.lajme. (qasur më 11.04.2020).

¹¹⁴ <https://www.evropaelire.org/a/buxheti-i-kosoves-ekonomi/29559427.html>. (qasur më 11.05.2020).

¹¹⁵<https://www.trt.net.tr/shqip/ballkani/2019/02/04/miratohet-buxheti-i-kosoves-per-vitin-2019-haradinaj-e-quan-zhvillim>(qasur më 11.08.2020).

3.12. BUXHETI I VITIT 2020

Buxheti i një vendi është njëherësh edhe bazament i planifikimit të përgjithshëm të zhvillimit të jetës në një shtet të caktuar. Situata e krijuar me virusin Corona nuk qartëson rrjetet zhvillimore të punimeve të Kuvendit. Nuk pritet ndryshim brenda dite, por nuk ka garanca që mund të mbajmë seanca në javët apo ditët në vijim, për pasoj të mundshme të infektimeve me virusin. As ne nuk jemi në rregull këtu me rregullat e përcaktuara.¹¹⁶

Intensifikimi i angazhimeve me mekanizmat kyç të financimit, siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore është kyçe për buxhetin e vendit ndërsa Kosova ka ngelur vonë në miratimin e projekt - buxhetit për vitin 2020 meqë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetor 2019, Qeveria e re e Kosovës u formua më 3 shkurt, kurse afati i fundit ligjor për Kuvendin e Kosovës për të miratuar projektligjin e propozuar për buxhetin është 31 Marsi.¹¹⁷

Të hyrat nga burimet buxhetore taksat përbëjnë shtyllën kryesore prej së cilës varet qëndrueshmëria financiare e një shteti, njëherësh është burimi kryesor i mbushjes të buxhetit të shtetit. Ndërsa Institucionet përgjegjëse për mbledhjen e taksave, tatimeve dhe detyrimeve financiare janë Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës, të cilat duhet treguar performancë në mbledhjen e të hyrave për arkën e shtetit. Dogana mbledh të hyra nga importet, aq sa ka vëllim të tregtisë dhe rritja ekonomike.

Ndikimi në të hyra mund të jetë edhe politikat fiskale në fuqi. Doganat e Kosovës në vitin 2020, parashihet të grumbullojë rreth 1.3 miliard euro. Ndërsa, ATK, mendohet se ka tejkaluar objektivat e planikuara.

*“Nga muaji Janar deri në Shtator agjencia ka grumbulluar 372 milionë euro. “ Projekzioni i ATK-së është mbledhja e 516 milionë eurove.*¹¹⁸

¹¹⁶Kryeministër i Kosovës.intervistë në RTK-ë, live,2021.

¹¹⁷www.sq/p/15.03.2020. (qasur më 11.05.2020).

¹¹⁸[www.evropalirë.com. \(qasur më 09.07.2021\).](http://www.evropalirë.com. (qasur më 09.07.2021).)

Parandalimi i ekonomisë joformale ndikon në uljen e in formalitetit, kështu i kontribuon rritjes së të hyrave dhe synon krijimin e barazisë në treg. Sipas Kornizës afat mesme buxheti i Kosovës për vitin 2020, parashihej të ishte rreth 2.4 miliardë €.¹¹⁹

“Gjithsej shpenzimet buxhetore për këtë vit pritet të janë 2 miliardë e 357 milionë euro që është për 12.7 % më shumë se buxheti i realizuar për vitin 2019. Buxheti për vitin 2020 është aprovuar në ditën e fundit të periudhës së paraparë”. Besnik Bislimi ministër i Financave dhe Transfereve.¹²⁰

Me vota të mjaftueshme, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar në shqyrtim të dytë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.¹²¹

3.13. BUXHETI I VITIT 2021

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, me 86 vota, miratuan pakon prej 12 amendamenteve të projektligjit, të cilat janë përkrahur nga komisioni funksional, ndërsa buxheti i miratuar për vitin 2021 kap vlerën e 2.4 miliardë euro. Projekt - buxheti merret me dy çështje kryesore, të cilat janë përballja me pandeminë dhe ngritja e rimëkëmbjes ekonomike.

Ndërsa sipas ministres, Hykmete Bajrami, buxheti është i dobët me rënienë së hirë prej 300 milionë euro për shkak të efekteve të pandemisë Covid-19. Me qëllim që buxheti të miratohej përpara se të shpërndahet Kuvendi dhe të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës është thirrur nga Lidhja Demokratike e Kosovës.¹²²

“ Pas përfundimit të kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2022-24 Ministria e Financave ka finalizuar përgatitjet përi rishikim të buxhetit për vitin 2021.

¹¹⁹<https://indeksonline.net/ky-do-te-jete-buxheti-i-kosoves-per-vitin-2020/>. (qasur më 02.11.2021).

¹²⁰<https://indeksonline.net/ky-do-te-jete-buxheti-i-kosoves-per-vitin-2020/>. (qasur më 11.09.2021).

¹²²www.ekonomiaonline.com 29.12.2020. (qasur më 03.10.2021).

Qeveria synon mposhtjen e pandemisë, si dhe prioritet tjetër është adresimi i rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë ”. Parametrat ekonomik tregojnë një rikuperim të ndjeshëm dhe të hyrat buxhetore kanë treguar rezultate të kënaqshme, ndërsa pritej një rimëkëmbje e mirë. Buxheti i rishikuar do të jetë 2 miliardë e 516 milionë euro”.¹²³

3.14. BUXHETI I VITIT 2022

Buxheti i Republikës së Kosovës i parashikuar për vitin 2022 është më i larti, duke arritur vlerën prej 2,748 milionë euro. Të hyrat buxhetore pritet të jenë në vlerë prej 2,364 milionë € që paraqet rritje 15% në krahasim me vitin paraprak.¹²⁴ Projektbuxheti i vitit 2022 ka për qëllim konsolidimin e ringjalljes ekonomike, sigurimin e qëndrueshmërisë së financave publike, ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, si dhe përkrahjen e punësimit dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 parashev investime e ndarje buxhetore në çdo lëmi që prek jetën e qytetarit, e që ndikon në ngritjen e mirëgenies qytetare. Në mënyrë më specifike, buxheti i planifikuar për vitin 2022 parashev investim në arsim dhe edukim me ndërtimin e 50 çerdheve të reja në tërë vendin, shkollimin falas për të gjithë studentët, si dhe ndarjen e 2 mijë bursave shtesë për studentët më të mirë.¹²⁵

Buxheti i vitit 2022 synon të ndihmojë edhe ekonominë familjare me ndarjen e 45 milionë euro për të mbështetur nënët me shtesat për lehonë e shtesat për fëmijë, ndarjen e 35 milionë eurove më shumë për kategoritë e pensioneve e sociale, ashtu që asnjë pension të mos jetë nën 100 € dhe shtesat për skemat sociale prej 30% të bëhen të përhershme. Në aspektin e shëndetësisë, buxheti i vitit 2022 parashev edhe 24 milionë € buxhet shtesë për sigurimin e barnave esenciale.¹²⁶

¹²³www.gazetaexpress.com/25.06.2021. (qasur më 04.10.2021).

¹²⁴ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fmf.rks-gov.net%2Fdesk%2Finc%2Fmedia%2F529659FE-E159-4026-8944-54E0CF33A53D.pdf>(qasur më 06.11.2021).

¹²⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fdosje.info%2Fministria-e-financave-jep-detaje-per-shperndarjen-e-buxhetit-2022%2F>(qasur më 08.09.2021).

¹²⁶<https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,2,1144>. (qasur më 07.10.2020).

“Ushtrinë e kemi projektin tonë madhor, andaj për herë të parë kemi ndarë buxhet mbi 100 milionë euro, apo 1.3% të Bruto Produktit Vendor. Synimi është që brenda mandatit ta sjellim në 2% të Bruto Produktit Vendor, aq sa kërkon standardi i NATO-s.¹²⁷

Deputetët e Kuvendit të Kosovës me shumicë votash në seancë plenare kanë miratuar buxhetin e Kosovës për vitin 2022 prej 2 miliardë e 748 milionë euro. Me shumicën e thjeshtë dhe asnjë abstenim dhe asnjë kundër ligjvënësit e Kuvendit të Kosovës aprovuan në shqyrtim e dytë projektligjin.¹²⁸ Kryeministri Kurti e quajti buxhetin 2022 si buxhet i cili i ka prioritet "sigurinë, shëndetësinë e arsimin" dhe do të jetë 2 miliardë e 748 milionë €, kurse të hyrat buxhetore rriten vlerën në 2 miliardë e 364 milionë €.¹²⁹

Megjithatë situata aktuale bëri që inflacioni të lëndon bazën ekonomike. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), norma vjetore e inflacionit e matur në muajin shkurt, 2022, me muajin shkurt, 2021, ishte 7.5 %. Rritje të çmimeve pati te buka, drithërat, qumështi, djathi, vezët, vajrat dhe yndyrat ushqimore, sipas AKS. Rritje të çmimeve pësuan pemët, perimet dhe disa produkte tjera. Çmimet janë në trend të rritjes për shkak të krizës në tregje që ka shkaktuar pushtimi Rus i Ukrainës, janë rritur në veçanti çmimet e energjisë, naftës dhe gazit. Kosova u atakua me ngritje të çmimeve edhe para luftës në Ukrainë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të çrrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia Covid-19. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni në janar të këtij viti ishte në 7.1 %, krahasuar me 0.2% sa ka qenë në janar të vitit 2021.¹³⁰

¹²⁷<https://www.monitor.al/buxheti-ne-kosove-miratohet-projektliglii-prej-2-7-miliarde-euro-per-vitin-2022/> (qasur më 11.11.2020).

¹²⁸ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fnep.facebook.com%2F400385793658915%2Fposts%2Fme-65-vota-pro-asnj%C3%A9-kund%C3%A9-Br-asnj%C3%A9-abstinen-kuvendi-i-kosov%C3%A9-miratoi-n%C3%A9-lexim-t%C3%A9-AB%2F1801338580230289%2F>(qasur më 07.08.2020).

¹²⁹<https://www.aa.com.tr/sq/balkani/kuvendi-i-kosov%C3%ABs-miraton-buxhetin-e-vitit-2022/2450500>. (qasur më 06.09.2020).

¹³⁰<https://www.evropaelire.org/a/cmimet-rritja-ne-kosove/31748413.html>. (qasur më 11.11.2020).

3.15. FONDET IPA

Për përfitimet nga (IPA), qeveritarët Kosovar thonë se Kosova ka përfituar më së shumti në rajon në raport me numrin e banorëve. Lidhur me këtë jo të gjitha burimet si qeveritare dhe të shoqërisë civile kanë qëndrim të njëjtë. Ish ministrja e integrimeve Evropiane e Republikës së Kosovës Dhurata Hoxha: “*Fondet IPA duhet të shikohen nga viti në vit dhe mund të themi se ka pasur rritje. Në vitin 2017 kanë qenë mbi 70 milionë, ndërsa në vitet 2018 – 2019 dhe 2020 janë respektivisht nga 100 milionë euro. Kosova për kokë banori është pranuesja më e madhe e fondeve të Bashkimit Evropian* “.

Dallimi në qëndrime dhe mendime kontradiktore për përfitimin nga fondet IPA për Kosovën janë të pranishme në media. Grupit për Studime Juridike dhe Politike thonë:” *Qeveria e Kosovës po i humb këto fonde për shkak të neglizhencës dhe mos realizmit të reformave të cilat dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe Agjenda për Reformave Evropiane (ERA)* ”.¹³¹

Qeveritarët Kosovarë nën vizojnë se bashkëfajësia është e përbashkët me burokracinë e BE-ë dhe procedurat e zyrtarëve të institucioneve të Kosovës. Kurse zyrtarë të BE-ë thonë se tarifa ka penguar agjenten Evropiane të Kosovës. Në njërin prej projekteve për ngritje të një deponie. BE ka lajmëruar se do të anulohet projekt për deponin e materieve të rrezikshme në Harilaq të Fushë Kosovës për shkak të mos gatishmërisë së asamblesë Komunale në Fushë Kosovë që të votojë për lokacion. Pra, Kosova nuk do të arrijë të marr 12 milionë €”.

Asistenca financiare në kuadrin e IPA II për Kosovën për vitet 2014–2020 kap shumën e 645.5 milionë, në katër objektiva specifike:

Mbështetje për reformat politike,

Mbështetje për zhvillim ekonomik, social dhe territorial,

Forcimin e aftësisë së përfituesve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian mbështetur harmonizimin progresiv, zbatimin dhe miratimin e Acquis të Unionit dhe forcimin e integrimit rajonal dhe bashkëpunimit territorial.¹³²

¹³¹Grupi për Studime Juridike, qëndrim i grupit,2021.

¹³²[Ekonomia Sot \(qasur më 20.02.20201.\)](#)

Vitet 2017–2020, Kosova ka arritur dhe do t'i shfrytëzojë rreth 300 milionë € nga fondet IPA. Mos luftimi i korrupsionit, krimi i organizuar, mosfunkcionimi i ligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme bën që Kosova nuk do të mund të përfitojë më fonde IPA III, reforma të kërkuara nga Bashkimi Evropian.¹³³ Kosova nuk do të mund të përfitoj fonde nga IPA III, pa përbushjen e reformave të kërkuara nga BE e cila kërkon luftimin e korrupsionit.¹³⁴

Luigii Brusa nga zyra e BE-ë në Kosovë thotë se:” *Në Kosovë legjislacioni dhe mbushja e hendeqeve ka ecur shumë shpejt*”. Ai thekson se reformimi i administratës publike si dhe koorupsioni janë probleme të cilat duhet tejkaluar në shoqërinë Kosovare. Për të fituar fonde nga IPA III, duhet të luftohet Korrupsioni, krimi i organizuar si dhe të funksionoj ligji i konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Kosova nga IPA II kishte përfituar 602 milion € për shtatë vitet e fundit.

¹³³www.evropalire.org,(qasur më 25.06.2019).

¹³⁴www.ekonomia (qasur më 28.02.2020).

Kapitulli IV

4.1. NOCIONI MBI POLITIKAT SOCIALE

Politikat sociale mbulojnë dispozitat dhe masat që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose synojnë të favorizojnë mirëqenien e grupeve më të brishta të shoqërisë.¹³⁵

Në kuptimin e ngushtë, politika sociale përcakton masat kundër varfërisë, parandalimit të saj, në radhë të parë sigurimet shoqërore dhe ndihma shoqërore. Në kuptimin e gjerë, përfshihen gjithashtu në politikën sociale, si politika e tregut të punës dhe punësimit, politika e arsimimit, e shëndetit, e strehimit, ose edhe politika fiskale të cilat janë të rëndësishë së veçantë për mirëqenien socio - ekonomike.

Shteti Social nënkupton konceptin e kryerjes së funksioneve të ndërhyrjes dhe të rregullimit në fushat ekonomike dhe sociale. Kjo shprehet nëpërmjet një tërësi masash që kanë për qëllim rishpërndarjen e pasurive dhe marrjen në ngarkesë të rreziqeve të ndryshme sociale si: Varfërinë, punësimi, familja, sëmundja dhe pleqëria.

Bazuar mbi solidaritetin midis grupeve shoqërore dhe në kërkimin e drejtësisë sociale. objektivat e politikës sociale përfshijnë:

Drejtësinë sociale (pa anësia, barazia e shanseve),

Sigurimet shoqërore, mbrojtja kundër rreziqeve të mëdha për sigurimin e ekzistencës),

Paqen sociale,

Rritjen e prosperitetit dhe pjesë marrjen më të gjerë në këtë prosperitet të përbashkët.

Puna, punësimi, formimi profesional, mbrojtja sociale dhe sigurimi shëndetësor, arsimi, personat në vështirësi (lypësit, të pastrehët, etj.), personat e moshuar janë sfida të politikave sociale përmes së cilave arrihet e drejta e sigurimit shoqëror dhe plotësohet kështu e drejta e ndihmës sociale.

¹³⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fshtetiweb.org%2Fpolitikat-sociale-2%2F>(qasur më 105.10.2020).

Lidhur me këtë trajtimi i temave të karakterit social në media të shkruara, elektronike apo edhe i atyre sociale, i kontribuojnë ndryshimit më të shpejtë të ngritjes socio - ekonomike duke ndikuar që nëpunës të ministrive dhe drejtorive përkatëse të nivelit qendror dhe lokal të janë më eksplativ në punë krahas përmbushjes së obligimeve ligjore.¹³⁶

Për të argumentuar përkushtimin institucional dhe angazhimin zyrtarëve që të dëshmohet se institucionet e vendit kërkojnë forma dhe modalitet për të përmbush nevojat e qytetarëve të kategorive të ndryshme, burime nga ASK-ë argumentojnë në mënyrë faktike se sa skema të përfituesve të mjeteve materiale janë ngrit në vend përgjatë vjetëve.

¹³⁶ www.rtklive.com, shënim autorial, (më 12.05.2020).

Tabela 4.Skema dhe numri i përfituesve të kategorive të komunitetit. (raporti i ASK-ë)

Nr.	Skemat përfituese	Numri i përfituesve
1	Pensionet bazë të moshës	140.917
2	Pensionet kontribut pagues të moshës	49.547
3	Pensionet familjare	3.663
4	Pensionet invalidore	91
5	Pensionet e Trepçës	2.453
6	Pensionet e TMK-ë	1.133
7	Pensionet e FSK-ë	572
8	Kompensime për persona të verbër	1.988
9	Pensione për persona me aftësi të kufizuar (PAK)	18.950
10	Pensione për persona paraplegjik dhe tetraplegjik	3.071
11	Skema për familjeve të dëshmorëve dhe invalid të luftës	13.640
12	Skema për veteranët e luftës	38.218

“ Statistikat e Mirëqenies Sociale, tre mujori i dytë 2020 ”, janë 99 mijë e 712 anëtarë që vazhdojnë të jetojnë vetëm me paratë nga ndihmat sociale. Shuma mujore e ndihmës sociale e cila iu paguhet familjeve në varfëri ndryshon, duke filluar nga 50 euro deri 150 euro.¹³⁷

¹³⁷Agjencia e Statistikave të Kosovës ,2021.

Tabela 5. Familjet sipas numrit të anëtarëve që pranojnë ndihma sociale burimi: ASK-ë

Familjet sipas numrit të anëtarëve	Shuma në €uro
Familja me një (1) anëtarë	50,00
Familja me dy (2) anëtarë	68,75
Familja me tre (3) anëtarë	75,00
Familja me katër (4) anëtarë	81,25
Familja me pesë (5) anëtarë	87,50
Familja me gjashtë (6) anëtarë	93,75
Familja me shtatë (7) anëtarë	100,00
Familja me tetë (8) anëtarë	106,25
Familja me nëntë (9) anëtarë	112,50
Familja me dhjetë (10) anëtarë	118,75
Familja me njëmbëdhjetë (11) anëtarë	125,00
Familja me dymbëdhjetë (12) anëtarë	131,25
Familja me trembëdhjetë (13) anëtarë	137,50
Familja me katërmëbëdhjetë (14) anëtarë	143,75
Familja me pesëmbëdhjetë (15) anëtarë	150,00

4.2. NOCIONI MBI POLITIKAT EKONOMIKE

Politika ekonomike e shtetit është tërësia e vendimeve dhe e veprimeve të institucioneve publike, bazuar në ligje dhe rregulla të caktuara, ndërsa për arritjen e objektivave ekonomiko - shoqërore të një vendi dhe mbrojtjen e interesave të shoqërisë në tërësi, nëpërmjet funksionimit optimal të çdo njësie ekonomike vendore (private ose publike).¹³⁸

Në mesin e institucioneve të cilët shërbejnë si gardian për ruajtje të interesave është media. Andaj me ndikimin e medias synohet të ndodh ndryshimi socio – ekonomik, kurse komuniteti të avancoj. E për të arrit avancimin ndikimi i medias është i pa kontestueshëm.

Krijimi dhe ekzekutimi i strategjisë ekonomike për e qëndrueshmërisë makroekonomik,

Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së rritjes optimale ekonomike afatshkurtër e afatgjatë,

Përmirësimi i strukturës sektoriale të ekonomisë, i nivelit të saj teknik e teknologjik,

Evoluimi i progresit të zhvillimit territorial të ekonomisë së vendit dhe ndryshimi mes rajoneve të ndryshme në vend,

Krijimi i kushteve edhe më të favorshme për marrëdhëniet ekonomiko me vendet e zhvilluara,

Krijimi i klimës së favorshme për investitorët e huaj,

Sigurimi i kushteve sa më optimale sociale,

Zbutja e varfërisë,

Zhvillimi i arsimit, shëndetësisë dhe i të gjithë sektorëve socialë, etj.

Është objektiv i politikave ekonomike kurse gjitha këto janë pikat strategjike të gjetjes së mundësisë së avancimit të shoqërisë së komuniteteve ndërsa në mënyrë që sa më lehtë të arrihet

¹³⁸ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fshtetiweb.org%2F2012%2F12%2F28%2Fceshte-politika-ekonomike%2F\(qasur më 11.09.2021\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fshtetiweb.org%2F2012%2F12%2F28%2Fceshte-politika-ekonomike%2F(qasur më 11.09.2021).)

qëllimi në momente të caktuara kohore ndikimi i medias konsiderohet shkas i rëndësishëm për arritjen e ndryshimit të dëshiruar dhe kërkuar.¹³⁹

Politika financiare e shtetit përfaqëson tërësinë e metodave dhe të veprimeve të ndërmarrë nga neveria dhe institucionet e saj, për përcaktimin, sa më racional të burimeve të nevojshme për plotësimin e programeve të saj gjatë një periudhe kohore të caktuar.¹⁴⁰

Politika financiare e shtetit është pjesë e rëndësishme e politikës ekonomike e cila përfshin: Politikën e sigurimit të ardhurave buxhetore, të tatimeve, të administrimit të borxhit shtetëror dhe të shpenzimeve buxhetore.

4.3. NOCIONI MBI MEDIAT

Sistemi i mediave dhe opinioni publik në shoqëritë demokratike gjenden në një proces të pandërprerë të transformimit. Deri tani, mediat dhe sistemi i mediave, në shumë raste nuk ka ecur me kohën ndërsa interesimi përfusha të caktuara ka qenë më i pranishëm në opinion në raport me situata të caktuara politike të aktualitetit, ndërsa disa fusha tjera kanë ngelë nën hije të proceseve politike.

Pas vitit 2008 me pavarësimin e Kosovës filloi një transformim gradual dhe themelor si në realitetin social dhe atë shoqëror bazuar në lirinë e shprehjes dhe fjalës së lirë. Kjo mund të jetë arsyja pse në refleksionet e shumta sociologjike, nocione si “ Shoqëri informacioni ” apo “ shoqëri e mediave ”, janë shndërruar në karakterizim të situatës së zhvillimit të momentit.¹⁴¹

¹³⁹ https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F35546712%2FNdikimi_i_grupeve_t%25C3%25AB_interesit_n%25C3%25AB_Britanin%25C3%25AB_e_Madhe_si_vend_an%25C3%25ABtar%25C3%25AB_i_Bashkimit_Evropian(qasur më 08.09.2021).

¹⁴⁰ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fshtetiweb.org%2F2012%2F12%2F21%2Fceshte-politika-financiare-e-shtetit%2F>(qasur më 09.11.2019).

¹⁴¹ www.04online.info/ Nga: Otfried Jarren: Medien, Mediensystem und politische Öffentlichkeit im Wandel; në: Ulrich Sarcinelli (Hg.), Politikvermittlung und Demokratie in der Mediengesellschaft, Bonn BpB 1998],(qasur më 06.06.2019).

7

Në shoqëritë moderne është rritur rëndësia ekonomike kulturore dhe politike e prodhimit dhe shpërndarjes së informacioneve. Madje sistemi i mediave është shndërruar në infrastrukturën qendrore të shoqërisë moderne. Mund të flitet për shoqërinë e mediave, sepse:

Mediat publicistike përhapen gjithnjë e më tepër në aspektin cilësor dhe sasior,

Është shpejtuar dukshëm kapaciteti i përhapjes së informacioneve nga mediat,

Janë zhvilluar lloje të reja të mediave,

Mediat përfshijnë gjithnjë e më tepër tërë shoqërinë,

Mediat kanë fituar për shkak të vlerave të përfilljes dhe të shfrytëzimit të vëmendjes gjithë shoqërore dëshironjë njohje,

Janë shndërruar në institucione.

Mediat gjithnjë e më tepër po bëhen premisë për praktikën e informimit dhe të komunikimit të aktorëve të tjerë. Pa media publicistike nuk është i mundur komunikimi mes organizatave në shoqëri⁷ dhe publikut. Opinionii⁷ në demokracitë moderne, për shkak të strukturës, përbajtjes dhe proceseve të tyre, ndikohet në masë të madhe nga mediat.

Duke marrë parasysh aktivitetet politike dhe prezantimin e tyre, ky zhvillim paraqet një sfidë të re për të gjithë aktorët që ndikojnë në marrjen e vendimeve në shoqëri.¹⁴²

4.4. ROLI I MEDIAVE

Roli i mediave në shoqëritë moderne po bëhet çdo herë e më i rëndësishëm, madje edhe po arrijnë ti lëvizin proceset socio - ekonomike dhe në fusha tjera. Mediat⁴³ sot nuk janë vetëm ato tradicionale, si gazeta, TV dhe radio, është shtuar numri i mediave që transmetohen përmes internetit apo mediave “online”.¹⁴³

¹⁴² www.04online.info-Nga:Otfried Jarren:Medien, Mediensystem und politische Öffentlichkeit im Wandel; në: Ulrich Sarcinelli (Hg.), Politikvermittlung und Demokratie in der Mediengesellschaft, Bonn BpB 1998), (qasur më 07.12.2021).

¹⁴³ Radio Evropa e Lirë(qasur më 07.03.2022).

Roli i mediave duhet të jetë me ndikim pozitiv në shoqëri, nevojitet të ketë një informim të përgjegjshëm dhe objektiv duke informuar dhe ofruar fakte sa më shumë e jo propaganduar e gjykuar sipas dëshirës apo interesave të mediave.

Presioni që qeveritë e bëjnë mbi punonjës të medias, redaktorë e gazetarë ekziston ku më shumë e ku më pak sikurse që edhe kriza ekonomike sfidon shumicën e mediave. Gjithsesi media ka mision refleksioni pozitiv për tejkalimin e ndasive dhe dallimeve etnike, fetare dhe shoqërore, ndërsa keqpërdorimi i medias nga individ apo grupe të caktuara është i pa pranueshëm me qëllim të parandalimit dhe shkaktimit të përçarjes në mes të grupeve të caktuara, komuniteteve, feve dhe racave.¹⁴⁴

Gazetaria e përgjegjshme për hulumtimin e së vërtetës të ngjarjeve e rrethanave dhe prezantimin para publikut është akt profesionalizmi i cili i nevojitet shoqërisë bashkëkohore demokratike dhe për këtë duhet inkurajuar këtë frymë të përgjegjshmërisë. Njëherësh duhet mbrojtur nga ndikimet e mundshme qeveritare. Për arritjen e synimit dhe informimit korrekt dhe të shpejt gjithsesi që kjo mundësohet përmes aplikimit të teknologjisë së informacionit në shërbim të publikut. Bazuar në parimet demokratike secili qytetar ka të drejtë të jetë i informuar për atë që është duke ndodhur, për këtë media duhet të bartë detyrën dhe përgjegjësinë e informimit të drejtë të qytetarëve.

Media konsiderohet si shtylla e katërt e pushtetit, një përkufizim i tillë rrjedh pikërisht nga roli që ajo ka për funksionimin normal të shtetit. Ajo është mekanizëm i fuqishëm për formimin e opinionit publik. Në shoqëri demokratike mediat janë korrekta e pushtetit. Por si është situata me media në Kosovë ? A janë mediat të pavarur ? A ekziston liria e shprehjes ? A ka ndikim politik në shfaqjen e informacioneve ? Në çfarë shkallë funksionon profesionalizmi i gazetarëve ? A ka hulumtim në gazetarinë kosovare ? A janë duke e kryer misionin e tyre ?¹⁴⁵

20

Për më tepër duhet thënë se mediat sot ushtrojnë rol të rëndësishëm në identifikimin dhe luftimin e dukurive negative, sikundër edhe në nxitjen dhe zhvillimin e proceseve pozitive në shoqëri.
20 Demokracia e një vendi më së miri mund të matet me lirinë e shtypit. Në demokraci, mediat janë “zëri” i popullit, për dallim nga diktatura. Mediat janë të pavarura dhe të lira për aq sa i përbahen

2

¹⁴⁴<https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fm.facebook.com%2Fgroups%2F461005473983271%2Fpermalink%2F2708413152575814%2F> (qasur më 07.12.2020).

F

¹⁴⁵ Mendim autorial i nxjerrë nga mjedise të ndryshme shoqërore në vend dhe mërgatë, 2019-2020.

20

etikës²⁰ dhe profesionalizimit dhe arrijnë t`i shmangen raportimit të një anshëm. Në Kosovë mediat ende shihen si një mjet osë instrument i përshtatshëm për realizimin e qëllimeve politike nga grupe të ndryshme. Koha në të cilën jetojmë është kohë e ndryshimeve dinamike ku dominojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Në këtë proces nuk ka shtete të vogla ose të mëdha si nga madhësia e territorit apo numri i banorëve, por të një game të madhe të vlerave, ku në mesin e tyre vend meritor kanë mediat. Për këtë aktivitet njerëzore në drejtim të një integrimi më të shpejtë të njerëzimit bazuar në vlera të njerëzve, kapitalit, teknologjisë, informative, ideve si dhe të vlerave kulturore midis shteteve dhe popujve mediat luajnë rol të rëndësishëm.

4.5.SUBVENCIONET EKONOMIKE DHE SOCIALE

Me subvencione kuptojmë mjete plotësuese që shteti nga buxheti i vet i ndanë për uljen e çmimeve të prodhimeve ose të shërbimeve dhe kanë karakter të destinuar. Me subvencione shteti ndihmon prodhuesin dhe konsumuesin. Dallohen subvencionet ekonomike dhe sociale. Subvencionet ekonomike paraqiten në formë direkt dhe indirekte, të cilat paraqiten si p.sh. Subvencionimi i minierave për të mbajt çmimin e metaleve apo të qomyrit ose subvencioni i premisave eksportuese për të siguruar bilanc tregtar me botën.

Subvencionet sociale janë mjete me karakter të destinuar dhe kanë për qëllim përmirësimin e kushteve për nevoja elementare, materiale të cilat nuk mund ti plotësojnë nga puna e vet numër i konsiderueshëm i qytetarëve. Subvencionet sociale të pa planifikuar mirë dhe pa kontroll mund të ndikojnë negativisht me kursim, investime dhe de stimulim, ndikim në punë dhe produktivitet.(Kadriu,2012.f 245).

Rritja e pabarazisë në dëm të shtresës së varférës është prezentë në të gjitha vendet dhe realizohet nëpërmjet shpenzimeve dhe tatimeve. Dukuria e rritjes së varfërisë duhet të studiohet dhe të bëhet një rindarje në favor të shtresës së varférës. Rritja e nivelit të varfërisë është prezentë gati në të gjitha shtetet dy deceniet e fundit. Ndërsa shkalla e varfërisë përcaktohet në bazë të studimeve, bazuar në metodën e anketës për të matur standardin e jetës. Mendohet se papunësia dhe niveli i ulët i arsimit janë shkaktarët kryesor të varfërisë. Prandaj, për zbutjen e problemit të varfërisë duhet

rritur shkallën e punësimit dhe të arsimimit. Niveli i varfërisë e kushtëzon nivelin e rritjes së mbrojtjes sociale dhe menaxhimit më të mirë të programeve dhe skemave të ndihmës sociale.

Në skemën e përfitimeve përfshihen:

Asistenca sociale,

Nevojat e veçanta,

Invalidët e luftës dhe të afërmit e tyre,

Pensionistët,

Pensionet për persona me aftësi të kufizuar,

Pensionet e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar,

Decentralizimi fiskal,

Shëndetësia është sektori kryesor i mirëqenies së popullatës, andaj për këtë duhet kushtuar kujdes të veçantë për realizimin e qëllimeve të mbrojtjes shëndetësore:

Financim të qëndrueshëm të sektorit shëndetësor publik pavarësisht situatës fiskale dhe asaj sociale.

Përmirësimi i menaxhimit të shërbimeve shëndetësore,

Monitorimi i shërbimeve publike,

Përkrahja e shërbimeve shëndetësore të sektorit privat,

Qeveria definon dhe finançon programet në ndihmën shëndetësore, kujdesin shëndetësor dhe mbështet sigurimin privat,

Riorganizimi dhe plotësimi i infrastrukturës shëndetësore dhe sigurimi i përvojave sipas standardeve Evropiane është kompetencë e Qeverisë,

Papunësia dhe varfëria janë pasojë e mungesës së arsimit dhe edukimit qytetar,

E drejta për arsim dhe edukim është e drejtë themelore kushtetuese e çdo shteti. Andaj të gjitha shtetet për këtë çështje kanë pozicion të rëndësishëm në strukturën e shpenzimeve publike,

Dituria dhe shkathësitë e fituara nga institucionet arsimore e edukative të individit dhe të punëtorit ndikojnë në rritjen e produktivitetit të punës, eliminon paragjykimet për çështje nacionale, sociale, fetare, politike dhe të përmirësimit të planit social-politik dhe ekonomik.(Kadriu,2016,f.125).

4.6. TRAJTIMI I DUKURIVE SOCIO - EKONOMIKE NË MEDIA

34

Dukuria socio - ekonomike e trajtuar në media ngërthen në vete një gamë të gjërë të problemeve dhe natyrave të ndryshme që ndërlidhen me kategorinë të ndryshme shoqërore. Aq sa shoqëria njerëzore është e përkushtuara dhe angazhuar po aq edhe shpërfaqen idetë dhe kërkesat për ndryshim socio - ekonomik.

Ndërsa kërkimi i ndryshimit dhe trajtimi i në media të shkruara dhe elektronike thuaja se është i vazhdueshëm ndërsa njëherësh edhe i iniciuar edhe përmes rrjeteve sociale të cilat dita - ditës e 23 kanë lehtësuar mundësinë e marrjes së informacionit dhe inicimit të veprimeve të ndryshme. Media si pjesë e rëndësishme e komunikimit të shoqërisë, informon publikun dhe reflekton pjesë të opinionit publik. Ajo luan rol kyç në luftën kundër stereotipave gjinore dhe kontribuon në pasqyrimin e një kuadri realist të aftësive dhe potencialit të grave dhe burrave në shoqëritë moderne.¹⁴⁶

Media konsiderohet zëri i arsyes e cila shpërfaq aktualitetin dhe dukurinë me qëllim të parandalimit dhe sensibilizimit të problemeve shoqërore sikurse edhe plason shembuj pozitiv në jetën e përditshme sidomos të temave me karakter socio - ekonomik dhe humanitar si të organizimit institucional shoqëror dhe individual pa dallim kontributit të shoqatave jo fitimprurëse të miqve të Kosovës, humanistëve dhe përfaqësuesve si jashtë edhe brenda vendit pa i anashkaluar edhe investimet nga linjat buxhetore të qeverisë së vendit.¹⁴⁷

Investimet dhe aktet humanitare të natyrës kryesisht atyre të ngritisës së kulmeve të reja nga personalitete dhe shoqata humanitare krahas punësimit në vend ndikojnë në ndryshimin socio -

23

¹⁴⁶ (Diskriminimi në punë në Evropë. Zyra Ndërkombëtare e Punës

TRAJTIMI_I_PROBLEMATIKAVE_SOCIALE_NE_MEDIA_-Perspektive_gjinore (qasur më 07.10.2020).

2

51

¹⁴⁷ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fdrengerguri.com%2Flirine-e-medies-po-e-rezikoje-politika-ekonomia-dhe-vete-mediet%2F> (qasur më 03.12.2020).

ekonomik tek qytetar të Kosovës dhe kjo është e argumentuar dhe dëshmuar me përkushtimin kryesishët të bashkëkombësve nga mërgata të cilët janë pjesë e atdheut.¹⁴⁸

Ngritja e objekte afariste nëpër edhe jashtë zonave industriale sikurse edhe prezantimi i tyre sidomos ma rastin e fillimit të punimeve dhe përgatitjes së produkteve për eksport shtron shpresat se megjithatë iu janë dhënë mundësitetë për gjenerim të mirave materiale por njëherësh edhe zbut shifrat e qytetarëve të cilët janë të pa punë dhe si të tillë i kontribuojnë ngritjes socio - ekonomike.

Kërkim lëmosha si dukuri sociale me potencial ndikimi në mirëqenien negative të shoqërisë në tërësi, kërcënët sigurinë e përgjithshme. Si problem më specifik dhe delikat është sidomos te fëmijët. Kosova është vend tranzitor dhe vend i destinimit për fëmijë të trafikuar, prostitucion dhe kërkim lëmoshë të detyruar gjersa vajzat e vogla dhe fëmijë të komunitetit RAE janë potencial i trafikimit për shkak të varfërisë së madhe dhe regjistrimit të ulët civil të lindjeve.(Refworld,2011).

Në Kosovë janë organizuar fushata të ndryshme në media me qëllim të inkurajimit të popullatës që të mos u jasin para lypësve në rrugë, duke u munduar të zvogëlojnë anën “ furnizuese “ të kësaj çështje. Këtu bëhet fjalë për ata të cilët përfitojnë duke shfrytëzuar fëmijët për pasurimin e vet personal.

Një dimension karakteristik i këtij problemi është dhënë në numrin e personave me çrrregullime mentale ose personave me aftësi të kufizuar të përfshirë në lysari. Ky problem tregon sistemin e ulët të mirëqenies sociale dhe kujdesit në Kosovë.

Mundësitetë e vogla që personat me aftësi të kufizuar të punësohen, pa dyshim ka ndikuar në konkurrimin e tyre në tregun e punës në Kosovë, i cili në një mënyrë afektohet me shkallën e lartë të pa punësisë.¹⁴⁹

Lidhur me lysarin dhe dukurinë e futjes në ujëra të tilla mediat me qëllim të ndryshimit të synuar si shoqëri trajtimin sidomos të fëmijëve lysarë e kanë trajtuar me përkushtim të parandalimit të kësaj dukurie. Ndërsa për të zbërtyer problematikën e kërkim lëmoshës zyrtarë institucional të nivelit qendror ministritor dhe atyre lokal kanë kontribuar për trajtim të këtyre kategorive.

2

¹⁴⁸ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.shkollat.org%2F>(qasur më 07.12.2021).

¹⁴⁹Report for the study on typology and policy responses to child begging in the EU,2012..

Problem analog i trajtimit për ngritje socio - ekonomike është edhe pa punësia përkatësisht punëtorët e krahut, tema të cilat janë të trajtuara në media lokale dhe qendrore si dhe publike dhe komerciale. Pa dallim kategorie sociale përkushtimi i politikave redaktuese të medias Kosovare kanë krijuar hapësira për të informuar opinionin publik rreth problemeve të ndryshme socio - ekonomike me qëllim të ndryshimit pozitiv dhe krijimin e mirëqenies duke ua “ përkujtuar “ zyrtarëve institucional që kanë obligim ligjor për trajtimin e problemeve sipas ligjit në fuqi.

4.7. MEDIUMI PUBLIK

Në kushtet e sotme kur globalizmi ka marrë hov në secilën sferë të jetës, e kur vjelja e informacioneve dhe e të gjitha produkteve që dalin nga ai informacion është bazë e zhvillimit social dhe ekonomik e shoqërisë dhe nevojë e përditshmërisë së një vendi, pa dyshim vjelja e informatave të verifikuara e të sakta, me kohë mbetet çelësi kryesor te një medie.

Në suaza të kësaj, Radio Televizioni i Kosovës, si medium publik është vjelës i informacionit e njëkohësisht përpunues dhe shpërndarës i tij, duke qenë në shërbim të publikut, natyrisht që ndikon në zhvillimin e shoqërisë në tërësi. (Selimi,2016,f.98).

Përveç rolit esencial për informim dhe zhvillim të përgjithshëm reformimi i mediumit publik është i rëndësishëm si nga aspekti tekniko - teknologjik për faktin që teknologjia e informacionit evoluuan aq shpejt sa që vështirë është të përcillet sidomos nga mediumet publike të shteteve të cilat janë në zhvillim dhe shtetet e reja siç është Kosova. Andaj për të arritur një avancim përvëç mjeteve dhe formave të ndryshme të financimit mbështetja me donacione është mundësi plus për zhvillimin e medias dhe ecje me kohën.

Marketingu në aspektin e zhvillimit të mediumit luan rol të rëndësishëm, ai ndihmon në shumë dimisione si: Të mediumit, të subjektit afarist, kulturor apo edhe institucional.

Megjithatë edhe pse mediumi publik sikurse p.sh Radio Televizioni i Kosovës ai duhet përmbajt rregullave sipas legjislacionit në fuqi duke përbush detyrat dhe obligimin të cilat dalin nga platforma dhe objektivat e formimit të tij.

15

Gjithnjë duke u përpjekur për të plotësuar objektivat e veta sipas rregullores së UNMIK-ut, ku thuhet RTK –ë ka për detyrë “ *Tu ofroj të gjitha komuniteteve në Kosovë mundësinë e shprehjes, përmes formimit të shërbimit të zyrës programore për ti përkrahur komunitet e tillë, duke ua kushtuar jo më pak se 15% të skemës programore të RTK-ës dhe duke përfshirë kohën kryesore të lajmeve në gjuhët e komuniteteve, përvèç gjuhës së popullatës shumicë në Televizion dhe në transmetime të kombinuara të Radio frekuencave të RTK-ës (Selimi,2016.f.26).*

24

E më pas me rregullimin e ligjit të RTK-ës bëhet fjalë për objektivat e sajë shtëpi informacioni. Me kalimin e kohës, RTK-ë nisi të zgjeronte programin e vet si dhe numrin e të punësuarave, e duke u bërë një nga mediat më të shikuara dhe më me ndikim në shoqërinë kosovare.

Zgjerimi i skemës programore dhe i stafit të nevojshëm për plotësimin e nevojave për informim dhe përgatitje edhe programe tjera për nevoja të prezantimit të aktiviteteve dhe punëve të komuniteteve bëri që prezantimi në median publike RTK-ës në Televizion dhe Radio të realizohej me vështirësi të shtuar për shkak të kërkeseve të mëdha gjë që bëri që gradualisht të rriten minutat, orët, programet e madje edhe kanalet e RTK-ës (Selimi,2016,f.201). për të fituar hapësira programore për emetim.

3

Ligji Nr. 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës Kuvendi i Republikës së Kosovës; Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton: Ligj për Radio Televizionin e Kosovës.

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

Nëpërmjet këtij ligji rregullohet themeli i funksionimit si dhe kompetencat për mediumin publik (RTK -ë), me qëllim për siguruar informim, ¹¹ objektiv, të paanshëm, të shpejtë për komunitetin e Republikës së Kosovës.

Neni 2 Përkufizimet

1. Termet e përdorura në ligj kanë këtë domethënie:

1.1. Shërbimi **medial** audio vizuale - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i të cilët është ofrimi i programeve, me qëllim që të jap informacione, **edukojë publikun**, nëpërmjet rrjetave të komunikimeve elektronike. Një ofrues i tillë i shërbimeve mediale audio vizuale është transmetues televiziv apo video me kërkeshë.

KREU II Radio Televizioni i Kosovës

11

Neni 3 Radiotelevizioni i Kosovës

11

1.Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) është transmetuesi i vetëm publik i Kosovës.

2.RTK-ë institucion juridik jo përfitues me status të pavarur dhe me rëndësi të veçantë i ofron shërbime publikut në spektrin fushës së veprimitarës mediatike, të caktuar me ligj dhe aktet tjera të caktuara ligjore dhe nënligjore.

3.RTK ka mision informues, edukues, kulturor dhe argëtues.

Neni 4

Themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës

38

1.Sipas këtij ligji Kuvendi i Republikës së Kosovës e themelon Radiotelevizionin e Kosovës.

2.Kuvendi mbron autonominë institucionale dhe siguron financim adekuat për realizimin e misionit të shërbimit publik të RTK-ë të përcaktuar me këtë ligj.

12

Funksion tjetër i mediave është të mbikëqyrin punën e qeverisë dhe institucioneve tjera të fuqishme të shoqërisë. Mediat duhet të kenë qasje kritike ndaj pushtetit, mirëpo vetëm me fakte, dhe pa anime politike. E drejta e informacionit dhe marrjes së tij si dhe dhënes konsiderohet si e drejtë e pa diskutueshme politike dhe civile. Në shumë vende të botës me demokraci të avancuar janë mediat ato që u paraprinë zbulimit të shume dukurive, sic janë: krimi i organizuar, korruptioni, nepotizmi në institucionet publike dhe shtetërore etj. Në vendin tonë mediat janë nën presionin e qeverisë dhe nuk janë të lira të informojnë opinionin objektivisht. Shembulli unik në Kosovë për të arsyetur është mediumi i vetëm publik, (RTK-ë). Vetëm tek vendet që synojnë të kenë një kontroll të plotë mbi mediat ndodh që mediumi publik të financohet drejtpërdrejt nga qeveria, fatkeqësisht kjo po ndodh në vendin tonë.¹² Me këtë mund të ngritën hipoteza sa mund të jetë i pavarur mediumi dhe sa objektivisht mund të janë informacionet në raport me themeluesin, kur është i varur finanziarisht nga ai.¹⁵⁰

15

¹⁵⁰<https://telegrafi.com/roli-i-medieve-te-lira-per-shoqerine-demokratike> (qasur më 08.08.2021)

4.8. MEDIAT KOMERCIALE

4

Peizazhi i medias në Kosovës përfshin dy nivele: Mediat kombëtare me shtrirje kombëtare, si dhe mediat rajonale/lokale me shtrirje të pjesshme ose specifike brenda një rafoni a qyteti. Sipas raportit të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) nga viti 2018, Kosova ka 20 stacione televizive operacion ale, 83 radiostacione, 41 operatorë shpërndarjeje dhe 80 ofrues të shërbimeve të mediave audio-vizive. Midis tyre janë 13 transmetues televizivë në gjuhën shqipe, përfshirë transmetuesin publik, pesë transmetues televizivë në gjuhën serbe dhe një që transmeton në gjuhën turke. Nga radio-stacionet, 48 transmetojnë në shqip, duke përfshirë dy radio-stacione publike, 23 në gjuhën serbe, tre në gjuhën boshnjake, tre në gjuhën turke dhe dy në gjuhën gorane.

Sa i përket rregullimit, media e Kosovës rregullohet nga Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). KPM-ja është organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencës së transmetimit. BNK rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitet e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audio -vizive.¹⁵¹

Krahas mediumit Publik edhe mediat komerciale varësisht interesit të tyre dhe ndikimit të subjekteve të ndryshme mund të ndikojnë në politikat redaktuese dhe atyre programore për aplikim të metodologjive të ndryshme për ndryshim socio - ekonomik. Kjo mund të argumentohet dhe analizohet se cili është dallimi mes medias publike dhe atyre komerciale. Ndikimi është i dukshëm për faktin që edhe përkundër obligimit ndaj komunitetit mediat publike në momente të caktuara ojanë të barabartë të prezantimit të realitetit socio - ekonomik ose qëndrojnë prapa mediave komerciale. E gjithë kjo vjen nga ndikimet e shumicës dhe institucioneve të cilat edhe pse deklaroohen se nuk ndikojnë në punën e medias publike ato ballafaqohen me sfida të ndryshme.

Megjithatë mediat komerciale sfidohen nga një kënd tjetër i sfidës së financimit dhe sektori i marketingut apo edhe donacionet e ndryshme i ndihmojnë ato (mediat elektronike).

4

¹⁵¹<http://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legislationi/1335250709.2603.pdf>. (qasur më 10.08.2021).

Derisa më lehtë mund të shpërfaqin sfidën e aspektit socio - ekonomik mediat publike megjithatë dhe mediat komerciale me emisione të dedikuara apo speciale jo rrallë herë hedhin hapa konkret të kërkim ndryshimit socio - ekonomik.

4

Në mozaikun e medias në Kosovë, i cili, përkundër situatës së paqartë politike, vazhdon të prodhojë kryesisht lajme politike, debate dhe prodhime tjera mediatike politike. Indeksi i qëndrueshmërisë së medias me të drejtë pohon edhe se “ shtimi i internetit ka hapur rrugën për shtimin e mediave shumë më të vogla, më të pavarura dhe profesionale në vitet e fundit.(Hoxha,2020).

Sektori i media private është në pronësi alternative të me probleme në informim dhe sajim të lajmeve sipas interesit të donatorëve, vendorë dhe atyre ndërkombetarë. Praktikat e mira të regjistruesve të lajmeve dhe të rutinës në redaksi kanë ndryshuar dhe ka më shumë censurë dhe vetë censurë në redaksi si rezultat i presionit politik (Andersen, et al, 2017).

4

Deri më sot, shumica e transmetuesve televizivë kombëtarë dhe rajonalë (lokalë) kanë pronësi zyrtarish transparente; megjithatë, pronësia e vërtetë nuk dihet ose nuk është e konfirmuar.

4

Vlerësohet se kosovarët ende besojnë që televizioni mbetet burimi më i besuar për lajmet (NDI, 2019), ndonëse nuk ka asnjë matje shkencore. Shumica e vlerësimeve vjen nga perceptimi i qytetarëve në sondazhe të tjera.¹⁵²

Me ndryshimin e situatës socio - ekonomike dhe sfidës së pandemisë Covid-19 kemi edhe sfidat ekzistenciale dhe transformimin e punës së medias komerciale pavarësisht elektronike apo edhe të shkruar e cila transformohet sipas rrethanave të krijuara për sigurimin ekzistencial të stafit punues të mediumit përkatës.

Kërkimi i modaliteteve përmes gjetjes së burimeve dhe sponsorëve mediat komerciale përmes sektorit të marketingut dhe sponsorëve të emisioneve arrijnë të sigurojnë mjete për mbarëvajtje të punës së medias dhe sigurimin ekzistencial financiar për qëndrueshmëri materiale të mediumit.

Mediat komerciale orientohen kryesisht për audiencë të afaristëve, ndërsa interesimi për program të informacionit e sidomos atij edukativ e kulturor është në plan të dytë. Te këto media vërehet

¹⁵²<https://www.ndi.org/sites/files/NDI%20Kosovo%20public%2> (qasur më 02.07.2021)

tendenca e shërbimit të medias për kategori të caktuar të audiencës të cilët janë të ndërlidhur me sferën e interesit të caktuar për afaristin apo për dëshirën e bartësve të medias komerciale. Në këto raste qëllimi është përvetësimi i audiencës dhe përfitimi në biznes të caktuara apo edhe në fusha tjera të interesit.

Në raste të tilla besimi në informacioni nuk është primari, meqë misioni është i qartë dhe ndikimi i mundshëm për krijim të opinionit të caktuar paraprakisht. Sa i përket informimit mediat komerciale janë të ndërlidhura me interesa të caktuara të autoriteteve pushtet mbajtëse ose opozitare me ndikim, kurse nga pikëpamja kulturore dominon përkushtimi për të realizuar spektakle të ndryshme me mision të caktuar.

Mediat komerciale përmes pompozitetit të prezantuar përmes programeve argëtuese në mënyrë indirekte dalin në pah persona me ndikim edhe nga jeta politike, ndërsa këtu ndryshimi i kërkuar nuk mund të avancoj përvèç në raste konkrete të lidhura mes medias, personalitetit publik me ndikim dhe qëllimit.

Përkundër tentativës për të ushtruar profesionalizmin dallimi mes medias publike dhe komercial dallon për faktin që ndikimi është i dukshëm tek media komerciale si shkaktar nga personat “ e fuqishëm “ të cilët shfrytëzojnë autoritetin, pozicionin dhe gjendjen materiale.

Ndikimi (interferimi) në media i njerëzve të fuqishëm bën që profesionalizmi të zbehet ndërsa fuqia materiale të ndikoj në atë kulturore dhe edukative për të shkuar edhe më larg që të ndikojnë në politika redaktuese. Numër i madh i mediave është themeluar nga bizneset, partitë politike dhe grupe tjera të interesit, duke ndjekur agjenda tjera dhe jo raportim objektiv e të balancuar. Këto media i shërbejnë interesave të bizneseve dhe agjendave ditore politike.¹⁵³

¹⁵³ <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2018/01/kosovo-country-report-alb.pdf>. (qasur më 22.06.2022)

4.9.MEDIAT SOCIALE DHE NDRYSHIMI SOCIO - EKONOMIK

Njerëzimi ka bërë hapa të mëdhenj në kulturën dhe në civilizimin e tij. Progresi social është i dukshëm në të gjitha fushat: Në art, në shkencë, në ekonomi, në politikë(Dragoti,2004,f.56). Kosova ka një nga depërtimet më të larta të përdorimit të internetit në rajon me 86.49% sipas ditarit mediistik të IPSOS. Pjesa e përdoruesve të telefonave mobil tejkalon 96% të popullsisë dhe pashmangshëm, rrjetet e mediave sociale luajnë rol.

Rrjetet e mediave sociale janë shumë të popullarizuara në Kosovë edhe midis liderëve politikë, partive dhe kanaleve të përgjithshme të komunikimit. Për disa vjet, qeveria e Isa Mustafës (2014–2017) komunikoi me publikun kryesisht përmes Facebook-ut dhe qeveria e fundit e koalicionit u negocia përmes Facebook-ut duke nxjerrë detaje edhe para se zhvillimet e reja të arrinin palën tjetër në negociata. Ngashëm, partitë politike, organizatat dhe individët me ndikim përdorin kryesisht Facebook-un për të komunikuar. Media ka prani shumë të lartë edhe në rrjetet e mediave sociale(Hoxhaj,2018,f.21).

Sipas një raport të Kosovo 2.0 në vitin 2019, prania e mediave sociale ka shtuar komunikimin ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve me publikun në përgjithësi duke i sjellë palët më afër njëra - tjetrës, por ky komunikim mbetet i një anshëm dhe jo i hapur për sfidë të mirëfilltë. Mediat sociale kanë lehtësuar komunikimin e shpejtë midis përfaqësuesve institucionalë dhe publikut, por edhe e kanë bërë më të vështirë punën e gazetarëve, sepse deklaratat e adresuara në mediat sociale shpesh përdoren si justifikime nga përfaqësuesit institucionalë për refuzimin e sfidimit publik lidhur me çështje të ndryshme në interes publik".¹⁵⁴

Kur bëhet fjalë për trendin në rrjetet sociale kemi pasqyrë 17 të qartë të rëndësisë së shfrytëzimit të gjitha potencialeve të cilat ato mund t'ju ofrojnë. Publiku 17 do të kërkojë përshtatje dhe 17 freski në redaksitë e mediave. Përmes krijimit të formave të reja gjithsesi ruhen publikimet paraprake, por do të hyhet në publik të ri. Kjo listë gjithsesi nuk është përfundimtare kur bëhet fjalë për trendin në rrjetet sociale, por gjithsesi mund 17 do të ketë pasqyrë më të qartë të rëndësisë së shfrytëzimit të potencialeve. Gjithnjë e më shumë jemi dëshmitarë se madje edhe mediat klasike, shtypi dhe televizioni po e kuptojnë rëndësinë e mediave sociale të cilat po i krijojnë profilet e tyre në këto rrjete. Gjithnjë e më pak po lexohen lajmet dhe gjithnjë e më shumë publiku dëshiron 17 të dëgjoj

¹⁵⁴<https://kosovotwopointzero.com/en/2018/>(qasur më 25.06.2021).

tema të ndryshme, ndërsa vijnë në shprehje mediat sociale të cilat mund të shfrytëzohen duke krijuar formate të reja, duke ruajtur publikun e vjetër dhe përfituar publikun e ri.¹⁵⁵

Mediat sociale kanë ndikim esencial në jetën e përditshme derisa interneti është bërë pjesë e përditshmërisë pa dallim moshe e në disa raste të veçanta mund të konstatohet që aplikimi i teknologjisë së informacionit ka ndikuar tek më të vegjlit që edhe mos ta njojin gjuhën amtare si pasojë e varësisë së krijuar nga interneti dhe pajisjet e mençura tekniko - teknologjike, ndërsa tek të rinjtë ndryshimi social është i dukshëm si rezultat i aplikimit të telefonisë mobile dhe krijimit të distancave sociale problem ky i bartur edhe te gjeneratat më të moshuara.¹⁵⁶

4.10.MEDIAT E SHKRUARA DHE NDRYSHIMI SOCIO - EKONOMIK

5

Tirazhi i ultë i mediave të shkruara është fenomen që ka përcjellë gazetat në dy dekadat e fundit. Ky trend është rritur sidomos me zgjerimin e rrjeteve televizive dhe mediave të internetit, të cilat janë ofrojmë lajme për publikun menjëherë, duke përdorur përveç tekstit edhe platforma audio - vizuale. Gazetat janë lënë në pozitë të pabarabartë në tregun e medias si dhe kanë pasur nevojë të bëjnë ndryshime të rëndësishme në politikat redaktuese për të qenë të qëndrueshme.¹⁵⁷

Në Kosovë ishin 9 gazeta të përditshme ditore që btoheshin të gjitha në gjuhën shqipe. Njëra nga ato e është themeluar muajin në shtator, 2009. Të tetë gazetat.¹⁵⁸

5

Të dhënët nga hulumtimet dhe të dhënët e mëparshme të specifikuara nga botuesit/redaktorët e gazetave janë ndryshtë kanë tirazh ditor mes 25,000 dhe 35,000 kopje.¹⁵⁹

Ky numër është tejet i ultë në krahasim me popullsinë në Kosovë (rreth 2.1 milionë) edhe po të merret parasysh që tre deri në pesë njerëz e lexojnë një gazetë të blerë.

¹⁵⁵Balkansmedia “Trendet në mediat sociale në vitin 2020 që janë të rëndësishme për gazetarinë“ 03.02.2020.

¹⁵⁶https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Funesdoc.unesco.org%2Fark%3A%2F48223%2Fpf0000149284_133(qasur më 05.03.2021)

¹⁵⁷<https://www.osce.org/files/f/documents/9/1/67791.pdf>(qasur më 05.06.2021)

5

¹⁵⁸Sipas të dhënave të ofruara nga të përditshmet Bota Sot, Epoka e Re, Express, Infopress, Koha Ditore, Kosova Sot, 15 m dhe Zëri. (qasur më 08.07.2021)

¹⁵⁹Të dhënët nga hulumtimet dhe të dhënët e mëparshme të specifikuara nga botuesit/redaktorët e gazetave janë ndryshtë. (qasur më 10.07.2021)

5

Arsyet e dhëna për mos blerjen e gazetave ishin të ndryshme. Opinionet e qytetarëve tregojnë që nuk blejnë gazetat, por ato i lexojnë në mjedise të ndryshme si kafene dhe lokale të ndryshme. Disa të tjerë thonë që nuk i blejnë gazetat sepse këtë e bëjnë prindër apo të afërmit e tyre. Arsyet e tretë që ka dalë nga dy takimet e grupeve të fokusit eshtë aspekti dhe përbajtja e gazetave, të cilat sipas pjesëmarrësve japid shumë lajme e pak analiza lajmi apo raporte hulumtuese.¹⁶⁰

Shkaqet të cilat gradualisht kanë ndikuar në rënien e tirazhit të shtypit ditor përgjatë viteve në Kosovë ndërlidhen me ndryshimin dhe avancimin e situatës tekniko - teknologjike në media, telekomunikim dhe atë socio - ekonomike në vend. Faktori i parë eshtë i natyrës profesionale. Për të mbijetuar gazetat ato duhet përshtat ndaj një publiku të caktuar gjë që i bën konkurrente me mediat e tjera si elektronike edhe të shkruara. Nevojitet përshtatja e përbajtjes sipas publikut të synuar enkas, për të qenë në situatë konkurrimi edhe me mediat elektronike. Gazetat në Kosovë nuk ishin koherente në këtë fazë dhe ato akoma publikonin lajme me përbajtje të thjeshta përgjegjje ditore në vend që të përqendrohen në raportime. Nuk ishin të suksesshme në është këtë proces.¹⁶¹

Faktori i dytë eshtë politizimi i shtypit. Dyshimi i bazuar se subjektet politike kanë ndikim në gazeta ekziston te pjesa dërmuese e opinionit dhe që nuk ka gazeta të pavarura në Kosovë dhe shumica nga ato mbështeten haptas nga disa subjekte politike.¹⁶²

Faktori i tretë eshtë shpërndarja e dobët e gazetave. Në Kosovë ekziston një sistem shpërndarës po ashtu edhe dy iniciativa si dhe dy iniciativa për të gjitha gazetat në Kosovë. Asnjë nga këto rrjete nuk aplikon shpërndarje në bazë të parimit të kërkesës dhe ofertës. Distribuimi i gazetave mbetet i bazuar në numër të caktuar që do të thotë që disa pika të shitjes merrnin numër të caktuar të gazetave, gjatë gjithë kohës duke mos pasur në konsideratë kopjet e shitura apo ato të kthyera. Veç kësaj në disa pika të shitjes iu lejohet të huazojnë gazetën, i lexojnë ato dhe më vonë i kthejnë pa pasur nevojë për ti blerë ato.¹⁶³

33

¹⁶⁰ <https://www.osce.org/files/f/documents/9/1/67791.pdf>. (qasur më 05.06.2021)

¹⁶¹ Konkludimet nga dy grupet e fokusit, 18 gusht 2009.

¹⁶² 33 ty.

¹⁶³ <https://www.osce.org/files/f/documents/9/1/67791.pdf>. (qasur më 05.06.2021)

⁸
Në mars të vitit 2020 dy gazetat e fundit, “Koha ditore” dhe “Epoka e re”, ndërprenë botimin, pas masave të marra nga qeveria për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe ato vazhduan punën online.

⁸
Përparimet në teknologji, po ashtu edhe rritja e mjeteve sociale ka bërë të veten dhe gazetat ta humbin betejën në aspektin e informimit. Mediat online, po ashtu edhe ekspansioni i mjeteve sociale e ka bërë të vetën, dhe kjo faktikisht ka bërë që gazetat ta humbin garën në aspektin e asaj gazetarisë që ka të bëjë me shpejtësinë. Por rrethana më e disfavorshme është mungesa e politikave të institucioneve të Kosovës se si me e pasur një qëndrim lidhur me hapësirën mediale duke përfshirë edhe gazetat.¹⁶⁴

⁸
Ekspert të fushës e shohin këtë ndërprerje të shtypit si fillim të një epoke të re. Kodi i etikës rret mediave të shkruara në vendin tonë është instrument vetëregullues, përmes së cilit mediat e shkruara dhe portalet duhet të respektojnë ndërtimin e lajmit apo hulumtimit të tij. Me krijimin e këtyre standardeve vetëregulluese, mediat i ndihmojnë vites duke fituar besimin e lexuesve të tyre por edhe në vlerësimin e publikut për to si media të pavarura dhe të përgjegjshme.¹⁶⁵ Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dha periudha e pandemisë Covid-19 i ka nxjerrë nga tregu shtypin ditor dhe periodikun. Aktualisht në Kosovë dominojnë portale dhe media online, të cilat duhet të respektojnë ligjin **dhe kodin e mediave të shkruara**.

Objektiviteti duhet të jetë synim i secilës media. Mirëpo në praktikë ndodhin lëshime të cilat shtojnë mosbesimin tek mediat. Në rast të tillë qytetarët duhet ti drejtohen këshillit të mediave me apo pa vetëdije nuk mbrohen fëmijët, nuk mbulohen pamjet e tyre apo intervistohen fëmijët pa i llogaritur pasojat për ata.¹⁶⁶

¹⁶⁴ <https://kallxo.com/lajm/perendimi-i-shtypit-ne-kosove/>.(qasur 17.06.2021)

¹⁶⁵ <https://kallxo.com/gjate/mendime/trendet-e-shkeljeve-te-etikes-ne-kosove-nga-mediat-e-shkruara-mungesa-e-zbatimit-te-standardeve-nderkombetare-te-gaztarise/> (qasur 12.05.2021)

¹⁶⁶ <https://kallxo.com/gjate/mendime/trendet-e-shkeljeve-te-etikes-ne-kosove-nga-mediat-e-shkruara-mungesa-e-zbatimit-te-standardeve-nderkombetare-te-gaztarise/>. (qasur 17.03.2022)

4.11. KOMUNIKIMI VIRTUAL

Me depërtimin e teknologjisë së informacionit shekulli (XX) në një formë tjetër fillon edhe ri dizajnimin e mënyrës së komunikimit. Bartja e porosive përmes postës elektronike, video konferencave etj. lehtësoi bartjen e informacionit dhe komunikimin. Këto forma të reja dita - ditës të zhvilluara lehtësuan aspektin ekonomik dhe kohën duke mundësuar komunikimin direkt.

Rrjetet kompjuterike mundësuan që porosit e formave të ndryshme, audio, video, foto dhe të shkruara të jenë shumë të shpejta përkatësisht në kohë reale analog sikurse në komunikimin me telefon. Bartja e shpejtë e porosive pavarësisht largësisë ka mundësuar ridizajnim të sistemit organizativ dhe ndryshimit në komunikim përmes modeleve të reja sa horizontale edhe elastike. Këto kanë gjeneruar komunikime elektronike virtuale përparësi të cilën janë duke e shfrytëzuar në gjithë botën varësisht organizimeve të ndryshme të niveleve të ndryshme si afariste, sociale, akademike, medias e deri te ato politike.

Organizimi i takimeve virtuale përmes teknologjisë krijoi lehtësim në komunikim sidomos në kohë të pandemisë Covid-19 ndërsa planifikimet objektivat arrihen përmes kësaj forme të komunikimit pa pasur nevojë për paraqitje në punë, ligjëratë apo takime të rëndësishë së caktuar për çdo ditë.

Në aspektin e përcaktimit komunikimi i tillë ofron mundësi që distancat mos të llogariten fare dhe se ato i mbeten të kaluarës kështu me këtë formë njerëzit janë më afër njëri tjetrit në kuptimin e qasjes dhe komunikimit(Halili,2012,f.45).

Punën nga ambientet e banimit (shtëpia) psikolog social e vlerësojnë si negative e cila shpie drejt humbjes së sjelljes humane të një shtrese të caktuar të cilat në vete sjellin:

Ndarje e vështirë e jetës private nga puna,

Humbja e përvojës së përbashkët,

Krijimi i distancave dhe dobësimi i kohezionit të grupit,

Cungon ndjenjën e përkatësisë dhe të afërsisë dhe

Reduktohet roli i faktorit njeri i cili duhet të dijë të shfrytëzoj mjetet elektronike.¹⁶⁷

¹⁶⁷ Po aty.

Zëvendësimi i komunikimit formal që ka për qëllim komunikimin zyrtarë në këmbim të porosive i cili organizohet brenda hierarkisë dhe niveleve të caktuara si atë vertikal dhe horizontal dhe që mund të jetë i dy anshëm (bilateral) edhe mes grupit duke shtuar në këtë rast edhe aspektin social më të favorshëm dhe në anën tjetër komunikimi jo formal i cili e bart informacionin edhe jashtë rrjetit zyrtarë komunikues dhe bart informacione më të shpejta kur të zëvendësohen me komunikimin virtual sjellin një risi në arritjen e shpejtësisë së bartjes së informacionit përmes komunikimit të drejtpërdrejtë drejt arritjes së qëllimit të caktuar duke fituar në kohë për përcjelljen e informacionit si në drejtim të grupit të caktuar (të myllur) ose edhe përmes opsonit të komunikimit me masën përmes medias nga liderë të caktuar të drejtuar me porosi për komunitetin apo edhe duke prezantuar informacione (edicione informative, emisione të drejtpërdrejta etj.) drejtuar opinionit.

Komunikimi virtual ofruan mundësi të shumta duke eliminuar distancat dhe kohën për informacionin e marrë nga burimi edhe përmes formës online të pranimit të informacionit me mundësi edhe të bashkëbisedimit në raste të caktuara sikurse konferanca shkencore etj. Me një fjalë secili ndryshim në vete ngërthen dy anët e medaljes të arriturat karshi formave tradicionale, andaj me përllogaritjen dhe matjen e progresit në aspektin e përgjithshëm veprimet e duhura për ndryshim pozitiv i kontribuojnë të mirës së përgjithshme.

Kështu ky avancim në teknologji ka bërë që përvëç shkurtimit të procedurave përmes faqeve të internetit të jenë të pranishëm dhe të shpejtë me informacione si për edicione informative po ashtu edhe për qëllime tjera mediale dhe gradualisht është duke e bërë më pak të rëndësishëm aspektin procedural të marrjes së informacionit për editim nga përfaqësues të medias elektronike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në kohë reale mund ti bartin informacionet deri te audiencia e mediumit përkatës përmes aplikimit të teknologjisë së informacionit.¹⁶⁸

Paraqitjet virtuale nga vendi i ngjarjes në kohë reale e bëjnë kredibil përkushtimin e medias që të jetë sa më afér audiencës me informacion të saktë dhe të identifikuar edhe në aspektin e pamjes.

2

¹⁶⁸ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkt-to.org%2Fsh%2Fabout%2Fpurpose> Halili.R “ Sjellja Organizative “ , (qasur më 14.04.2021).

Ndërsa kjo është dëshmia reale e cila e ka evoluuar situatën në informim të opinionit publik dhe njoftimin e duhur për ndryshimin e kërkuar të bazuar në argument audio-viziv për problemin e trajtuar nga mediumi përkatës.

Për një informim të shpejtë dhe gradualisht edhe duke u avancuar edhe me pajisje tekniko - teknologjike komunikimi dhe raportimi virtual dita - ditës është duke u aplikuar më shumë ndërsa për këtë rrjeti i internetit e ka bërë botën e vogël dhe mundësinë që të kemi informacionin e shpejtë dhe të saktë duke aplikuar teknologjinë e informacionit.

Me krijimin e këtyre mundësive për komunikim virtual të praktikuara çdo ditë e më shumë thuaja secili përdorues i kësaj teknologjie ka një mundësi për editim të një informacioni në kohë reale përmes rrjeteve sociale krahas atyre të cilat janë duke i aplikuar edhe në media elektronike dhe kështu të kenë komunikim në kohë reale e cila ka sjellë ndryshim sidomos në informim publik dhe komunikim tek personat juridik dhe fizik.¹⁶⁹

169

https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.researchgate.net%2Fpublication%2F315035659_NDIKI_MI_I_SISTEMEVE_TE_INFORMACIONIT_NE_SIpermarrje_IMPACT_OF_INFORMATION_SYSTEMS_I_N_ENTREPRENEURSHIP(qasur më 24.03.2021).

Kapitulli V

Kapitull përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë përfshin një përbledhje të 14 rasteve studimore, të cilat përfaqësojnë variacione të ndryshme të organizimeve sociale në Kosovë. Pjesa e dytë paraqet analizë të studimeve të rastit, me qëllim të identifikimit të tipareve themelore të subjekteve sociale në Kosovë. Pjesa e tretë përmban intervistat me përfaqësues të institucioneve dhe subjekteve të përfshira në procese të krijimit të politikave drejt organizimit social, sistemeve mbështetëse, duke përcaktuar organizimin social në Kosovë dhe rolin e saj në shoqëri. Për shkak të natyrës hulumtuese të studimit dhe specifikave të kontekstit Kosovar në të cilin organizimi social evoluon, prezantohen kritere shtesë - risitë në qasje, aktivitetet, identifikimi i aktorëve social – organizativ dhe pikëpamja rajonale. Risia në sferën sociale tregon natyrën e organizimit të veprimit dhe orientimin shoqëror. Eksplorimi rajonale synon sigurimin e njohjen e dallimeve apo ngjashmërive mes rajoneve edhe pse Kosova është e vogël. Përzgjedhja e rasteve për hulumtim janë përcaktuar duke e përbushur së paku një kriter nga secila kategori.

Tabela 6. Kriteret për zgjedhjen e rasteve të organizimit social në Kosovë.

<i>Dimensioni Ekonomik</i>	<i>Ekzistenza e aktivitetave të prodhimit ose shitjes së produkteve ose shërbimeve.</i>
	<p>Shkallë e autonomisë, që organizata themelohet dhe drejtohet nga një grup individësh, jo një institucion shtetëror ose kompani private.</p> <p>Marrja e shkallës së rrezikut ekonomik në aktivitete, të veprimit të tregut.</p> <p>Shuma e punës së paguar, mund të ketë forma të tjera të punës (vullnetare)</p>
<i>Dimensioni Social</i>	<p>Qëllimi i quartë është misioni për komunitet, veprim që synon të mirën e përbashkët të komunitetit.</p> <p>Iniciativë e nisur nga grup qytetarësh, e cila bazohet në dinamikën kolektive të ndryshimit social.</p> <p>Forma demokratike e qeverisjes (e bazuar në parimin e një anëtar - një votë), pavarësisht pronësisë.</p> <p>Pjesëmarrja e organizimit sociale, përfshirë pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm (jo vetëm të pronarëve dhe anëtarëve).</p> <p>Shpërndarja e fitimeve, duke kufizuar akumulimin e fitimit individual.</p>
<i>Kriteret Shtesë</i>	<p>Inovacioni në veprim. (duke mos imituar diçka që ekziston)</p> <p>Identifikimi (i brendshëm ose i jashtëm) i veprimtarisë organizative sociale.</p> <p>Shpërndarja rajonale.</p>

Shpërndarja rajonale është një kriter i plotësuar pjesërisht. Ndonëse në shumicën rajoneve kishte e mundësi të identifikohen iniciativat socio - organizative në forma të ndryshme. Numri i vogël i hulumtimeve në disa pjesë e bën më të vështirë vlerësimin për ndryshime socio - ekonomike në rajone. Përqendrimi i organizimeve socio - ekonomike është i madh në Prishtinë, ndërsa nëpër rajone kryesisht janë nëndegë të organizatave sociale.

5.1. Rastet Studimore

5.1.1. Studime të rastit: Përbledhje

Në këtë pjesë, prezantojmë rezultatet empirike të hulumtimit në (14) organizata në Kosovë dhe jashtë vendi të cilat janë identifikuar shembuj të organizimeve sociale. Rezultatet e hulumtimit janë paraqitur në formën e raporteve të rasteve. Pjesa e parë përshkruan organizatën e identifikuar si organizatë sociale, d.m.th. jepet një pasqyrë e jashtme e organizimit social. Janë përdorur materiale që disponuam si statute, raporte, botime dhe materiale dhe dokumente të tjera dhe burime në internet, pastaj materiale të mbledhura përmes intervistave me përfaqësues të organizatave dhe hulumtimeve të studiuesve.

Pjesa e dytë paraqet një analizë të grupit bazuar në pyetjet e bëra për të gjithë pjesëmarrësit, të cilët kërkuant të identifikojnë disa aspekte, nga kuptimi i sipërmarrjes sociale dhe organizimi i tyre në kontekstin e organizimit social, te perceptimi i rolit të organizatës sociale në shoqëri. Të dhënët dhe informacionet janë marrë përmes intervistave me përfaqësues të organizatave. Bazuar në këtë pjesë të hulumtimit, ne do të përpinqemi të identifikojmë format në të cilat shfaqet organizimi social në Kosovë, cilat janë tiparet dhe si shihet roli i tyre në shoqëri. Duke vepruar kështu, do të bëhen përpjekje për të identifikuar modelet mbizotëruese të sjelljes ose mirëkuptimit për ndryshimin socio - ekonomik në grupin e qytetarëve dhe në përgjithësi në shoqërinë Kosovare.

Te studimi i rasteve bashkëpunimi ishte korrekt dhe i vazhdueshëm me përfaqësues të organizatave deri me mbylljen e tyre me qëllim të komunikimit për të përditësuar informacionet e mundshme të reja për shkak të dinamikës së zhvillimit të jetës në kohë reale derisa janë përgatitë intervistat ndërsa situata e përgjithshme sidomos me pandeminë Covid-19 ka bërë që të kemi kontakte sipas nevojës edhe të drejtpërdrejta por edhe me komunikim sidomos me organizatat të cilat funksionojnë në vend. Ndërsa me organizatat jashtë vendi komunikimi përmes teknologjisë së informacionit ka mundësuar të jemi në kontakt për secilin ndryshim të mundshëm me zyrtarë të organizatës përkatëse ose drejtpërdrejtë me të intervistuarin.

Tabela 7. Të dhënat për organizatat e hulumtuara

Subjekti	Vendi	Forma e organizatës	Fusha e veprimtarisë	Viti i themelimit	Të hyrat vjetore	Numri i punonjësve	Pozita e të ekzaminuarit
Klubi Dëshira	Prishtinë	OJQ jo fitim prurës	Reabilitimi i personave nga sfera e shëndetit mendor	27.11.2001	2019 34.6555 €, 2020 7800 €, 2021 7860 €.	Të rregullt 2 pjesërisht 6	Nusret Shillova Drejtor
SHHBK " Nëna Terezë"	Prishtinë	Shoqatë humanitare	Veprimtari shërbysese humanitare	1990, riregjistruar i 2000 dhe 2008	2019 524,013 €, 2020 383,995 € 2021 parashikimet 772,000 €	Të rregullt 10 pjesërisht 1 5	Zef Shala Drejtor Gjeneral
Shoqata e Pensioni stëve të Prishtinës	Prishtinë	Organizatë joqeveritare	Veprimtari shërbysese humanitare	Themeli 1947, ri regjistrim në vitin 2000.	Punë vullnetare pa të hyra të rregulla.	Të rregullt 4	Asllan Asllani Kryetar
Kultura multietnike në Kosovë	Fushë Kosovë	OJQ-ë	Veprimtari avokuse shërbysese humanitare	2010	2019 8.000€ 2020 18.000 € 2021 7.000 €	Të rregullt 5 pjesërisht 10 -15	Ridvan Gashi Drejtor
Forumii Aftësisë së Kufizuar i Kosovës	Prishtinë	OJQ	Avokim	2017	2019 106.025€ 2020 209125€	Të rregullt 8 pjesërisht deri 40	Bujar Kadriu Drejtor

Shoqata Shqiptar o- Zvicrane “ Kushave ci”	Schliren, Zurich Zvicér.	OJQ	Veprimtari kulturo-humanitare.	2016	Të hyra nuk prezantojnë, ndërsa thonë se vetëm donojnë.	13 anëtar të kryesisë.	Benhard Topalli, anëtar i kryesisë së Shoqatës
Shoqata “ Miqësia Franko Shqiptar e”	Francë/ Annemas se	OJQ	Administrative Binjakëzime Kulturë Eksposita Sportive Media Bashkëpunime Universitare Ekonomike Trajnimë mjekësore Humanitare	21/02/1994	Të hyrat Kontribuite Donacione	Aktivist /volunter sipas nevojës	Tahir Shabani – President
“Qatar Charity”	Prishtinë	OJQ	Humanitare	2000	2019 3,990,466.00 2020 4,868,029.00 2021 1,423,193.00	20 anëtar, staf i rregullt	Mahmoud Shaker Drejtor i Organizatës
Lidhja e Invalidëve dhe viktimave civile dhe të zhdukur	Drenas	OJQ	Humanitare resocializuese	2000	Të hyra nga donacionet	Aktivist voluntarë sipas nevojës	MMustaf Prengajbbb Mustafë Prengu Përgjegjës i OJQ

në Kosovë.							
Shoqata kulturor e “ 17 Shkurti.	Baden	OJQ	Aktivitete kulturore dhe humanitare.	2008	Pa te hyra por me vete donim për aktivitetet	Aktivist te rregull 30 dhe sipas nevojës edhe te tjerë bashkëkom bës.	Tahir Turkaj Kryetar i shoqatës
Oda Ekonom ike Gjerman o- Kosovar e	Prishtinë	Asociacion Ekonomik	Ekonomik	2012		10 të rregullt dhe 130 anëtar	Besnik Beqiri Kryetar i Odës
Shoqata Humanit are Bamirsë se “ Bereqeti “	Prishtinë	OJQ	Aktivitet humanitar	2001	Të hyra në të mira materiale nga donator	Aktivist vullnetar dhe punëtor të herë pas hershëm me pagesë ditore	Xheladin Fazliu Sekretar i SHHB
Drejtori Komuna le e Mireqen ies Sociale Gjilan	Gjilan	Institucion publik lokal dhe qeveritar	Shërbime shëndetësore dhe të mirëqenies sociale	1972 ndërsa DSHM-ë - nga 2002	Institucion i paguar nga buxheti i shtetit 2002	23 të punësuar, përfshirë 282 me kod buxhetor te QKMF plotësuar edhe nga Caritasi me 40 persona për kohësish.	Mursel Zyberi Drejtori i QPS-ë Gjilan.

“Rrjeti i Grave të Kosovës”	Prishtinë	OJQ	Veprimtari avokatie për të drejtat e grave	Viti 2000 fillimi i aktivitetit ndërsa 2003 regjistrimi	Donacione nga organizata ndërkomëtare	Numri i punonjësve përkatësish t aktivisteve të irregullt ose me pjesëmarrje të kohëpasko hshme 180 organizata	Igballe Rogova Drejtore ekzekutive
-----------------------------	-----------	-----	--	---	---------------------------------------	--	------------------------------------

Kërkesa iu dërgua të gjitha organizatave ose individëve të identifikuar për të marrë pjesë në hulumtim si pjesë e përgatitjes së disertacionit të doktoratës. Katërmbëdhjetë iu përgjigjën kërkesës që të jenë pjesë e përfshirjes në studim. Intervistat me përfaqësuesit e organizatave janë zhvilluar në periudhë kohore nga Qershori 2021 deri më Qershori 2022.

Shumica e intervistave janë kryer gjatë vizitës personale në organizata. Gjatë periudhës së hulumtimit, organizatat janë kontaktuar disa herë për të verifikuar të dhënat, mbledhjen e informacioneve shtesë dhe për sqarime të mundshme. Intervistat u bazuan në intervista gjysmë të strukturuar. Kjo metodë siguroi depërtim në perceptimin dhe qëndrimet e të anketuarve dhe u jep atyre hapësirë të lirë për përgjigje, që rrit aftësinë për të identifikuar aspekte të pa parashikuara të objektit kërkimor dhe rrit vlerën e hulumtimit.

Për këtë hulumtim të cilit iu përgjigjen 14 subjekte të ndryshme duhet potencuar edhe argumentin që 4 organizata tjera nuk kishin gatishmëri të përgjigjen në këtë projekt hulumtues empirik me arsyetimin për dinamikë të madhe të punës dhe mungesës së kohës.

5.1.1.1. Rasti studimor 1

Klubi “ Dëshira “, Prishtinë

OJQ, Klubi “ Dëshira ” është regjistrues në vitin 2001 si një domosdoshmëri e kohës së re të pasluftës në Kosovë me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore të rasteve sociale me tematik nga fusha e shëndetit mendor problem ky i cili ishte jo mjaftueshëm i njohur dhe realizuar nga e kaluara në Kosovës në sistemin monist e sidomos në atë të dekadës së fundit,¹⁷⁰ të shekullit të kaluar përkatësisht të viteve të 90-ta kur gjithçka ishte e futur në masa të dhunshme të sistemit serb në Kosovë.

Ndërsa qëllimi i regjistrimit dhe themelimit të OJQ klubit “ Dëshira “ me seli në Prishtinë vjen si nevojë e identifikimit të aftësive kreative të fshehura dhe kurrë të afirmuar të personave me probleme të shëndetit mendor të cilët iu kishin ekspozuar sfidave të bashkë me diskriminimin nisë nga familja, rrathi shoqëror dhe ai institucional. Me krijimin e rrethanave të reja sikur hapen dritare të reja të cilat iu kishin qëllim promovimin human të personave me probleme të shëndetit mendor të cilët nga e kaluara ishin konsideruar barrë e familjes e shoqërisë dhe ishin margjinalizuar si vetë personat edhe familjet e tyre.

Aplikimi i metodologjive shkencore dhe profesionale nga fusha e shëndetit mendor nga ana e profesionistëve shëndetësor për largimin gradual të këtyre personave nga farmak terapia dhe ambienti spitalor ishte qëllimi primar.

Duhej ndërtuar bindjen te personat me probleme mendor se janë të dobishëm për rrithin shoqëror duke synuara gjithnjë avancimin e tyre në fusha të ndryshme, varësisht prirjes të tyre nga e kaluara. Me kalimin e kohës shtohet numri i personave të identifikuar me probleme shëndetësore mentale, ndërsa fillimi i aktivitetit të OJQ klubit “ Dëshira “ nisë me 5 deri 10 persona në hapat e parë të punës më 2001. Mirëpo sa shtoheshin vjetët e punës dhe aplikimi i metodologjive të punës profesionale rehabilituese për personat me shëndet të rënduar mendor shtohet edhe numri i personave të cilët anëtarësohen si rezultat i punës profesionale, vetedukimit të familjeve dhe rrithit shoqëror për ti nxjerrë nga mbyllja pa vepër penale “ Në burg shtëpiak ”.

2

¹⁷⁰<https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.iium.edu.my%2Fdeed%2Fquran%2Falbanian%2Ftemanexhat2.html>(qasur më 22.04.2021).

Për 20 vjet punë, angazhim dhe përkushtim në OJQ klubit “ Dëshira “ ka arritur të identifikojnë dhe trajtojnë rreth 200 persona të dyja gjinive e ku dominon numri i meshkujve në raport me femrat, kurse mosha e personave anëtar te OJQ Klubi ” Dëshira “ është e ndryshme.

Fillimi ishte sfidues mirëpo me kohën u arrit që së pari të ndryshojmë vetveten duke mos besuar që ndoshta do të kemi numër kaq të madh të njerëzve me shëndet të dëmtuar mendor meqë. Dilemat se në Kosovë persona me probleme të shëndetit mendor kishte për faktin që informacionet sporadike dhe problemet e dala nga lufta e fundit e viti 1998/99 jepnin sinjale për shtimin e numrit të tyre, ndërsa trajtimi i duhur i këtyre personave në Kosovë vlen për tu dëshiruar, andaj edhe kjo ishte dhe mbetet intanca që trajtimi i këtyre personave duhet avancuar, ndërsa bazike mbetet përbushja e konventave ⁵² ndërkombëtare për të drejtat e njeriut edhe në Kosovë,¹⁷¹ në mënyrë që të dëshmohet demokratizimi i shtetit të Kosovës.

Kjo sjell reformat dhe personat me probleme të shëndetit mendor duke u trajtuar të barabartë në shoqëri pa dallim të specifikave shëndetësore e jo të etiketohen e emërtohen me emra dhe shprehje jo meritore të cilat nuk ka arsyë të përmenden as me këtë rast. Trajtimi profesional i këtyre personave është realizuar me profesionalizëm të shëndetit mendor siç është rehabilitimi fizik dhe mendor të pasuar me aktivitete tjera në natyrë me qëllim të nxjerrjes jashtë ambientit të mbyllur dhe përmirësimin e shëndetit të anëtarëve të klubit “ Dëshira “. Në këtë rrafsh shtohet angazhimi në seanca të trajtimit psikologjik dhe seanca individuale të cilat kanë avancuar shëndetin mendor të anëtarëve me këshillim psikologjik dhe mbështetje psiko - sociale për jetë të pavarur.

Qëllimi i trajtimeve ka të bëj me transferimin e njohurive, shkathtësive dhe aftësive te anëtarët tjerë. Kurse kjo metodologji shoqërohet përmes tregimeve individuale, lojës, diskutimeve dhe fotove të gjendjes së tyre psiko - sociale.

Numër i konsiderueshëm i anëtarëve të klubit “ Dëshira “ është i angazhuar në punëtori të ndryshme bazuar në shkallën e intelektit dhe në praktika profesionale ku shpesh ballafaqohen me përshtatje në ambiente të punëtorive. Deri tani me këto të arritura në OJQ klubit “ Dëshira “ vetëkënaqësia nuk ka vend përkundër rezultateve evidente të arritura dhe arritja e ndryshimit te

2

¹⁷¹ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fncd-ks.com%2Fstorage%2Fapp%2Fuploads%2Fpublic%2F5dc%2F892%2Fx\(qasur më 23.05.2021\)](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fncd-ks.com%2Fstorage%2Fapp%2Fuploads%2Fpublic%2F5dc%2F892%2Fx(qasur më 23.05.2021))

personat e trajtuar nga gjendja para trajtimit ku vërehet gjendja e tyre shpirtërore dhe emocionale si rezultat i punës profesionale dhe risocializimit dhe ri integrimit të tyre në komunitetin ku jetojnë.

Mediat në përgjithësi të shkruara më herët sa ishin aktive në vendin tonë krahas atyre elektronike i janë përkushtuar punës së OJQ Klubit “Dëshira”. Konsiderojmë se puna e Klubit “Dëshira” është prezantuar kënaqshëm në mediat e vendit dhe përmes kësaj pune të mediave është arrit të zbulohen raste të reja të personave me probleme të shëndetit mendor të cilët janë paraqit tek klubit “Dëshira” për tu trajtuar. Për këtë nuk ka munguar roli i institucioneve dhe familjes në mënyrë që këta persona mos të mbeten të mbyllur.

Prezantimi i aktivitetave në ambiente të klubit “Dëshira” dhe në ambient të jashtëm publik si në natyrë, ekskursionet ditore dhe javore brenda dhe jashtë vendi me qëllim të ndryshimit social të këtyre personave janë përcjell si aktivitet i nevojshëm dhe dobishëm nga mediat të cilat kanë prezantuar këto aktivitete nëpër edicione informative dhe emisione tjera të ndryshme brenda skemës programore dhe në emisione enkas për këto kategori si p.sh te mediumi publik RTK-ë në emisionin “Mundësi” dhe “Refleksion” emisione të cilat trajtojnë problematika socio - ekonomike¹⁷² në vend dhe në emisione tjera të mediumeve komerciale. Duhet potencuar se bisedat në studio nuk kanë munguar e këto janë realizuar me qëllim të ndryshimit socio - ekonomik në përgjithësi të shoqërisë Kosovar e në veçanti të personave me aftësi të kufizuar si në rastin konkret për personat me probleme të shëndetit mendor.¹⁷³

42

Me kalimin e kohës dhe zhvillimin e rrjeteve sociale po ashtu kemi arritur të jemi të pranishëm edhe në ato mjedise ku mediat nuk kanë mundë të realizojnë apo nuk i kanë pasur në skemat e tyre programore, programe kushtuar personave me aftësi të kufizuar si në rastin konkret të atyre me probleme të shëndetit mendor.¹⁷³

2

¹⁷²https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F12256835%2FKonceptet_baz%25C3%25AB_t%25C3%25AB_zhvillimit_ekonomik (qasur më 21.05.2021).

¹⁷³ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Nusret Shillova.

Rekapitullim:

Dimensioni ekonomik i trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor në OJQ klub “Dëshira” nuk është synuar asnjëherë duke ditur që krijohen kosto të harximeve nga mbështetja institucionale dhe donatorë të ndryshëm, megjithatë dimension i veçantë konsiderohet risocializimi dhe arritja e ndryshimit që disa nga anëtarët e klubit tashmë janë të integruar në punë dhe aktivitet tjera të cilat mund t’ju krijojnë të ardhura duke ua blerë punën e dorës si: Kartolinat, pikurat e ndryshme etj. punë të cilën e realizojnë në klub kryesisht por edhe në shtëpitë e tyre.

Ndërsa sa i përket dimensionit social mund të thuhet që personat me dëmtime shëndetësore të cilët janë pjesë e vijimit ditor në klubin “Dëshira” janë të risocializuar në shoqëri, ata janë të pavarur në aktivitet e tyre si në klub edhe në familjet e tyre. Megjithatë mbështetja e profesionistit dhe institucioneve si vendore dhe ndërkontëtare i bën që ata të avancojnë çdo ditë dhe të jenë të dobishëm për veten e tyre, familjen dhe shoqërinë.

Te veprimet shtesë konstatohet që OJQ klub “Dëshira” nuk ka degë të saj në ndonjë qytet të Kosovës derisa veprojnë e punojnë të pavarur por në bashkëpunim me Forumin e Aftësisë së Kufizuar të Kosovës, me qendrat e shëndetit mendor nëpër komuna të Kosovës si institucione publike në Kosovë kanë bashkëpunim mes vete. Autonomia e plotë e synuar në raste individuale është arritur te disa anëtarë të OJQ klubit “Dëshira” që të punësohen në institacione me orar dhe vend të përshtatur sipas shkallës së dëmtimit shëndetësor por edhe me avancim dhe vazhdim të fazës së shkollimit ku kishin mbetur sikurse dhe duke zhvilluar aktivitetet e hapjes së ekspozitave personale sikurse në art etj.

OJQ klub “Dëshira” me seli në Prishtinë radhit sukseset falë përkushtimit të stafit të organizatës, anëtarëve të sajë, institucioneve vendore dhe ndërkontëtare dhe mbi të gjitha ka arrit të mbjell optimizëm tek familjet dhe qytetarët që pavarësisht situatës të shëndetit mendor qytetar të sfiduar me probleme të shëndetit mendor nuk duhet diskriminuar dhe mohuar të drejtë e tyre e të qenit të barabartë në shoqëri dhe shfrytëzimin e drejtës për tu trajtuar nga ekspert të shëndetit mendorë¹⁷⁴ për të arrit rezultate drejt pavarësimit të plotë në shoqëri.

2

¹⁷⁴ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkt-to.org%2Fsh%2Fabout%2Fpurpose\(qasur më 21.03.2021\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkt-to.org%2Fsh%2Fabout%2Fpurpose(qasur më 21.03.2021).)

Megjithatë sfiduese ishte dhe mbetet pandemia Covid-19 e cila ngarkon edhe më shumë situatën lidhur me përkujdesjen e duhur për këta persona për të cilët nevojitet angazhim shtesë i personave të cilët merren me problemet e personave me probleme të shëndetit mendor.

5.1.1.2. Rasti studimor 2

SHHB “ Nëna Terezë “, Prishtinë.

Shoqata humanitare bamirëse (SHHBK) “ Nënë Tereza “ e themeluar më 10.05.1990 si një domosdoshmëri e organizimit - bashkimit të qytetarëve për të ndihmuar familjet në nevojë të cilët ishin privuar nga puna për shkak të ndikimeve politike pas shuarjes së autonomisë të Kosovës në ish Jugosllavisë, bazuar në nenin 22 dhe 23 të Ligjit mbi organizatat dhe Shoqatat qytetare të (Gazeta Zyrtare KSAK nr.28/1984) SHHBK-ë regjistroi subjektivitetin e sajë humanitarë me mision të sigurimit të minimumit ekzistencial të familjeve të rrezikuara nga aspekti ekonomik.¹⁷⁵ Bazuar në këtë dokument të nxjerrë ligjërisht SHHBK veproi deri në Dhjetor të vitit 1999 kurë bëhet ri regjistrimi sipas legjislacionit të Institucioneve të përkohshme ndërkontinentale në Kosovë (UNMIK).

Më themelin e Institucioneve të shtetit të Kosovës edhe njëherë u realizua regjistrimi. Ndërsa me këtë dokument zyrtarë të Republikës së Kosovës shoqata funksionon sot e kësaj dite. Me regjistrimin e SHHBK-ë pa dilemë që kishim objektiva të zbatimit të profesionalizmit në rrafshin social të fuqizuar me regjistrim, deshifrimin dhe ndarjen e të mirave materiale të përfituar nga donatorë të ndryshëm me qëllim të zbutjes së situatës socio - ekonomike në rrëthana kohe që fillimisht nuk mund të parashiheshin ndryshimet bazuar në shtimin e rasteve që dita - ditës shtoheshin familje të cilat mbeteshin pa të zënët me punë krahas atyre të cilat ishin në shkallë varfërisë ekstreme.¹⁷⁶ Përgjatë viteve kemi edhe shtim të rasteve të cilat e ngarkonin punën e

¹⁷⁵ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fbislame.net%2Fmyftiu-ternava-te-pagjeturit-sfide-per-kosoven%2F> (qasur më 23.07.2021)

¹⁷⁶ <https://google.com/url?sa=D&q=http%3A%2F%2Fhandi-kos.org%2Fwp-content%2Fuploads%2F2020%2F03%2Fbinder.pdf> (qasur më 22.06.2021)

shoqatës e cila merr primatin e organizimit social në vend përmes degëve të shoqatës edhe në komuna tjera të vendit. Gjatë viteve kemi edhe ndryshimin socio - ekonomik i cili tregon rëniengritjet e situatave socio - ekonomike të familjeve kosovare.

Tabela 8. Ndihmat nga SHHBK “Nenë Tereza“ nga viti 1990 deri 2020 për persona dhe familje.

Periudha në vite Persona të ndihmuar Familje të ndihmuara

<i>1990 deri 1995</i>	1.510.603
<i>1996 deri 2002</i>	6.026.750
<i>2003 deri 2008</i>	26.954
<i>2009 deri 2015</i>	25.837
<i>2016 deri 2020</i>	7.041

Tabela 9. Ndihmat e SHHBK “Nëna Terezë“ në vitet sfiduese.

1998 deri në shtator 1999 2.480.241 persona të ndihmuar Lufta në Kosovë

<i>Tetor 1999 - Dhjetor 2000</i>	2.178.000 persona të ndihmuar	Viti i parë pas luftës në Kosovë
<i>2004</i>	3370 familje	Përfshirë edhe fam. nga Maqedonia
<i>2008</i>	4138 familje	Kriza globale e vitit 2008
<i>2019 – 2020</i>	2831 familje	Covid-19 dhe tërmeti ne Shqipëri

Përkushtimi i stafit të SHHBK “Nënë Tereza“ ishte të jetë aty ku ishte nevoja për mbështetjeje të familjeve skamnore. Mund të thuhet se nuk ka munguar edhe përkundër sfidave deri në ato ekzistenciale nga ana e regjimit serb të kohës. Asnjëherë nuk është ndalë aktiviteti për të ndihmuar rastet në nevojë dhe përbush misionin humanitar të mbështetur në besimin e fituar nga donatorët. Kjo na fuqizonte me kryerjen e aktiviteteve humanitare. Mbështetja ishte e shumë dimensioneve si nga faktori vendorë, e në këtë rast mund të flasim për mërgimtarët sikurse edhe për gatishmërinë

e bashkëkombësve në troje etnike në Ish Jugosllavi që të ndanin të mira materiale për familjet në nevojë në Kosovë.

Sigurisht që nëse tentojmë të numërojmë edhe miqtë ndërkombe të do ti hynim në hak ndonjërit prej tyre të cilët ndihmuani popullin e Kosovës në kohë para, gjatë dhe pas luftës për mirëqenie dhe zbutje të varfërisë. Këtë qellim ia kemi arritur më shumë përmes fondeve të institucioneve ndërkombe dhe më pakë përmes fondeve të institacioneve vendore të nivelit qendror apo lokal.

Jemi të kënaqur me te arriturat tona gjatë kësaj periode 30 vjeçare e cila mund të vërehet nga shënimet (dëshmitë) nga tabela me të dhëna në baza vjetore, kurse objektiv i përhershëm mbetet te jemi afër atyre qe kanë nevojë për SHHBK-ë në momentet më të vështira duke respektuar moton e shoqatës: “ Aty kujeta është në rrezik aty jemi ne ”.

E pakontestueshme është se pa komunikim me mediat e shkruara, elektronike dhe tani edhe të atyre sociale opinioni nuk do të ishte i informuar me gjendjen aktuale sociale dhe më pas as me ndryshimin e saj aty ku intervenohet. Pa prezantim të synimeve dhe arritjes së objektivave, media e të tria niveleve e shkruar, elektronike dhe sociale askush nuk mund te prezanton gjendjen aktuale ne terren. Ndërsa hapësirat për prezantim të synimeve dhe objektivave dhe dëshmuan aktivitet e shoqatës “ Nënë Tereza“ nuk kanë munguar si në mediat publike po ashtu edhe në ato komerciale. Për këtë falë përkushtimit mediatic është arrit të evidentohen familje me gjendje të vështirë socio - ekonomike.

Sado që një aksion mbështetës humanitar me qëllim për të ri ngrit familjet në nevojë nëse nuk është bërë publik në media nuk mund të konsiderohet që iu është dhënë pesha e ngjarjes për të cilën interesimi nuk ka munguar asnjëherë si nga donatorët, shoqatat vendore si dhe pushteti lokal dhe qendror.

Me publikimin e ngjarjeve humanitare nëpër media është vërejt shtimi i interesimit të rasteve të rënda socio - ekonomike dhe njëherësh edhe numri i donatorëve si ndërkombe të vendore të cilët mbështetin familjet në nevojë. Andaj pa punën e përkushtuar të medias si sublime i humanitetit shoqëria Kosovare nuk do të ishte kjo që është aktualisht, ndërsa dhe media konsiderohet kontribuues i zhvillimit socio - ekonomik i familjeve nevojtare dhe në përgjithësi edhe shtetit.¹⁷⁷

¹⁷⁷ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Zef Shala.

Rekapitullim

Dimensioni i veprimit të SHHBK “ Nënën Tereza “ ngërthen në vete si dimensionin ekonomik po ashtu edhe atë social. Nga aspekti ekonomik tentonte që përmes mbështetjes së ndryshme nga miqtë e shoqatës si ndërkombëtar edhe vendorë të ngrit gjendjen ekonomike me tendencë të dhënes krah që familjet me gjendje të vështirë ekonomike të ngriten e më pas të krijojnë pavarësi ekonomike edhe përkundër rreziqeve të kohës dhe angazhimit të punës vullnetare të anëtarëve të shoqatës.¹⁷⁸

Kurse nga pikëpamja sociale mëtonte përmes mirëqenies krijimin e një stabiliteti social të përkohshëm duke synuar që të krijon një bilanc për kushtet ekzistenciale te komuniteti sfidues nga aspekti socio - ekonomik, kurse aktiviteti i shoqatës nuk ishte i përqendruar vetëm në një komunë të caktuar por në nivel vendi. Ndërsa për të tentuar arritjen e qëllimit të hyrat vjetore dhe numri i stafit e në veçanti ai i vullnetarëve ndihmon aktivitetin e shoqatës edhe në pandemi.

2

¹⁷⁸ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fkt-to.org%2Fsh%2Fabout%2Fpurpose> (qasur më 11.07.2021).

5.1.1.3. Rasti studimor 3

“ Organizata Komunale e Pensionistëve ”, Prishtinë

Organizata Komunale e Pensionistëve të Prishtinës daton qysh nga viti 1947. Deri në vitet e 90-ta të fundshekullit të kaluar ishte profitable, ndërsa me 1999 kjo organizatë regjistrohet në institucionet e përkohshme ndërkomëtare në Kosovë (UNMIK), ndërsa misioni i sajë sipas regjistrimit kalon me status të një organizatë jo fitimprurëse.

Misioni i themelimit ishte mbrojtjen e të drejtave të pensionistëve, anëtar të shoqatës të dëshmuar përmes regjistrimit të anëtarësisë të personave të cilët arrinin moshën apo për një shkak tjetër kalojnë në pension. Çdo vit ardhjet në Organizatën e pensionistëve ishin më të mëdha sidomos në rrithana kohe kur ekziston mundësitet për mbështetje të pensionistëve me barna, rehabilitim në banja dhe bregdet dhe aktivitete të ndryshme sikurse edhe në transport urban.

Zgjedhja e anëtarëve të organizatës së pensionistëve ka përvojë të organizimit. Zgjedhjet brenda organizatës që mbaheshin njëherë në katër vjet sikurse edhe tanë duke tentuar krijimin e kushteve sa më të mira për pensionistët prej përfaqësimit deri ndihmat për pensionistët. Sigurimi i barërave më herët nuk ka munguar, megjithatë nuk zgjat shumë dhe humbet kjo mbështetje sikurse edhe vetë prania e mjekut dhe infermierës brenda objektit të organizatës që është hapësira e dedikuara për ekipin mjekësor por mjek, infermiere dhe medikamente jo.

Interesimi për të rikuperuar shëndetin në banja dhe plazhe nuk mund të realizohet në mungesë të fondeve të cilat dikur ishin, ndërsa me krijimin e rrithanave të reja ky aktivitet synohet të realizohet me sa më pak kosto financiare duke aplikuar raporte bashkëpunimi nga ana e anëtarëve të shoqatës me pronarë të hotelevë dhe banjave për të siguruar çmim më të pranueshëm për trajtim të pensionistëve.¹⁷⁹

Legjislativi i vendit pa dallim subjektesh sikur është kundër të moshuarve të cilët kur vjen koha për pensionim ndërsa ka persona që nuk mund të arrijnë deri te pensionimi për mungesë të vjetëve të punës e që sipas legjislacionit Kosovar që të gëzosh pensionin duhet pasur 15 vjet stazh pune.

2

¹⁷⁹[https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F305917%2FRreth_Shkaktor%25C3%25ABve_Q%25C3%25AB_Lidhen_Me_Korrupsionin_Rasti_I_Shq\(qasur më 14.06.2022\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F305917%2FRreth_Shkaktor%25C3%25ABve_Q%25C3%25AB_Lidhen_Me_Korrupsionin_Rasti_I_Shq(qasur më 14.06.2022).)

Dinamika e anëtarëve të shoqatës së pensionistëve të Prishtinës nuk është për tu kritikuar për mos punë, për faktin që bashkëpunimin me shoqata në terren e kanë trasuar duke vendos ura bashkëpunimi në mënyrë që të gjejnë mundësi për të mbështetur anëtarët e shoqatës së pensionistëve.¹⁸⁰

Anëtarësimi prej 3 euro në vjet e dëshmon që pensionistët kanë gatishmëri të kontribuojnë duke ua bartur kompetencat udhëheqësve për mbrojtjen e interesave. Bashkëpunimi me shoqatat vendore dhe rajonale funksionon herë pas herë edhe me grupe të interesit, duke dëshiruar që të kontribuojnë për të mirën e pensionistëve që të gjejnë mbështetje për pensionistët anëtar të organizatës. Kjo dëshmohet me ndihmat e realizuara për numër të konsiderueshëm të përfituesve.

Organizata e Pensionistëve të Prishtinës raportet me media i konsiderojnë të përbajtura bazuar në faktin që mediat nuk kanë bërë aq sa kanë pasur mundësi për pensionistët, sidomos në situatën që kurrë vjen momenti i vlerësimit sikurse në fushatë zgjedhore mediat përcjellin personalitetet politike të cilët vizitojnë pensionistët me ambicjen për të vjelë ndonjë votë më shumë. Ndërsa me përfundim të zgjedhjeve zotimet se do të ndryshojnë ligjin pro pensionistëve sikurse edhe uljen e pragut të fitimit të pensionit nga 15 vjet në 10 vjet përvojë pune e jo sa është tani 15 vjet. Kjo irriton pensionistët të cilët kërkojnë nga deputet dhe përfaqësues të institucioneve që të iniciojnë ndryshimin e ligjit për arritjen e pensionit e jo te ketë skema për pensione.

Veç tjerash sfiduese për pensionist konsiderohet Pandemia Covid-19 e cila i ka mbyll pensionistët nëpër shtëpitë e tyre ndërsa në anën tjetër ata thonë: “ Pjesa dërmuese e tyre i janë mbetur barrë e familjes ”.¹⁸¹

2

¹⁸⁰ <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fhr-hr.facebook.com%2FShoqata-P%25C3%25ABrshefca-Zvic%25C3%25ABr-1487315388244848%>(qasur më 13.06.2022).

¹⁸¹ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Asllana Asllani,2021.

Rekapitullim

Në dimensionin ekonomik pensionistët janë kategori shoqërore të cilët nuk arrijnë me mjetet e tyre të skemave të pensioneve tija dalin dhe për pasoj mbeten barrë e familjes përkatësisht pasardhësve të tyre. Organizatës së tyre iu janë gllabëruar fondet nga regjimi serb gjë që kishte ngarkuar situatën ekonomike. Njëherësh organizata e tyre kërkon modalitete dhe forma të ndryshme për tua lehtësuar kushtet jetësore anëtarëve të sajë. Në planin social pensionistët e thonë se dinjiteti i pensionistit është i nëpërkëmbur për pasoj të mjeteve të pa mjaftuara të fituara nga mundi i tyre. Tash kur më së shumti iu nevojitet mbështetja materiale dhe shëndetësore pensionistët sfidohen përveç sëmundjeve të moshës edhe me pandeminë Covid-19 ndërsa sigurimi i barnave sipas protokolleve, sikur pensionisti mos të ketë mbështetje nga familja i prekur me virusin Corona, nuk ka mundësi të mbulon shpenzimet e barnave.

5.1.1.4. Rasti studimor 4

OJQ “ Kultura Multietnike në Kosovë ”, Fushë Kosovë

OJQ “ Kultura Multietnike në Kosovë ” e themeluar 2010 dhe në po të njëtin vit e regjistruar për qëllim kishte promovimin e kulturës dhe gjuhës rome në Kosovë dhe integrimin e komunitetit rom në shoqërinë kosovare. Përveç qëllimit primar të promovimit të kulturës rome siç u tha më lartë sipas statutit të OJQ-ë kemi edhe fusha tjera organizative të mbështetjes së komunitetit posaçërisht atyre me gjendje me të rëndë socio - ekonomike e që tek komuniteti rom është numër i madh të cilët kanë nevojë për mbështetje. Kategoritë në moshë, gratë dhe fëmijët dhe rinia e komunitetit rom janë pa mjaftueshmë të integruar dhe punësuar për pasoj të shkollimit të dobët në vendin tonë.

Angazhimi në OJQ-ë ka filluar me vetë nevojën e regjistrimit të shoqatës duke u organizuar fillimisht dhjetë student të këtij komuniteti të cilët ishin pjesë e themelimit të OJQ-ë, ndërsa qëllim kishim ndryshimin socio - ekonomik duke aplikuar punë vullnetare me ambicie për të ndryshuar gjendjen e komuniteti i cili në fillim ishte në numër të madh të regjistruar për tu mbështet nga

OJQ-ë. Ndërsa qytetarët rom të cilët kanë kërkuar mbështetje nga OJQ-ë ishte në fillim rreth 4500 banorë lokal të regjionit të Prishtinës.

Me kalimin e kohës dhe viteve lëvizjet e personave për tu ndihmuar përfatë mirë bazuar në shifra ato ndryshojnë dhe kjo ishte inkurajuese meqë numri i kërkesave përfatë mbështetje, sidomos të ndihmave përfatë ngritje ekonomike u zvogëlua.

Pa reshtur jemi përkushtuar të mbështesim familjet në nevoje në secilin rast të paraqitur tek ne, ndërsa përkushtimi ynë në bashkëveprim me organizata vendore dhe ndërkombëtare gjithnjë është synuar të zbusim situatën socio - ekonomike të familjeve dhe personave në nevojë. Përveç avokimit dhe ndihmës juridike falas përfatë qytetarët komunitetit rom kemi arrit të mbështesim familjet në nevojë me artikuj esencial ushqimor dhe higjenik. Njëherë kemi ndërmjetësuar edhe tek bizneset private përfatë punësim të pjesëtarëve të komunitetit rom përfatë ti punësuar. Aktivitet me subjekte humanitare vendore dhe ndërkombëtare janë si në vijim:

Ndërtimi i shtëpive përfatë familjet në nevojë (pesë shtëpi) në zona rurale ku jetojnë pjesëtarët këtij komuniteti,

Ndihma me bursa përfatë dhjetë student nga donatorët vendor,

Një mori aktivitetesh përfatë furnizim me material shkollor përfatë fëmijë.

Inkurajim ky përfatë vazhduar shkollimin, ndërsa nuk duhet harruar edhe ndihmat e organizatave ndërkombëtare të cilat janë përkujdes përfatë probleme shëndetësore të komunitetit rom përfatë cilët një herësh janë siguruar barna por edhe veshmbathje. Megjithatë asnjëherë nuk i kemi lënë vend vetëkënaqësisë me të arriturat dhe rezultatet e arritura të organizatës të cilës iniciativat nuk i mungojnë dhe shih përfatë kërkjmë alternativa përfatë t'iu dalë në ndihmë komunitetit rom të cilët janë pak të integruar në sistemin e arsimit, shëndetësisë dhe punësimit, ndërsa banimi i tyre është kryesisht i dobët i cili nuk i përmblush nevojat esenciale përfatë familjen rome e cila është tradicionalisht e madhe me anëtarët të familjes.

Përfatë arritjen e qëllimit sensibilizimi dita - ditës ka arritur të shtohet përmes mediave sociale, ndërsa nuk kanë munguar as edhe aktivitet e mediave elektronike të cilët me shënimet e tyre i kanë bërë publike rastet të cilat kanë pasur nevojë, ndërsa përfatë OJQ-ë ka sugjeruar dhe kontaktuar me përfaqësues të mediave të cilët janë interesuar përfatë rolin e komunitetit rom dhe angazhimin e OJQ

“Kultura Multietnike në Kosovë “ se sa kemi kontribuar me iniciativa për çfarë jemi të regjistruar.¹⁸²

Mediat e shkruara ishin sa për kurtuazi. Kemi detektuar që nuk kanë bërë mjaft për shkak se gradualisht me kohën ato edhe u shuan. Kurse mediat elektronike ishin dhe mbeten katalizator i ndryshimit socio – ekonomik. Sado që mund të ketë qenë atraktiv cilido aktivitet i OJQ “ Kultura Multietnike në Kosovë “ në rastet kur nuk është përcjell nga mediat rezultatet ishin minore për mos ti quajtur raste të dështuara, andaj rol të rëndësishëm për njoftim dhe sensibilizim me organizata si motra në Kosovë dhe ato ndërkombëtare për të ndihmuar komunitetin kishin mediat, të cilat në skemat e tyre përveç shënimit të aktiviteteve ditore në edicione informative iu kanë dhënë hapësirë edhe në emisione si të drejtpërdrejta edhe në ato të përgatitura enkas për trajtim.¹⁸³

Rekapitullim

Në aspektin ekonomik jemi përkushtuar që të kemi sa më pak raste sociale gjë që herë pas herë janë ulë shifrat e familjeve nevojtare, ndërsa me rastin e pandemisë Covid-19 janë rikthyer për këtë ka pasur angazhim për ti rifreskuar listat dhe shtuar angazhim për bashkëpunim me organizata humanitare vendore dhe ndërkombëtare. Në aspektin social jemi përkushtuar të ruajmë egon e secilit qytetar dhe familjar. Ndërsa me institucionet publike kemi pasur takime për gjetje të modaliteteve për të mbështetë këto familje dhe avokuar që ato mos të mbeten të margjinalizuara. Kritere shtese nuk kemi pasur, përveç përkushtimit që në regjionin ku veprojmë në Prishtinë me rrëthinë mos të na mbeten pa u mbështetur familjet në nevojë apo aplikuar subjektivizëm që ndonjërin ta kemi të diskriminuar pozitivisht e ndonjëri të mbetet i pa përfillshim nga cilido aktivitet e OJQ-ë.

2

¹⁸² <https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.evropaelir.qasur më 23.02.2021>

¹⁸³ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Ridvan Gashi, 2022.

5.1.1.5. Rasti studimor 5

OJQ “ Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar i Kosovës ”, Prishtinë

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar i Kosovës (FKAK)³⁷ është i regjistruar si organizatë joqeveritare në janar të vitit 2017. Qëllim kishte mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, pa dallim të kategorisë dhe shkallës së invaliditetit. Synim i forumit është avokimi për zhvillim dhe implementim të drejtave ligjore të personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesur për përmirësimin e situatës së pafavorshme sociale të personave me aftësi të kufizuar.

Në kuadër të zhvillimit të proceseve, Forumi Kosovar i aftësisë së kufizuar përfaqëson të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara anëtarë të forumit e ku përfshihen persona me dëmtime intelektuale, shqisore, fizike dhe mendore etj. Si nevojë për unifikim të qëndrimeve të kërkesave të llojeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar ideja ishte për formimin e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar si organizatë ombrellë e organizatave të personave me aftësi të kufizuara.

Që nga themelimi synimi i anëtarëve të Forumit, ishte që njëzëri të avokojnë ⁴¹ për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, kurse sa i përket numrit të organizatave anëtare të cilat që nga fillimi e përqafuan këtë ide është numër statik aq sa janë regjistruar po aq edhe qëndrojnë brenda forumit sot e asaj dite. Si ⁴¹ Forum është i hapur për anëtarësim të organizatave të reja të cilat përfaqësojnë interesat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe ³⁷ është i angazhuar në vazhdimësi për ligj i cili do të jetë në favor të aftësisë së kufizuar dhe si rrjeti i punës së vazhdueshme të FKAK-së dhe organizatave anëtare tani është në proces draft ligji për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar.

Bazuar në gjendjen ekzistuese dhe sfidës me pandeminë forumi është angazhuar për mos ndërprerje të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara pavarësisht rrethanave meqë për persona me aftësi të kufizuar pandemia Covid-19 ishte goditje e dyfishtë për personat me aftësi të kufizuar.¹⁸⁴

2

¹⁸⁴ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fzh-cn.facebook.com%2\(qasur më 23.07.2021\)](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fzh-cn.facebook.com%2(qasur më 23.07.2021))

FKAK-ë pandërprerë është angazhuar për hartimin e shumë kërkesave drejtuar institucioneve për avancimin e personave me aftësi të kufizuara. Përkushtimi i stafit të FKAK-ë është mirëkuptuar dhe mbështetur nga institucionet qoftë vendore apo edhe ato ndërkombëtare e që për hir të vërtetës mbështetja ndërkombëtare vazhdon edhe më tutje kurse institucionet vendore sikur me kohë e kanë kuptuar seriozitetin dhe përkushtimin e FKAK-ë për sensibilizimin dhe avokimin e nevojave sipas ligjit për persona me aftësi të kufizuara.¹⁸⁵

59

Duke pasur parasysh gjendjen e personave me aftësi të kufizuara ndër vite, mund të flasim për arritje në respektim të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në sfera të ndryshme. Megjithatë, vetëkënaqësi nuk duhet të ketë, ndërsa edhe në të ardhmen presin punë për avancimin e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara. Prandaj, si objektivë kryesore është avokimi për miratimin e draft ligjit për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara nga Kuvendi i Kosovës, ligj përmes së cilit përfaqësohen të gjitha kategoritë e aftësisë së kufizuara e i cili rregullon në mënyrë të duhur zhvillimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara.¹⁸⁶

28

57

Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuari, bashkëpunon ngushtë me media me qëllim të pasqyrimit të gjendjes së personave me aftësi të kufizuara. Si rezultat i kësaj pune të përbashkët, opinioni publik gjithnjë e më shumë është i informuar rrëth aftësisë së kufizuari dhe në të njëjtën kohë puna e Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuari dhe të arriturat e Forumit janë kënaqshëm të pasqyruara.¹⁸⁷

2

¹⁸⁵ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fzh-\(qasur më 23.09.2021\)](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fzh-(qasur më 23.09.2021)cn)

¹⁸⁶ <https://facebook.com%2FRadioStarGjilan%2Fposts%2F1179553318746050%2F>

56

¹⁸⁶ [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fhandi-kos.org%2Fshpallja-e-vitit-2022-vit-i-personave-me-aftesi-te-kufizuara-ne-kosove%2F\(qasur më 23.03.2021\)](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fhandi-kos.org%2Fshpallja-e-vitit-2022-vit-i-personave-me-aftesi-te-kufizuara-ne-kosove%2F(qasur më 23.03.2021))

¹⁸⁷ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Bujar Kadriu.

Rekapitullim

Ndërsa në vazhdën e synimit për ngritje në rrafshin ekonomik roli i Forumit varet nga zbatimi i legjislacionit aktual dhe reformimi i legjislacionit i cili lidhet me mirëqenin e personave me aftesi të kufizuar (PAK), kurse si objektiv e forumit, është puna e vazhdueshme në avokim për këtë çështje. Mirëqenia sociale e PAK nënkupton edukim të mirëfilltë, mundësi që të gjithë të jenë të barabartë, punësim të përshtatshëm për personat me aftesi të kufizuara me theks të veçantë duke u përqendruar te respektimi i ligjit përfaktor që personat me aftesi të kufizuar diskriminimin si pozitiv ashtu edhe atë negativ nuk pëlqejnë meqë e ndjejnë veten të barabartë para ligjit pavarësisht gjendjes së tyre faktike. Forumi duke qenë organizatë ombrellë, bashkëpunon me të gjitha organizatat në nivel vendi, kurse si organizatë ombrellë e aftësisë së kufizuar, forumi si i tillë mund të thuhet se është i veçantë në veprim dhe është zëri i arsyes përfaktor që kufizuar në vend.

5.1.1.6. Rasti studimor 6

OJQ “ Kushaveci “ Schliren, Zvicër

Shoqata Shqiptaro - Zvicerane " Kushaveci " është regjistruar në Shtator të vitit 2016 në Schliren të kantonit Zürich duke iu përbajtur të gjitha rregulloreve të regjistrimit në shtetin nikoqir ku jetojnë komuniteti shqiptar nga vende të ndryshme nga trojet etnike, gjithnjë sipas rregullores, shoqata " Kushaveci " ka statusin e saj përmes së cilës ligjërisht funksionon, ndërsa ka edhe logon e vet e cila dëshmon që shoqata ka subjektivitetin e sajë të funksionimit dhe merret kryesisht me veprime humanitare brenda shtetit ku jetojnë e punojnë si dhe edhe jashtë shtetit kryesisht në vendlindje të bashkëkombësve të cilët emigruan në Zvicër si në rastin konkret fokus të mbështetjes është rajoni i Gjakovës dhe Prizrenit përfundimisht. ¹⁸⁸

Si shoqëri me një kulturë tradicionale e cila i mungon komunitetit shqiptar në Zvicër ka bërë që të kërkojnë modalitete të funksionojmë në mërgim dhe kjo ka mundësuar të ruhet tradita e të parëve

¹⁸⁸ [2](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Falternativa. (qasur më 21.03.2021))

dukë vazhduar me kulturën e familjarëve tona në vendlindje dhe kjo ishte qëllimi i regjistrimit të shoqatës me emër “ Kushaveci ” ku pjesa dërmues e anëtarësisë së shoqatës ka prejardhjen nga atje. Aktiviteti i shoqatës është me karakter lokal dhe për këtë arsy ka pasur aktivitete në Dukagjin dhe në Prizren, ku janë mbështetur disa raste me nevoja humanitare, si dhe ka pasur disa përkrahje kulturore siç është ngritja e përmendores së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në Prizren. Megjithatë primare mbetet trajtimi i rasteve humanitare me qëllim të ngritjes socio - ekonomike të bashkëkombësve në vendlindje.

Shoqata “ Kushaveci ” dhe anëtarët e saj ia bënë barrë vetes të ruajnë dhe vazhdojnë kulturën e familjarëve të tyre të po të njëjtit fshat Kushavec të Komunës së Gjakovës me emër të njëjtë siç është emërtuar edhe shoqata. Solidariteti me të sfiduarit gjithë herë është i pranishëm në shoqatën Kushaveci. Prindërit tonë e kishin mbëltua te pasardhësit traditën kulturore e humane që të janë të bashkuar edhe pa dallim ku jetojnë në fshat apo mërgim dhe të janë të bashkuar dhe solidar me nevojtarët.

Vetë fakti i të jetuarit larg vendlindjes shton edhe mallin për vendlindje atëherë edhe atdhedashuria është më e madhe te mërgata e cila as njëherë nuk e shkëputi lidhjen me familjen, dhe vendlindjen e tyre meqë aktiviteti human i bashkëkombësve të lindur në mërgim apo vendlindje në Kosovë, Gjakovë apo Kushavec nuk krijon ndasi në aktivitete humane.

Nuk kanë munguar kontributet si komunitet gjithnjë në të gjitha format e mundshme si të organizuara apo edhe individuale, por në Shtator të vitit 2016 u nxor vendimi unanim që të organizohet shoqata për arsy se edhe mundësit e kontaktit në shtetin nikoqir (Zvicra) janë më te mira dhe u fillua me 10 anëtar, kurse tash janë mbi 60 anëtar në Shoqatën e Kushavecit në mërgim.¹⁸⁹

Familjet në përgjithësi i gëzojnë përkrahjet, kurse anëtarësia jonë janë shumë sepse secili nga ne kemi familjar në Kosovë dhe duke qenë anëtarë në shoqatën “ Kushaveci ” trajtojmë dhe ruajmë freskinë e atdhedashurisë. Një i ri apo e re që rritet në Evropë nganjëherë i mungon apo humb për një çast orientimin dhe kështu që nga ne anëtarët e shoqatës “ Kushaveci ” marrin këshilla që të rikthejnë vëmendjen dhe shtohet përkrahja familjare në Kosovë nga secili prej nesh.

2

¹⁸⁹https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F35546712%2FNdikimi_i_grupeve_t%25C3%25AB_interesit_n%25C3%25AB_Britanin%n(qasur më 22.05.2021)

Por në mënyrë të organizuar janë disa familje dhe projekti ma i madhi deri tash ishte ndërtimi i një shtëpie në nevojë ekstreme në Kushavec (ku edhe mediumi publik RTK në edicionin informativ dhe një emision ia kushtoi kontributit të mërgatës së Kushavecit për Kushavecin). Për arritjen e qëllimeve të përbashkëta nuk mungon edhe bashkëpunimi me shoqata. Nënvizojmë ndërtimi i objektit të morgut të fshatit i cili është konsideruar si i domosdoshëm për tu ngritur enkas për shkak që Kushavecasit janë të emigruara dhe duhet përmbrush edhe kjo nevojë. Megjithatë asnjëherë nuk janë harruar sfidat dhe kontribuuesit e lirisë.

Përkrahje nga institucionet e shtetit ku jetojnë shqiptarët e Kosovës (Zvicra) nuk kemi pasur. Megjithatë krahas aktiviteteve humanitare nuk mungojnë edhe aktivitete kulturore dhe politike të vendin nikoqir në Zvicër e cila konsiderohet prej vendeve mike të Kosovës. Anëtar të shoqatës së Kushavecit thonë se janë të kënaqur për këto vite të aktivitetit humane - kulturor, por në kohë pandemie munguan takimet dhe aktivitetet, ndonëse u mbajt vazhdimësia e veprimeve të shoqatës e cila në gjirin e saj përveç aktivistëve të Kushavecit ka edhe bashkëkombës nga vende të ndryshme të trojeve etnike e që janë me punë në Zvicër e që i bashkëngjiten aktiviteteve të bashkëkombësve nga Kushaveci ndoshta pa e ditur në aspektin gjeografik se edhe ku gjendet Kushaveci,¹⁹⁰ vetëm për të qenë pjesëmarrës në ndihmën konkrete të synuar nga kryesia e shoqatës së Kushavecit.

Optimizmi dhe atdhe dashuria është burim ekzistencial dhe shpresë se sfida e pandemisë do të kalon, do të stabilizohet situata shëndetësore dhe në të ardhmen e afërt të ri vazhdojmë fuqishëm me aktivitet humanitare për çka nuk janë duke munguar planifikimet strategjike dhe identifikimi i veprimeve të cilat do ti marrim.

Për veprimet e realizuara më herët dhe planifikimet për veprimet e radhës në raste të ndryshme rol të rëndësishëm kanë mediat meqë ato janë katalizator i ndryshimit pozitiv përfaktin që me rastin e pasqyrimit të veprimeve konkrete ato i shërbijnë situatës sikur një auditor i veçantë që i kontribuon raportimit se si ka rrjedh procesi i planifikuar dhe sa është arrite qëllimi gjë që bën që inkurajon anëtar të shoqatës “ Kushaveci ” mos të hezitojnë të kontribuojnë kur bëhet publike puna e realizuar falë mundit dhe djersës së tyre. Media ka rol te veçantë në pasqyrimin e nevojave socio-ekonomike kudo qofshin po ashtu edhe në vendin tonë, ndërsa për korrekëtsi duhet thënë që in putet informative për anëtar të shoqatës “ Kushaveci ” janë edhe mediat krahas informacioneve

¹⁹⁰:intervistë ekskluzive me zyrtarë të shoqatës Kushaveci, mars,2021.

nga bashkëkombësit dhe vetë anëtarët të cilët janë në familje dhe fshat gjatë periudhës kohore sa janë në vendlindje sikurse edhe komunikimeve thuaja shumë të shpeshta me banorët rezident në Kushavec të Gjakovës. Nga këndi ekonomike, shoqata ka përkrah edhe nxënës dhe student të Kushavecit me bursa duke organizuar edhe aktivitete kulturore për çdo vjet për pavarësinë e Kosovës dhe ditën e Flamurit aktivitete të cilat ndikojnë në aspektin social, kurse të hyrat e realizuara i dedikojmë për nxënësit dhe studentët e fshatit Kushavec të Komunës së Gjakovës.¹⁹¹

Rekapitullim

Shpresojmë se tradita do të vazhdojë ashtu siç vepruan dje prindërit tonë (gjenerata e parë në Zvicër), sot po veprojmë ne edhe si anëtar të kryesisë së shoqatës dhe anëtar tjerë. Shpresoj se kështu vjen në shprehje thënia “ Rrushi piqet duke e pa tjetrin “ gjeneratat e reja janë e nesërmja e qëndrueshme edhe pse të lindur në Zvicër dhe gjetiu “ nuk do të ndalen së vepruari sikurse paraardhësit e tyre për të mirën e atdheut.

5.1.1.7. Rasti studimor 7

OJQ “ Miqësia Franko-Shqiptare ”, Francë.

Roli i Shoqatës “ Miqësisë Franko - Shqiptare ” në Bashkimin Evropian e themeluar më 21 shkurt 1994, botuar në gazetën zyrtare nga administrata e N/ prefekturës në Saint Julien en Genevois në Francë. Amitie Franco Albanaise (Shoqata e Miqësisë Franko-Shqiptare) është asociacion joqeveritar i mbrojtur sipas ligjit, me seli në Annemasse të Francës, e udhëhequr nga presidenti i saj z. Tahir Shabani, Ambasador për Paqen Botërore, kontribuues i çështjeve organizative

¹⁹¹ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Berhand Topalli.

koordinuese, drejtuese dhe protokollare në konferanca dhe seminare, nga Komisioni Evropian për organizimin e promovimeve kulturore dhe ekonomike me organizatat ndërkombëtare me seli në Gjenevë. Me shkëmbimin shumë kulturor, avancohet në një aleat të vyeshëm të diplomacisë shqiptare, duke lobuar në vazhdimësi për Kosovën, me përkrahjen e klubit diplomatik në Gjenevë dhe Francë, si një partner serioz i institucioneve të Republikës së Kosovës.¹⁹²

Gjatë viteve kontributi i shoqatës “ Miqësia Franko - Shqiptare ” që nga vitet e ndryshmeve të mëdha 1991-1992 me përkushtim në aktivitetet humanitare e atashuar pranë Organizatës „ Farmacistët pa kufij “, ka kontribuar në Shqipëri me medikamente të rëndësisë së parë. Qëllimet dhe aktivitetet e shoqatës kishin të bënин me promovimin e miqësisë mes popullit francezë dhe shqiptarë në të gjitha fushat e bashkëpunimit me shoqatat e miqësisë Franko - Shqiptare të krijuara në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe vende Evropiane. Bashkëpunimi me vëzhgues ndërkombëtar për zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe vende të tjera. Ndihma emergjente për viktimat e katastrofave natyrore, sigurimi ndihma humanitare në formën e donacioneve, pajisjeve mjekësore, optike, administrative. Organizimin e trajnime për mjekë përmes praktikave në Francë. Vendosja e lidhjeve midis institucioneve kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare për binjakëzimet në fusha konkrete.

Shoqata synon të kontribuojë në shkëmbime konstruktive, dhe nxitje të partneritetit ekonomik dhe kulturore midis Francës dhe Bashkimit Evropian nga njëra anë ⁴⁷ dhe vendeve në zhvillim nga ana tjetër me prioritet Republika e Kosovës. Vitet e sfidave të luftës së fundit 1998-1999 pati aktivitet humanitar dhe diplomatik, i cili konsiston në gjetjen e ndihmave, dhe organizimin e dërgesave humanitare në mbështetje të popullsisë së zhvendosur me ndihmën e Francës dhe të kryqit kuq ndërkombëtare, Organizatës ndërkombëtare të Imigracionit për ç ‘gjë kishte mobilizim edhe të medias si: Radio Televizionet, gazeta të përditshme, dhe të diplomatëve në mbështetje të çështjes shqiptare,¹⁹³ të cilët ishin detyruar ta mbronin jetën dhe vendin e tyre Kosovën.

Lobimi për Këshillin e Drejtave të Njeriut, Federatën e Helsinkit dhe organizatave jo-qeveritare për të ndihmuar me grupet e ekspertëve dhe diplomatëve pranë OKB-së për aprovimin

2

¹⁹² [https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fballkani.info%2Ftahir-shabani-kosovari-qe-po-nderton-ura-miqesie-\(qasur më 23.09.2021\).](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fballkani.info%2Ftahir-shabani-kosovari-qe-po-nderton-ura-miqesie-(qasur më 23.09.2021).)

¹⁹³ Intervistë ekskluzive enkas me ambasadorin e pages botërore Tahir Shabani, 2021.

e rezolutave në favor të Kosovës. Në aspektin socio – ekonomike, shoqata gjithnjë është përkushtuar falë mbështetjes së miqve për ndryshim pozitiv kurse duhet evidentuar:

Në janar 2000, anëtar aktiv i klubit diplomatik të Gjenevës, me angazhim arritën të aktivizohen dhe anëtarësohet konsullata e Republikës së Kosovës në Gjenevë në Klubin diplomatik pran OKB-së. Më 6/11/2007 Diplomacia Ekonomike në OBT, me angazhimet e shoqatës “Franko – Shqiptare” arritën për herë të parë pjesëmarrje të delegacionet nga Kosova me z. Bujar Dugolli Ministri i Tregtisë dhe Industrisë të marrin pjesë në Forumin Publik të Organizuar nga Organizatës Botërore të Tregtisë me seli në Gjenevë.

Në Qershor 2008 arrihet marrëveshje ndërmjet Francës dhe Kosovës në lëmin e punës dhe mirëqenies sociale e firmosur nga ministria e punës dhe Ambasada Francës ne Prishtinë. Marrëveshja konsiston për thellimin e shkëmbimeve në fushën e punës dhe të mbrojtjes sociale me qëllim të përgatitjes së projekteve të kooperimit bilateral dhe multilaterale. Përkrahje arkivit të Kosovës për mundësi të bashkëpunimit me arkivat në Francë, Zvicër, Evropë dhe pran OKB-ë dhe organizatave ndërkombëtarë për vizita studimore.

Nga 2015-2018 Organizmin e agjendave protokollare për komunat nga Kosova në kuadër të bashkëpunimit kulturore dhe ekonomik me komunat e Francës dhe Gjenevës. Bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Kosovës, për avancimin dhe ngritjen e standardeve të Federatave sportive të Kosovës dhe integrimin e tyre në Institucionet dhe organizata ndërkombëtare, në bazë të standardëve të Federatave sportive Evropiane dhe Botërore me qendër në Lausanne të Zvicrës.

Të arriturat janë të faktuara, ndërsa në këtë vlen sintagma “Asnjëherë mos pyet çka bëri shteti për mua por çka bëra unë për shtetin”. Bashkëpunimi me institucionet lokale dhe qendrore në vend argumentojnë se sa ishte dhe mbete primare lidhshmëria e shoqatës me vendin. Për arritje të qëllimit kontribut të rëndësishëm kanë dhënë mediat të cilat me punën profesionale e kanë zbardh dhe nxitur kontributin si të shoqatës “Miqësia Franko – Shqiptare ” po ashtu të secilit subjekt kontribuuves. Vlerësohet puna e palodhshme e medias shqiptare dhe asaj Kosovare pa mos i anashkaluar mediat e shteteve nikoqire si në Francë e Zvicër e gjetiu dhe gjithandje kudo që ka kontribuar shoqata “Franko – Shqiptare ”. Ndërsa duhet të potencohet se aktivitetet e përbashkëta

me miqtë ndërkombe të cilët kishin ardhur në Kosovë apo Shqipëri të gjitha janë shënuar nga përfaqësues të mediave.¹⁹⁴

Rekapitullim

Shoqata “ Miqësia Franko-Shqiptare “ veprimtarinë e sajë që nga themelimi e deri tani e ka të bazuar në lobim dhe krijim të urave ndërmjet institucioneve në troje etnike si në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Luginë të Preshevës si në rrafshin social po ashtu edhe në atë ekonomik d.m.th varësisht nevojave të qytetarëve ka shtrirë aktivitetin për integrim dhe krijim të kushteve sa më të mira ekonomike në troje etnike me qëllim që ndikimi mos të jetë te përfaqësues të institucioneve, personalitetet dhe familje në bazë të gjendjes ekonomike. Kurse në aspektin social kjo shoqatë ka lobuar që qytetar shqiptar kudo jetojnë, të jetojnë me dinjitet dhe të integruar në shtetet nikoqire, mike të Kosovës të cilat e dëshmuant miqësinë në të gjitha kohët si në paraluftë, luftë dhe paqe për ngritje socio - ekonomike dhe përgatitur sa më parë duke i plotësuar kriteret për anëtarësim në familjen e madhe Evropiane.¹⁹⁵

¹⁹⁴ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Tahir Shabani.

¹⁹⁵ Qëndrim i Kryetarit të shoqatës “ Miqësia Franko – Shqiptare “ z. Tahir Shabani dhënë RTK-ë për emisionin Refleksion, Prishtinë 2021.

5.1.1.8. Rasti studimor 8

OJQ “ Qatar Charity ”, Qatar

Organizata “ Qatar Charity ” është regjistruar në Kosovë në vitin 2000. Ishte kjo një domosdoshmëri e kohës duke pasur para sylhet që populli mik i Kosovës kishte dalë nga lufta, ndërsa gjithçka ishte e dëmtuar si nga humbja e jetëve të qytetarëve deri tek dëmtimi dhe shkatërrimi i pasurive të tyre të luajtshme dhe të pa luajtshme. Natyrisht që misioni i organizatës ishte për të mbështetur njerëzit në nevojë, ndërsa të tilla familje kishte mjaft në Kosovë dhe për këtë ekskluzivisht synimi i organizatës “ Qatar Charity ” ishte zbutja e situatës socio - ekonomike për familjet në gjithë vendin, me theks për familjet e zonave të luftës dhe rasteve më të rënda sociale.

Angazhimi i “ Qatar Charity ” ka filluar me përkrahjen e fëmijëve bonjak. Në radhë të parë synimi ishte përkrahja e shtresave me të prekura nga pas lufta meqë ata ishin kategoria më e rrezikuar. Por jo vetëm këta janë mbështet. Pavarësisht situatave të familjeve dhe gjendjes së tyre socio - ekonomike është aplikuar profesionalizmi i të zënëve me punë në organizatën humanitare “ Qatar Charity ” në mënyrë që trajtimi të jetë adekuat për secilin rast ndërsa për këtë fillimi i punës profesionale nis me 10 punëtor për të cilët ishte menduar se do të jenë të mjaftueshëm për të përbush misionin humanitar në Kosovën e pasluftës për të cilin angazhim thënë sinqerisht është shpresuar se gradualisht do të zvogëlohet numri i punëtorëve e jo të rritet që do të thotë se aktualisht janë 20 të punësuar,¹⁹⁶ ndërsa kjo është simptomatike që ende populli i Kosovës ka nevojë për mbështetje për kategori të ndryshme të komunitetit e posaçërisht për familjet me gjendje të rëndë socio - ekonomike dhe familje të cilat në mesin e tyre kanë fëmijë bonjak të cilët kanë mbështetje të vazhdueshme.

Mbështetja e fëmijëve bonjak mbetet krenaria e shoqatës, ndërsa njëherësh është edhe rehatia që një bonjak më shumë përfshihet në këto skema dhuratash të cilat janë të formave të ndryshme përmes aktiviteteve financiare, mbështetja me grante, ndërtim të shtëpive dhe shumë aktivitete të ndryshme humanitare etj. Megjithatë kënaqësia është e madhe meqë për arritjen e objektivave nuk

¹⁹⁶ Mahmoud Shaker ” Familjet Kosovare të dala nga lufta do të mbështeten me të mira materiale “ RTK -ë, lajme 19.30, 2020.

ka munguar bashkëpunimi me institucionet në vend si ato të nivelit lokal gjithashtu edhe atyre qendrore sikurse ministritë e linjave të cilat janë të lidhura drejtësore me brengat e qytetarëve si ministria e Shëndetësisë, e Financave, e Punës dhe Mirëqenies, asaj të Zhvillimit Ekonomik etj. thonë në organizatën “ Qatar Charity ”. Në këtë vazhdë edhe drejtori komunale nëpër komuna përkatëse në Kosovë kanë ofruar bashkëpunim dhe për këtë realizimi ka qenë më i lehtë. Këto dhe shumë aktivitet tjetra të ndryshme të realizuara janë mbështetur edhe me pranin e ambasadorit të Qatarit në Tiranë përfaqësues për Shqipëri dhe Kosovë.

Gjitha këto aktivitete janë përcjell nga video produksioni i organizatës në mënyrë që transparencia të jetë çelës i suksesit të organizatës e cila ka reputacion tek qytetarët kosovar të cilët janë falënderues gjithandje kudo zyrtarë të organizatës por edhe përfaqësues të jetës politike nga të gjitha instancat e kanë të njojur aktivitetin humanitar të organizatës “ Qatar Charity ”. Të arriturat e deritashme janë inkurajuese derisa besimi është sforcuar tek takspaguesit e shtetit të Qatarit të cilët e kanë të njojur aktivitetin e organizatës se ku i destinojnë të hyrat dhe se sa është arri përmes mbështetjes, zbutja e situatës socio - ekonomike të familjeve në nevojë.

I gjithë aktiviteti humanitar i organizatës “ Qatar Charity ” është publik fillimisht nga aktivitet e mediave elektronike televizive për tu vazduar edhe në rrjete sociale të cilat thuaja nuk kanë lënë aktivitet pa regjistruar si zyrtarë të organizatës po ashtu edhe miq të sajë.

Organizata “ Qatar Charity ” përkushtimin e përqendroi si në planin ekonomik po ashtu edhe në planin social të rasteve në nevojë, fillimisht duke synuar që gradualisht tu jep mundësinë për tu rimëkëmb së paku përkohësisht në aspektin ekonomik dhe gradualisht edhe përgatit mundësinë që të ri ngritën vetë anëtarët të familjeve në nevojë me punën e tyre e cila do tua shtonte dinjitetin e që ndërlidhet edhe me aspektin social.¹⁹⁷ Për këtë edhe shifrat mbështetëse përfëmijët bonjak janë milionëshe.

Kontributet janë të shumta dhe të ndryshme ndërsa i gjithë aktiviteti kishte dhe ka synim ngritjen socio - ekonomike për kategori të ndryshme të familjeve në nevojë por njëherësh edhe për mbështetje institucionale sikurse tek mbështetja në fushën e shëndetësisë, bujqësisë dhe ndërtimtarisë ku përmes institucioneve të cilat janë në shërbim të qytetarëve është tentuar të zbutet

2

¹⁹⁷[https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F29222715%2FThe_role_of_media_in_intercultural_\(qasur_më_23.02.2021\)](https://google.com/url?sa=D&q=https%3A%2F%2Fwww.academia.edu%2F29222715%2FThe_role_of_media_in_intercultural_(qasur_më_23.02.2021))

situata socio - ekonomike ndërsa duhet nënvizuar që marrëveshjet për ndërtim të objekteve shëndetësore, shtëpi banimi, hapja e puseve për ujë të pijes, ndërtimi i lagjeve të banimit, dhurimi i banesave së bashku me kontroll shëndetësor dhe sigurimi i donacionit për ministrinë e shëndetësisë me teste dhe aparatura për trajtim të Covid-19 janë vetëm disa nga aktivitet mbështetëse të cilat e formulojnë mozaikun humanitar në Kosovë nga organizata “Qatar Charity”¹⁹⁸ duke mos lënë pas dore edhe aktivitet të ndryshme edukativ - arsimore siç ishte rasti i dhurimit të kompjuterëve përfshirë fëmijët bonjak pa mos u ndaluar edhe te materiali shkollor dhe veshmbathja e fëmijëve.

Me qëllim të prezantimit të aktiviteve humane dhe mbështetje të qytetarëve rezident në Kosovë organizata “Qatar Charity” ka gjithë përfshirje në gjithë vendin aty ku kanë nevojë familje me situatë më të rënduar socio - ekonomike, kurse organizata me aktivitetet e sajë socio - ekonomike mbulon komunitet pa dallim.¹⁹⁹

Rekapitullim

Kontributi i filluar nga paslufta në Kosovë i Organizatës “Qatar Charity” në vete përmban një aktivitet të vazhdueshëm humanitar por edhe edukativ në mbështetje të familjeve me gjendje të rëndë socio-ekonomike, mbështetje të fëmijëve bonjak sikurse edhe krijimin e mundësive përvillim të mikroekonomisë përfshirë krijuar vetëpunësim persona të interesuar përfshirë gjenerim të hyrave nga vetëpunësimi.

Familjet me bonjak janë caku i kontributit të organizatës “Qatar Charity” ndërsa përfshirë këto familje nuk ka çka nuk mbështeten këto familje. Ndërtimi i shtëpisë të banimit me bashkëveprim institucional komunal dhe të nivelit qendror bën që kjo organizatë të përfshirë serioze dhe e përkushtuar përfshirë kudo që ka nevojë dhe referencë e mbështetjes të rasteve sociale janë zyrat e përfaqësuesve të nivelit lokal dhe qendror. Përveç aspektit socio-ekonomik angazhimi i tij rrinje

¹⁹⁸ Fahredin Hashani. Intervistë ekskluzive “donacionet e shoqatave humanitare nga lindja ndihmojnë rastet sociale dhe bonjakët Rtk-ë, Refleksion. 2020.

¹⁹⁹ Intervistë e realizuar përfshirë hulumtim empirik të rastit studimor me z. Mahmoud Shaker, 2021.

në kurse të ndryshme në organizim të “ Qatar Charity “ bën që këta të rijnë të avancohen në fusha të trajtimit si në kompjuterik gjithashtu edhe në gjuhë të huaja.

5.1.1.9. Rasti studimor 9

OJQ “ Lidhja e Invalidëve, Viktimave Civile dhe të Zhdukur në Kosovë ”, Drenas

Lidhja e invalidëve, Viktimave Civile dhe të Zhdukur në Kosovë (LIVCZHK) si organizatë joqeveritare e cila është themeluar në vitin 2000, pranë Ministrisë Administratës Publike. Ndërsa organizata fillimi është menduar të krijohet me qëllim të mbështetjes dhe ndihmave të mundshme për qytetar të sfiduar nga lufta e fundit nga forma të ndryshmet si: Invalid të luftës, viktimate civile, familjarëve të zhdukurve, viktimate të dhunës seksuale të luftës në Kosovë etj.(Prengu,2022).

Menjëherë që nga pasluftha kjo organizatë ka zhvilluar aktivitete të shumta me qëllim të shpërqendrimit dhe shtimin e aktiviteteve të personave anëtar të kësaj shoqate përmes zyrave të saj si në Prishtinë, Drenas dhe Fushë Kosovë ndërsa kemi të evidentuar janë mbi 500 raste të dhunës seksuale. Nga ky numër prej tyre 30 janë të punësuar në qendrën e (LIVCZHK) në Fushe Kosove ku zhvillojnë aktivitet artizanal.

Numri i anëtarëve të shoqatës asnjëherë nuk ka qenë statik ai ka evoluuar dhe është shtuar gradualisht duke u rritur vetëdijen e qytetarëve. Përveç aktiviteteve risocializuese në (LVCZHK) aktivitetet nuk kufizohen vetëm në ofrim të ndihmave periodike apo edhe të rregullta të anëtarëve të kësaj shoqate me organizata vendore dhe ndërkombëtare dhe humanistëve vendor, ndërkombëtar dhe bashkëkombësve nga mërgata që dëshmon se bashkëpunimi i LIVCZHK është në shumë dimensione.

Megjithatë trajnimet dhe risocializimet përmes bashkëpunimit me profesionist të institucioneve për trajtimin sidomos të mbijetuarve të dhunës seksuale i kontribuon qëllimit dhe synimit të kërkuar për rehabilitimin dhe risocializimin e personave të cilët janë viktima të luftës në Kosovë.

Ndryshimi i kërkuar duke eliminuar stigmatizimin përmes angazhimit të përgjithshëm të institucioneve të vendit me theks të medias bën që mund të konsiderojmë se aktivitet e deritanishme janë përcjell dhe sensibilizuar nga mediat në vend të cilat iu kanë përgjigj kërkesave kur interes i ka qenë të jenë të prezantuara si ngjarje deri në masën e duhur për plasim të informacioneve në opinion.²⁰⁰

Si shoqatë synojnë është që gjithë anëtarët, posaçërisht femrat të cilat kanë nevojë për mbështetje profesionale për zhvillim dhe avancim si dhe informim për të drejtat e tyre, mënyrën institucionale të reagimit kundër diskriminimit dhe ri-viktimizimit si dhe rehabilitimi i tyre përmes aktiviteteve të lira në punëtoritë brenda hapësirave të shoqatës së (LIVCZHK).²⁰¹

Rekapitullim

Në aktivitet të cilat e bëjnë të njohur në opinion përmes mbështetjes së mediave Lidhjen e Viktimave Civile dhe të Zhdukurve të Kosovës (LIVCZHK) janë këto:

Organizimi i tryezave në lidhje me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të grave,

Organizimi i tryezave grupore në lidhje me informimin për mbrojtjen nga dhuna në familje,

Rehabilitimi dhe risocializimi i këtyre grave përmes aktiviteteve të lira në punët artizanale dhe përgatitjen e ushqimeve tradicionale dhe

Organizimi i ankandeve për shitjen e punimeve tradicionale të punuara nga gratë anëtare të shoqatës.

²⁰⁰po aty.

²⁰¹ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Mustafë Prengu.

5.1.1.10. Rasti studimor 10

Shoqata Kulturor-Sportive “ 17 Shkurti “ Baden, Austri

Shoqata 17 shkurti është themeluar më 31 mars 2007. Ndërsa këshilli iniciator vendosi që shoqëria të nis punën si shoqëri amatore dhe të përgatitet me kohë që edhe emrin ta përzgjedh dhe të jetë shoqatë me dinjitet, e nderuar nga opinioni për emrin e synuar ” 17 Shkurti ”. Ndërsa në prag të 17 Shkurtit kur edhe shpallet Pavarësia e Kosovës, në mbrëmjen e 16 Shkurtit kryesia e shoqatës e bëri publik emrin e shoqatës.

Juridikisht kemi synuar të jemi në rregull, kjo është realizuar me regjistrimin pranë organeve zyrtare në qytetin Baden të Austrisë ndërsa datë zyrtare e regjistrimit konsiderohet data 15 Prill të vitit 2008 dhe për këtë nuk munguan dokumentet e nevojshme zyrtare që shoqata të jetë edhe zyrtarisht duke funksionuar. Kjo dëshmohet përmes certifikatës së regjistrimit.

Kurse për kontributin e sajë jo vetëm për komunitetin tonë qe e kishim synim ta kemi sa me afër bashkëveprimit dhe integrimit duke mos e harruar asnjëherë vendlindjen por edhe forcuar pozitën në shtetin mik Austriak gjë që gjatë viteve kjo ide është fuqizuar thuaja pa u vërejtur dhe kështu kemi arritur të jemi të respektuar për punën me duar të pastra dhe transparencë të plotë.²⁰²

Me kohën situata evoluoi dhe si shoqatë kishim përfitime të synuara dhe planifikuara duke u bashkuar me njeri tjetrin si bashkëkombës nga të gjitha trojet etnike dhe si të tillë sukseset ishin të pranishme. Aktivitetet e komunitetit shqiptar në Baden të Austrisë dhe aktiviteti kulturor i palodhshëm na bëri të barabartë me të gjitha nacionalitetet të cilat jetojnë në Baden dhe më gjërë në tërë Austrinë.

Shoqëria shqiptare e organizuar rreth shoqatës ” 17 Shkurti ” për as një rast e çast nuk ishte e ndarë dhe e diskriminuar nga vendorët apo përfaqësues të nacionaliteteve tjera. Këtu shqiptarët jetojmë dhe punojnë dhe trajtohen shoqëri dobiprurëse për shtetin Austriak por edhe për familjet tona dhe familjarët në vendlindje nga e kemi prej ardhjen. Përveç punës dhe angazhimit të përditshëm, lindi nevoja mes komunitetit tonë që të përqendrohem i në angazhimin e fëmijëve në shkollën shqipe dhe edukimin e tyre në si dhe shtimit të kujdesit nga dukurit negative shoqërore.

²⁰² Tahir Turkaj: Intervistë speciale, “ Roli i Medias në ndryshimin socio-ekonomik në Kosovë”2021.

Jemi aktiv me aktivitetet shumë kulturore, ndërsa qëllim permanent ishte dhe mbetet që përmes takimeve të ruajmë mallin e pashuar për atdheun. Krahas punës kontributi i bashkëkombësve është edhe në jetën sportive nëpër turne të ndryshme.

Numri i anëtarëve nuk është statik, ai lëviz ndërsa kemi anëtar të jashtëm të cilët kontribuojnë në fondin e shoqatës së bashku me donatorët të cilët janë krahu i djathtë i shoqatës. Qëllimi është të afrohemë dhe njihemë në shoqërinë e "17 Shkurtit" ndërsa mbi 30 anëtarë është grupi kontribuues në jetën kulturore. Realisht në Austri nuk kemi nevoje të ndihmojmë thuaja askënd (nuk ka raste sociale te komuniteti ynë shqiptar) përveç në raste të jashtëzakonshme për riatdhesim në rast vdekje etj...

Ndërsa ndihmat janë përqendruar në vende të ndryshe në troje tona. Kemi ndihmuar shkollën në Kosove ku ka pasur nevojë, sikurse edhe familjet me gjendje të vështira ekonomike sidomos nga Mitrovica, qyteti i Minatorëve. Mjete materiale janë dërguar dhe kohë pas kohe po dërgohen e dhe tani tek familjet me gjendje më të rëndë socio-ekonomike gjithandje vendit. Për shoqatën "17 Shkurti" nuk ka lokalizëm, shqiptarët pa dallim nga trojet etnike në Baden janë të orientuar që ta ruajnë kulturën dhe traditën kombëtare dhe njëherësh edhe ndihmuar rastet e ndryshme me gjendje të vështirë ekonomike në vendlindje dhe kjo na bën te lumtur që nuk kemi shkëputje me vendlindjen.

Deri tani me atë se çka kemi tentuar te arrijmë mund të themi se kemi arritur objektivat fale angazhimit të secilit bashkëkombës, pjesë e shoqërisë së "17 Shkurtit", ndërsa na gjëzon fakti që thuaja për asnjë rast social nuk është dashur të kërkojmë, vetëm të informojmë dhe vëllezërit tanë mërgimtar e kanë dëshmuar dhe po e dëshmojnë veten dhe kjo na bën të ndjehemi krenarë. Ndërsa me këto veprime humane po krijohen ura bashkëpunimi edhe me institucion lokale në Kosovë p.sh ku na presin me zemërgjerësi për aktivitet tona të cilat janë të vazhdueshme. Pra me një fjalë vetëm informata e saktë ndërsa puna ecën vete për shkak te atdhe dashurisë dhe dëshirës që qytetari shqiptar të jetoj me dinjitet dhe mos të ketë festë kombëtare apo ndërkomëtare e tryesa e familjes së caktuar të jetë e zbrazur.

Rastet shëndetësore janë mbështet duke iu dërguar mjete po ashtu edhe në Austri duke u bashkuar në aksione për të mbështet trajtimet shëndetësore jashtë vendit të cilat vinin për trajtim në Austri së bashku me shoqata të ndryshme të shqiptarëve edhe nga qytete tjera të Austrisë d.m.th kur e do nevoja jemi një. Ndryshimi social duhet të kërkohet pa asnjë hezitim, ndërsa mediat kanë

kontribuar për sensibilizim. Gjithashtu kohëve të fundit rrjetet sociale janë më të shpejta, më të qasshme dhe po e bëjnë publike kërkesën, nevojën dhe informatën se çfarë me të vërtetë e kemi situatën në momente të caktuar si komunitet lokal në Baden, në trojet tona etnike, në Austri dhe gjetiu në shtete tjera ku kemi lidhje shoqërore dhe familjare por nuk duhet harruara që vendlindja e jonë gjithnjë është në fokusin e secilit mërgimtar.

Mediat nga të cilat informohemi na bëjnë që mos të ndjehemi të larguar, me një fjalë bota është bërë e vogël, ndërsa informacionet e shpejta sikurse kjo bisede e drejtpërdrejt me formë elektronike po na lehtëson komunikimin me bashkëqytetarë dhe bashkëkombësit tonë. Emisionet kushtuar mërgatës i kanë kontribuar ofrimit me atdheun. Shqiptarët në Baden e kanë adresën e tyre, ajo është shoqata “ 17 Shkurti “ për të gjitha nevojat e tyre, ndërsa integrimi i shqiptarëve në Austri ka peshë.

Në një takim mes zyrtarëve të Kosovës dhe Austrisë u ngrit hipoteza të kujt janë më shumë qytetarët shqiptar që jetojnë e punojnë në Austri ? Megjithatë Bashkëkombësit tonë në Austri janë të lidhur me vendlindjen ndërsa përveç synimit që të përkujdesen për familjarët e tyre ata janë duke ndihmuar rastet e ndryshme socio-ekonomike në Kosovë.²⁰³

Rekapitullim

Në aspektin ekonomik veprimet e shoqatës janë fokusuar në vendlindje aty ku ka nevojë duke u bazuar në argumente dhe mbështete të punës së përbashkët edhe përfaqësues të kompanive private të cilët janë donatorë për mbajtjen e aktiviteteve në organizime shoqërore dhe pjesëmarrje në aktivitete përmes mbështetje humane si në mërgim ashtu edhe në troje etnike. Ndërsa kryesisht e gjithë puna e shoqatës realizohet me punë vullnetare të anëtarëve të shoqatës dhe familjarëve të tyre. Dimensioni social i shoqatës “ 17 Shkurti “ është që e mira e përbashkët është qetësi dhe rehabilitim i përgjithshëm shoqëror duke u përkushtuar që ndryshimi social të jetë i dukshëm duke

²⁰³ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Tahir Turkaj.

iu ofruar brenda mundësive secilit rast në mënyrë të kontribuoj pa menduar që duhet të punohet vetëm për një mjedis të caktuar lokal, por aty ky nevojat janë më të mëdha ndërsa fitimi më i madh konsiderohet kur ndahen mjete dhe një rast social më pak do të fuqizon shoqërinë dhe shtetin. Tek veprimi i kritereve shtesë veprimet e duhura në kohë të duhur duke identifikuar rastet për të vepruar konkretisht pa dallim rajoni por për të ndihmuar rastin e caktuar brenda fuqisë ekonomike ashtu edhe siç janë anëtar të shoqatës “ 17 Shkurti “ nga mjedise të ndryshme të trojeve etnike, po ashtu synim mbetet të identifikohen rastet të cilat kanë nevojë për mbështetje.

5.1.1.11. Rasti studimor 11

Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare, Prishtinë

Oda Ekonomike Gjermano - Kosovare e themeluar në Prill të vitit 2012 bazuar në nenin 3 të statutit të Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare, ndërsa qëllim ishte aktiviteti ekonomik përmes odës në promovimin e marrëdhënieve ekonomike midis Kosovës dhe Gjermanisë gjithnjë duke synuar përfaqësimin e interesave të anëtarëve të odës në aspektin e veprimtarisë së tyre ekonomike, në kuadër të marrëdhënieve ekonomike Kosovare - Gjermane, me ambicie afatgjatë për të mbështetur krijimin zyrtar të Odës së tregtisë së jashtme të Gjermanisë në Kosovë duke shkëmbyer informacione dhe eksperiencia mes afaristëve të dyja shteteve.
31

Para themelimit të Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare (OEGJK-ë) nuk kishte ndonjë odë apo shoqatë biznesi e cila do të përfaqësonte interesat e kompanive Gjermane në Kosovë dhe përkrahjen e kompanive Kosovare për të depërtuar në tregun Gjerman, andaj ishte nevojë imanente të themelohej një institucion për interesa afariste dhe në vitin 2012 me iniciativë të Ambasadës Gjermane dhe 39 kompanive themeluese si dhe një eksperti gjerman, Kahan Ertik, i cili në atë kohë ishte i angazhuar në Odën Ekonomike të Kosovës, u themelua Oda Ekonomike Gjerman - Kosovare (OEGJK-ë) ndërsa gradualisht me kohën shtohej edhe numri i personaliteteve të cilët anëtarësoheshin në OEGJK-ë.

Anëtarësimi në OEGJK-ë është vullnetar, ndërsa zgjedhja e anëtarëve të bordit si dhe e kryetarit realizohet në formë demokratike dhe me mandat të caktuar dy vjeçar nga anëtarët e bordit, kurse angazhimi në bord është vullnetar. Në bordin e drejtoreve janë shtate anëtarë që zgjidhen nga Kuvendi, ndërsa anëtarë i tetë është Ambasadori apo zëvendës ambasadori gjerman, kurse 3 nga shtatë anëtarë duhet të janë shtetas gjerman. Kontributi dhe roli i bordit është këshill dhënës ndërsa takimet e bordit janë të rregullta dhe të parapara 4 herë në vjet. OEGJK-ë e drejton drejtoresha ekzekutive dhe ekipi prej shtatë të punësuarve, të cilët merren me zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve që janë paraparë në planin vjetor të punës.

Në vitin 2017 OEGJK-ë, kishte 78 kompani anëtare ndërsa në Tetor të vitit 2021 janë 130 kompani, dhe janë mbi 10 tjera që presin mbledhjen e radhës të bordit për tu anëtarësuar në OEGJK-ë. Shprehur në përqindje mbi 40% e anëtarëve janë kompani me kapital gjerman, kurse pjesa tjeter janë kompani kosovare që eksportojnë mallra apo shërbime në shtetin mik Gjerman ose që importojnë dhe përfaqësojnë ndonjë markë gjermane në tregun e Kosovës.

Duhet theksuar se numri i anëtarëve në OEGJK-ë nuk është statik, rritja është e qëndrueshme, ashtu që mund të vetëfinancohet OEGJK-ë, përmes pagesave të anëtarësisë.

OEGJK-ë përmes këshillimit dhe trajnimit të kompanive anëtare ka arritur të përkrah kompanitë që të eksportojnë produktet e tyre në tregun gjerman, duke ju gjetur partnerë por edhe blerës. Janë përkrah kompani që të hapin degë në Gjermani. Mirëpo, gjithashtu janë asistuar kompani gjermane që të investojnë në Kosovë, dhe rrjedhimisht të krijojnë vende pune në Kosovë. Gjatë vitit 2020 eksporti nga Kosova në Gjermani ka arritur të ketë rritje prej mbi 45%, ndërsa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2021 eksporti është rritur deri 57%.

OEGJK-ë ka publikime dhe studime dhe sondazhe që i bën në baza të rregullta me anëtarët e saj. Përmes rekomandimeve të bazuara në hulumtime konkrete, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare jep input në projektligje të ndryshme, por edhe udhëzime për qeverinë se si ta përmirësojë klimën e të bërit biznes në Kosovë.

Puna deri tashmë jep komoditet për punën e arritur duke qenë se çdo vit janë tejkaluar targetet e odës dhe përmes aktiviteteve që ofron oda për anëtarët duken rezultate konkrete, që janë të orientuara kah biznesi. Përmes punës së anëtarëve të odës katër vitet e fundit, është arritur që

Kosovën ta bëjmë më të dukshme edhe te partnerët në Gjermani, por dhe krahas odave të jashtme Gjermane në rajon.

Objektivat e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare janë që të arrijmë të përkrahim rritjen e eksportit, por edhe të kemi më shumë investime gjermane në Kosovë. Kurse sa i përket kontributit të medias zyrtarë të OEGJK-ë e konsiderojnë që media i kontribuon të mirës së përgjithshme dhe sensibilizimit të ndryshimit duke prezantuar vlera dobipurëse duke plusuar dhe prezantuar rezultate të arritura të biznesit si shembuj të mirë për të pasur mostër dhe kampion për të shërbyer shembull për tregun. Herë pas herë mediat kanë bërë publike dhe shpërfaqë sukseset e OEGJK-ë. Mediat gjithnjë janë konsideruar krah i djathtë dhe kontributi i tyre për prezantim të vlerave shembull siç është angazhimi në planin ekonomik të subjekteve ekonomike jo vetëm për zhvillim por edhe eksport të produktive vendore përmes punësimit në kompanitë Kosovare të cilat mund të plasojnë mallra të produhuara në vend në tregun Evropian dhe atë gjerman njëherësh duke sjellë përvoja Gjermane dhe investitor Gjerman dhe të bashkëkombësve tonë në Gjermani, e gjithë kjo duke punuar dhe prezantuar cilësi Evropiane nga prodhuesit vendor Kosovar.²⁰⁴

Rekapitullim

Në aspektin ekonomik OEGJK-ë është duke sensibilizuar dhe kërkuar formulën e suksesit për zhvillim ekonomik duke gërshtuar përvojën dhe investimet e biznesit nga tregu i shtetit mik Gjerman përfshirë këtu edhe kontributin e bashkëkombësve për investime në vendlindje por me përvojë gjermane, ndërsa produktet e produhuara në tregun vendor të gjejnë hapësirë për eksport në vendet perëndimore e sidomos në tregun Gjerman. Shtimi i kompanive anëtarëve në OEGJK-ë faktorizon odën dhe fuqizon të bërit biznes në vendin tonë duke shtuar vende të punës dhe kështu rritë punësimin dhe ulë migrimin dhe përmes produktive vendore Kosovare të jemi në tregun Evropian. Roli lobues dhe këshillues i kontribuon të mirës së përgjithshme dhe kështu investitorët e jashtëm sidomos atyre të tregut Gjerman të jenë sa më të pranishme në vendin tonë, ndërsa roli i

²⁰⁴ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Besnik Beqiri, Kryetar i Odës ekonomike Gjermano – Kosovare , Prishtinë,2021.

medias sipas OEGJK-është domethënës për prezantim të vlerave të cilat i kontribuojnë të mirës së përgjithshme të vendit.

5.1.1.12. Rasti studimor 12

SHHB “Bereqeti”, Prishtinë

Dëmet nga lufta e fundit e përshkuar me të vrarë dhe shkatërrime të shumta bëri që domosdoshmërisht duhej të vazhdojë me aktivitet humanitar të SHHB “Bereqeti” e cila ishte themeluar për të mbështetur ekskluzivisht rastet në nevojë nga themeluesi Bashkësia Islame e Kosovës që nga vitet e 90-ta, por me emër tjetër ndërsa me krijimin e rrëthanave të reja regjistrohet më 2001 në institucionet e përkohshme të Kosovës.

Me krijimin e rrëthanave të reja në Kosovën e shkatëruar nevojat emergjente ishin edhe për nevojat elementare andaj për këtë qëllim në vitin 2001 Bashkësia Islame e Kosovës regjistroi Shoqatën Humanitare Bamirëse në institucionet e UNMIK-ut.

SHHB “Bereqeti” pas luftës ishte strehë e mbështetjes së rasteve sociale dhe kategorive të ndryshme meqë nga lufta dëmet ishin të mëdha dhe rreth 80% të qytetarëve përfshirë edhe ata që u riatdhesuan kishin nevojë për mbështetje në artikuj ushqimor, veshmbathje, higjenike e deri te krijimi i kulmeve të reja të cilat ishin të dëmtuara e rrënuara nga lufta e fundit e vitit 1998/99.

Domosdoshmëria për të qenë pranë familjeve të cilët kishin të vrarë e të humbur ishte dhe mbetet e pa diskutueshme dhe për këtë bashkëpunimi i SHHB ”Bereqeti” me shoqata ndërkombëtare dhe biznese vendore i kontribuuan dhe po i kontribuojnë krijimit të urave të bashkëpunimit për të ndihmuar familjet në nevojë. Duhet nën vizuar që qytetar të vendit individualisht nëpër Këshilla të Bashkësive Islame ndanë të mira materiale të cilat sot e asaj dite i realizojnë përmes Shoqatës Humanitare Bamirëse “Bereqeti”.

Në SHHB “Bereqeti” organizimi horizontal shtrihet edhe në degë të shoqatës në shtatë regjionet e vendit, ndërsa angazhimi ishte i bazuar në parimin vullnetar përkundër mos pasjes së personave profesionist për punë socio - ekonomike.

Megjithatë sikur më mirë ecnin punët përfaktin që përveç aktivitetit shoqëror ai emocional dhe teologjik forcon bindjen përfashimën mes anëtarëve të degëve dhe anëtarësise së saj të cilët ishin pjesë e komunitetit Islam në Kosovë i cili në asnjë çast nuk e dalloj dhe diskriminoi qytetarët në nevojë në kohë të vështira.

Sa i përket anëtarëve të shoqatës ai është fleksibil, përfaktin që secili qytetar i cili ka qenë apo edhe është i regjistruar në qendrat përfashimë sociale (QPS-ë) është konsideruar edhe rast i cili duhet ndihmuar nga SHHB “Bereqeti”. Numri i rasteve ka pasur ngritje rënie varësisht nga situata e krijuara socio - ekonomike në vend.

Paslufta solli sfida të cilat gradualisht edhe e shtuan numrin e madh të familjeve nevojtare përfshirë vazhduar edhe gjatë vitit 2001 në luftën në Maqedoni dhe Luginë e Preshevës. Pastaj kriza e vitit 2008 (kriza ekonomike botërore) deri te pandemia sfidë në vete e cila kërkoi dhe kërkon gjetje të modaliteteve të kërkimit të shtigjeve përfshirë rastet në nevojë.

Dëshirë e stafit të SHHB “Bereqeti” mbetet të ketë sa më pak raste sociale përfshirë ndihmuar me aktivitete humanitare të bizneseve vendore dhe bashkëkombësve nga mërgata të cilët besimin e tyre ua kanë bartur SHHB “Bereqeti” përfshirë menaxhuar me të mira materiale të cilat janë shpërndarë gjithandje vendit sikurse edhe në malësi të Gjakovës përkatësisht në veriun e Shqipërisë përfshirë edhe qytete shqiptare në Serbi si në Medvegjë.

Numri i anëtarëve ka pasur ngritje rënie, kurse mbështetja me të mira materiale nuk ka munguar gjatë gjithë kohës varësisht nga nevojat e qytetarëve kurse unike mbetet krijimi i shtëpive të reja dhe mjeteve përfshirë trajtim shëndetësor të qytetarëve.

Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti” nuk ka qëndruar duar kryq sidomos te rastet e marginalizuara përfshirë ndihmuar në risocializime sidomos të kategorive të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit, trafikimit me qenie njerëzore dhe kategori tjera, ndërsa bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me shoqata vendore dhe ndërkombëtare të cilat kanë kontribuar përfshirë risocializim të këtyre kategorive shoqërore. Të gjitha këto janë bërë publike gjithnjë duke aplikuar profesionalizmin e personave përgjegjës varësisht projektit i cili është dedikuar dhe prezantuar në

mjedise të ndryshme të vendit. Projektet e SHHB “Bereqeti” janë të vazhdueshme me shoqata të cilat janë ekskluzivisht të themeluara për kategori të caktuara dhe të marginalizuar.

SHHB “Bereqeti” thonë janë të kënaqur me rezultate të punës në bamirësi pa i dhënë vetes vetëkënaqësi dhe mbi të gjitha faktin që nuk kanë asnje refuzim të kërkesave varësisht nga vijnë edhe përkundër që ndoshta nuk mundemi ti përmبushim plotësisht për shkak të numrit dhe artikujve të cilat i kërkojnë por megjithatë duar zbrazur asnje organizatë nuk kthehet nga SHHB “Bereqeti”. Për më shumë ua dërgojnë deri në lokacionet e tyre, ndërsa shoqata, organizata apo grupi përfitues merren me anëtar të tyre.

Ndërsa për objektiv në SHHB “Bereqeti” mbetet nxitja e shpirtit human si brenda dhe jashtë vendi duke mos anashkaluar asnjëherë kontributin e bashkëkombësve në diasporë të cilët në secilën kohë ishin së bashku me qytetar të vendit si para, gjatë dhe pas luftës të cilëve po iu bashkohen humanist dhe biznesmen vendor.

Kurse sa i përket SHHB “Bereqeti” gjithnjë ka qenë transparente dhe bashkëpunuese me media që të sensibilizoj humani tetin krahas ndihmës për familje në nevoje. Kurse vlerësohet përkushtimi i medias e cila bën publike thuaja secilin aktivitet humanitar, ndërsa media ka rol esencial në informim dhe sensibilizim. Megjithatë nuk duhet harruar as edhe mediat sociale të cilat në një apo formë tjetër është bërë burim i informacionit për rastet të cilat janë në nevojë përvëç informacioneve tjera brenda grupit shoqëror, mes shoqatave dhe bashkëpunimit me institucione lokale dhe qendrore të Kosovës nga fusha socio - ekonomike.²⁰⁵

²⁰⁵ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Xheladin Fazliu, Prishtinë, 2021.

Rekapitullim

Në dimensionin ekonomik përfitimi i SHHB “ Bereketi “ është shumë dimensional për faktin që si staf i shoqatës kanë punë primare, ndërsa nga aktivitet humanitare nuk përfitojmë materialisht. Megjithatë i kontribuojmë planifikimit dhe shpërndarjes në suaza të punës vullnetare, kurse përfitues janë familjet nevojtare dhe aktivist të cilët shpërblehen me të mira materiale apo herë pas herë me mëditje për punën të cilën e kryejnë.

Kërkohet ndryshimi në qasje pozitive të mirëqenies të grupit shoqëror të rasteve sociale, ndërsa aktiviteti dhe dinamika e punës së aktivisteve konsiderohet skeleti i veprimit dhe funksionimit të shoqatës krahas donatoreve të cilët ofrojnë rast për të mbështet familjet në nevojë kurse gjithë përfshirja në aktivitete humanitar jo vetëm duke dhuruar bën që SHHB “ Bereketi “ të mos ndjehet i vettuar në asnjë rast përderisa është shoqatë humanitare dhe nuk i përket një grapi apo individi por komunitetit në përgjithësi për të zbutur dhe ndryshuar gjendjen socio - ekonomike në vend.

I vetmi përfitim në SHHB “ Bereketi “ konsiderohet autoriteti i përbashkët human i gjithë qytetarëve në vend dhe jashtë për të ndihmuar qytetarin në nevojë me projekte të vazhdueshme duke përfshirë edhe aktivitete emergjente të cilat janë të nevojshme si veprimtari e cila ka krijuar autoritet si SHHB “ Bereketi “ e cila varësisht nga rrethanat vepron gjatë gjithë vitit.

Këtë e mundëson aktiviteti i pa ndalur i degëve të “ Bereketit “ në tërë vendin, ndërsa si raste specifike janë hapja e kuzhinave humanitare, marketi humanitar, sofa e Ramazanit, kurbanet, dhurata për festa, iftare si dhe stufa dhe dru për ngrohje. Kurse sa i përket aksioneve emergjente aktivitet e shoqatës janë të njoitura si për dëme nga tërmeti, vërsimet dhe dëmet nga zjarri. Pa mos i anashkaluar ndihmat e rregullta gjatë gjithë vitit më qëllim të përmbushjes së nevojave për familje nevojtare me artikuj ushqimor, veshmbathje, pako higjenike etj.

5.1.1.13. Rasti studimor 13

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Gjilan

Krijimi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan është bërë për shkak të kursimit të buxhetit në nivelin komunal duke kursyer administratën. Në këtë rast janë fuzionuar në një drejtori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Në dy apo tri komuna tjera të Kosovës ekziston drejtoria e veçantë për mirëqenie sociale dhe drejtoria për shëndetësi. Qëllimi i krijimit të drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale është ofrimi i shërbimeve shtesë të mirëqenies sociale nga ana e buxhetit komunal. Të gjitha shërbimet sociale mbulohen nga ana e ministrisë në veçanti pas decentralizimit të shërbimeve sociale nga viti 2010 kur një pjesë e shërbimeve sociale kalojnë në kompetencë të Komunës.

Trajtohen familjet pa strehë, raste të rënda shëndetësore të cilat për shkak të buxhetit të varfér familjar nuk kanë mundësi ti mbulojnë shërbimet me barna dhe shërimi ndihmohet në raste të veçanta. Ndihmohen familjet me pako ushqimore dhe higjenike, lëndë djegëse (dru për ngrohje), veshmbathje kurse në raste të caktuara përmes donatorëve ofrohen mjete ndihmëse (proteza) për lëvizje për persona me aftësi të kufizuar. Objektiv mbetet ngritja e mirëqenies dhe shëndetit dhe përmirësimi i kushteve të jetës dhe ofrimi i shërbimeve përmes sistemit të patronazhit (vizitave familjare) dhe banimit social.

Angazhimi i personelit fokusohet kryesisht në ofrimin e shërbimeve profesionale këshilluese dhe ndërmjetësim në raste të problemeve në familje. Kurse në sferën e shëndetësisë kemi numër të konsiderueshëm të stafit profesional, ndërsa ndihet nevoja për eksperte në lëmin sociale. Fenomeni i dhunës në familje, rastet e trafikimit me qenie njerëzore, përdoruesit e substancave narkotike dhe sjellja asociale nxjerrin në pah vështirësitë me të cilat ballafaqohet organi i kujdestarisë në kudër të QPS-ës, ndërsa në sferën e shëndetësisë ka nevojë për përmirësim të infrastrukturës përcjellëse si: Laboratorë vetura, ambulatore dhe staf profesional për vizita në familje për persona me gjendje më të rëndë shëndetësore dhe lëvizje të kufizuar.

Shifrat e rasteve janë varësisht situatës së përgjithshme ekonomike në vend, kurse pandemia është sfiduesja më e madhe që i ka rritur nevojat për shërbimeve sociale si në aspektin ekonomik edhe shëndetësor si rezultat i mbylljes së ndodhur.

Risocializimi përmes punës në praktikë sociale bën që të kërkojmë ndryshimin e dëshiruar e në raste të veçanta duke marrë para së shumë edhe kapacitet ekzistuese që posedojnë shërbimet sociale dhe bashkëpunimi me qytetarë të vullnetit të mirë të cilët në forma të ndryshme po i kontribuojnë të mirës së përgjithshme për qytetar me gjendje jo të mirë socio - ekonomike.

Ndërsa puna e shërbimeve sociale bazohet në asistencë dhe shërbime sociale duke i adresuar kërkesat te vartësit qoftë për asistencë apo probleme familjare dhe për këtë obligohen të raportojnë me qëllim të krahasimit të rezultateve të arritura për periudha ta caktuara kohore dhe krahasim të suksesit të synuar.

Bazuar në kapacitet e DSHMS-ës në Gjilan është arritur planifikimi, kurse në raste të caktuara janë tejkaluar parashikimet, ndërsa vetëkënaqësia nuk ka vend edhe përkundër rezultateve të arritura përballë kërkesave të qytetarëve. Objektiv esencial i shërbimeve sociale është që sa më pak të jenë të shpërfaqura fenomenet negative si: Dhuna, trafikimi, prostitucioni narkomania etj.

Niveli i bashkëpunimit i institucioneve lokale dhe qendrore është i nevojshëm për përmirësim të shërbimeve sociale kurse për arritjen e rezultateve sa më të mira në këtë drejtim roli i mediave është thelbësor ngase i zgjon nga gjumi dhe njall punën në institucionet lokale dhe qendrore për të marrë veprime të duhura në raport me dukuri të caktuara.

Përmes emisioneve të përgatitura në media dhe kronikave në edicione informative është synuar ndryshimi socio - ekonomik sikundër që nuk ka munguar as reflektimi institucional por edhe i bamirësve të cilët përmes gala mbrëmjeve humanitare e kanë dëshmuar veten pa dallim ku jetojnë e punojnë si në mërgim apo vendlindje. Andaj rolin e medias e konsiderojmë si një dritare e cila e ndriçon dhe ajros situatën socio - ekonomike në vend.²⁰⁶

²⁰⁶ Intervistë e realizuar për hulumtim empirik të rastit studimor me z. Mursel Zymberi, drejtor i DSHMS Gjilan, Maj 2022.

Rekapitullim:

Asnjë nga rastet e rënda socio - ekonomike në Komunën e Gjilanit nuk janë mbështetur pa iu ofruar mundësi punësimi së pari meqë për këtë na janë ofruar mundësitetë përmes bashkëpunimit me biznese vendore të cilët kanë shfaq gatishmëri të bashkëpunimit me DSHMS-ë në mënyrë që të zbutet situata socio - ekonomike. Raste të evidentuara të punësimit janë 300 deri 400 ku janë orientuar dhe punësuar ata të cilët kishin mundësi të punojnë dhe të krijojnë të hyra pa pasur nevojë të jenë pjesë e skemave sociale. Pra synimi jonë mbetet largimi nga skemat sociale i sa më shumë rasteve falë punësimit të tyre tek bizneset vendore. Përveç sferës ekonomike të përmirësimit edhe aspekti social ka ndryshuar pozitivisht falë bashkëpunimit me qendra rinore, institucionale dhe shoqata si dhe me kontributin e mërgatës të cilët sjellin përvoja të ndryshme nga vendet ku jetojnë e punojnë.

Kurse përtej shërbimeve sociale, Gjilani si regjion dallohet me donacione në bamirësi, ndërsa është ngritur edhe fshati i lumtur, organizimi i gala mbrëmjeve humanitare shpërndarja e mjeteve mbështetëse për persona me aftësi të kufizuara (PAK) sikurse edhe grumbullimi i mjeteve për trajtim shëndetësor të personave jashtë vendi. Aseti, mërgatë dhe bashkëpunimi me biznese vendore konsiderohen krah i djathë i institucioneve për mirëqenie të qytetarëve, ndërsa media shpesh herë shërben si katalizator për kontribut të shtuar humanitar në vend.

5.1.1.14. Rasti studimor 14

OJQ “Rrjeti i Grave të Kosovës”, Prishtinë.

Ka filluar në vitin 2000 ndërsa regjistrimi është realizuar më 2003. Kemi filluar si OJQ “Motrat 28 Qiriazi” ndërsa i gjithë qëllimi ynë ka qenë të përkushtohemi për të drejtat e njeriut, avokim dhe të drejtat e grave që ndërlidhet me të drejtat e njeriut veçanërisht për barazinë gjinore të cenuar thuaja në se cilën pore të jetës.

Andaj si subjekt e jo si zë individual kemi synuar të fuqizojmë kërkesat tona duke besuar se më lehtë do ti avancojmë si grup shoqëror. Andaj anëtarësimi na bënte më të vendosur si OJQ-ë e cila përkushtohet për misionin e sajë për barazi gjinore.

Me krijimin e rrethanave te reja të pasluftës së fundit 1998/99 qartë dukej që bota femërore ishte larguar thuaja tërësisht ngajeta politike dhe aktiviteti shoqëror në vend. Identikuam problemin e mbështetjes jo vetëm nga vendorët por edhe aq me keq edhe nga ndërkombëtarët. Me një fjalë mungonte përkrahja.

E kërkuam ndryshimin në mënyrë që gratë dhe vajzat mos të jenë objekt, por subjekt i kontributit kurse kërkesat për të avancuar i kemi iniciuar vetë për përkrahje të barazisë gjinore e cila ishte në stad të pavolitshëm në vend dhe kishte diskriminim.

Donatoret e huaj që vinin aplikuan një metodologji të punës duke mbështetur organizata jo qeveritare për organizime të ndryshme pa u interesuar mjaftueshmë për projektet konkrete dhe realizimin e tyre, për këtë lindi ideja që të krijohet një rrjet i organizuar me qëllim të synimit të përbashkët për të avokuar për të drejtat e femrave në të gjitha poret e jetës në mënyrë që ato mos të mbeten vetëm si subjekt i shoqërisë.

Me regjistrimin në vitin 2003 si OJQ “Rrjeti i grave të Kosovës” mund të thuhet se nisi e mbara ndërsa brenda rrjetit organizativ ishin 36 organizata të cilat kishin objektiv dhe synim mbrojtjen e të drejtave të grave, ndërsa sot pa modesti mund të themi që falë përkushtimit serioz dhe gatishmërisë për të avokuar dhe pa reshtur kërkuar barazinë gjinore janë 180 organizata të grave nga i gjithë vendi gjë që nënkupton që rrjeti i grave kosovare ka shtrirje në tërë vendin.

Të nënvizojmë se paslufta krijoj mundësi për krijim të shumë organizatave dhe e gjithë kjo kishte një qëllim i cili për hir të transparencës ishte për shkak i mbështetjes materiale për organizata. Ndërsa me ndërprerjen graduale të donacioneve njëherësh shuheshin edhe organizatat.

Megjithatë përkushtimi për ndryshim pozitiv nuk është venit dhe nuk kanë munguar as programet të cilat qëllimi primar kishin ndalimin e dhunës në baza gjinore dhe për këtë kemi ngrit zërin për të edukuar institucionet që të jenë më të vendosura për parandalim sesa të merren me pasojën.

Sot ka ende ka dhunë edhe përkundër institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë, ndërsa avokimi fatkeqësish ka nevojë edhe më tej të organizohet për ngritjen e vetë dijës institucionale për të vepruar në mënyrë që të parandalohen keqbërësit dhe kryesit të krimit në shoqëri.

Fillimisht mund të thuhet se në Kosovën e pasluftës kishte tema tabu sidomos për dhunën ndaj botës femërore e që gradualisht ndërroi vetëdija dhe filloi ndryshimi i kërkuar për personat e sprovuar me të vetmin qëllim që keqbërësit të marrin dënimin meritor, ndërsa të kuptohet që drejtësia duhet të veproj në mbrojtje dhe mbështetje të personave të cilët pësuan nga dhuna. Njëherësh dëshmuani që institucionet e shtetit të Kosovës të funksionojnë për ti liruar së pari nga dhuna e dy fishtë personat të cilët ishin të ndrydhur ndër vite për dhunën e ushtruar gjatë luftës mbi ta e që duhej heshtur për hirë të nderit dhe familjes.

Megjithatë thyerja e heshtjes bëri që shoqëria kosovare të jetë më e avancuar ndërsa i kontribuon parandalimit të problemeve shoqërore nga të cilat pësimi është i shumëfishtë. Pa modesti duhet thënë se deri tani arritjet janë të mëdha por nuk ka vend për vetë kënaqësi dhe si rrjet i grave Kosovare krijojnë strategji të cilat i zbatojnë në praktikë me programe të ndryshme të cilat kanë të bëjnë kryesish për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të femrave në Kosovë.⁵⁵

Kurse për përbushjen e programeve brenda strategjive nuk mungojnë mbështetjet financiare të dedikuara për rrjetin e grave kosovare në gjithë territorin e vendit, kur themi në gjithë territorin e vendit mendojmë më tepër për viset rurale dhe qyteza apo në periferi meqë të organizosh projekt në kryeqytet pa dilemë është më lehtë. Ndërsa nëse nuk do të kishte fonde vështirë do të funksiononim edhe si zyra e lere për të organizuar programe përmes projekteve të ndryshme.

Pa fonde ka qene vështirë të zbatohet strategjia dhe nuk do të mund të luanim rolin e rrjetit dhe do të mbeteshim vetëm si zyrë, ndërsa duke pasur fondin kemi mundësi të zhvillimit të aktiviteteve të rrjetit të grave kosovare.

Fondin e mundëson faktori ndërkombetar (donatorët) ndërsa është nis me një fond të vogël nga një organizatë e grave të Suedisë, më pas këtij foni iu janë bashkuar fonde nga qeveria Austriake dhe zyra e BE-ë për zhvillim.

Ndërsa qeveria e Kosovës kanë ndarë mjete sidomos gjatë pandemisë për OJQ-ë që janë në rrjet. E konsiderojmë si hap të mirë dhe të rëndësishëm përderisa kemi edhe një agjenci përbrenda qeverisë së Kosovës për barazinë gjinore.

Gjitha këto të arritura dhe synime që i kemi në plan përmes programeve të përgatitura në mënyrë autonome nuk do të ishin publike sikur nuk do të kishim transparencë dhe bashkëpunim të shkëlqyeshëm me media të cilat secilin aktivitet të OJQ “Rrjeti i grave të Kosovës” e përcjellin pa hezitim kurdo që i thërrasim. Mund të them se jemi krenar që mediat e shtetit tonë janë zë i fuqishëm, ato i përcjellin aktivitet e rrjetit të grave. Me një fjalë mediat janë shembull i përgjigjes në raport me rrjetin e grave në vendin tonë.²⁰⁷

Rekapitullim

Fillimi i punës si rrjet tri vitet e para ka qene me vetë financim ndërsa me kohën dhe seriozitetin në punë krijohen edhe mbështetjet e para ndërsa ne e dëshmuam që mundemi dhe dimë të krijojmë bazament për solidaritet mes subjekteve të rrjetit të grave kosovare. Ndihmat e donatorëve mundësuan krijim të ambientit të punës dhe gjithë afirmimi është arritur me transparencë e cila ka sjellë sukses në anëtarësi të rrjetit të grave kurse shtyllat esenciale të planeve dhe programeve të mbështetura nga burimet financiare kanë ndikuar edhe më shumë në organizime të radhës në të gjitha sferat përfshirë edhe aktivitetin politik dhe kulturor.

Në vitet e 90-ta ishin aktiv burra dhe gra meqë Kosova ishte në okupim ndërsa qëllim kishim lirinë, kurse pas luftës sikur gratë u pasivizuan dhe duhej marrë veprime për avokim, sensibilizim dhe hapje të dyerve për të parë dhe plotësuar në përgjithësi aktivitet shoqërore edhe me kontributin e gjinisë femërore.

²⁰⁷ Intervistë e realizuar me z. Igballe Rogova, Prishtinë, 2022.

Barazia gjinore është vetë ndryshimi dhe ka vetëdijesuar edhe meshkujt për këtë dhe për çdo ditë e më shumë janë më të zëshëm dhe më mbështetës në projekte të rrjetit të grave. Për arritje të suksesit dhe qëllimit të përbashkët për barazi gjinore duhet të funksionoj formula e bashkëpunimit institucionale ndërkontinentale, ato vendore dhe komuniteti. Kështu arrihen rezultate drejt ndryshimit socio - ekonomik dhe të qenit i barabartë në shoqëri. Kjo dëshmohet me qëndrimin që jemi zëri unik si rrjeti grave Kosovare përfaktin që kemi shumë organizata brenda rrjetit dhe jemi model në rajon e më gjerë ndërsa përbazë arritjes së suksesit në punë kemi solidaritetin mes organizatave, ndërsa me bashkëveprim mund ta ndryshojmë fenomenin e caktuar në rrethana kohe për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.

Rrjeti i grave Kosovare e konsiderojnë veten referencë përvendet e rajonit meqë funksionimi është autentik me projekte të vetë përgatitura të pa importuara dhe kjo e bën "OJQ" Rrjetin e grave Kosovare "të besueshëm falë veprimit korrekt, autentik dhe të përkushtuar drejt mbështetjes së të drejtave të njeriut e posaçërisht të drejtave të grave, kurse programet shtylla të aktivitetit të "Rrjetit të Grave Kosovare" janë:

26

Fuqizimi ekonomik i grave,

Fuqizimi lëvizjes feministë në Kosovë,

Gratë në politikë dhe vendimmarrje,

Jeta pa dhunë me bazë gjinore,

Përmirësimi i qasjes në edukimin cilësor dhe të ndjeshëm gjinor dhe

Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor.

Analiza e të dhënave nga hulumtimi empirik

Përzgjedhja përfokus kishte përfaqësimin e formave të ndryshme organizative dhe fushave të ndryshme të veprimit për organizimin social dhe synimin për ndryshim. Në kohën e hulumtimit empirik secila nga organizata kishin bazë organizative me tendencë të ndryshimit në të mirën e përgjithshme të komuniteteve në përgjithësi dhe në veçanti të komunitetit të cilin përfaqësojnë si në mjeshter lokal ku funksionojnë po ashtu edhe në atë regional në nivel vendi dhe kontributi i bashkëkombësve përmes organizimit të tyre në mjeshter ku jetojnë dhe punojnë sikurse shoqata “Kushaveci “ nga Zvicra e që fiksim ka investimin në fushën e mbështetjes socio - ekonomike në vendlindjen e tyre në Kosovë ku pjesa dërmuese e anëtarëve janë nga Kosova, megjithatë në aktivitet e kësaj shoqate nuk ndahen duke kontribuar edhe bashkëkombës nga vende të ndryshme ndërsa jetojnë dhe punojnë në kurbet së bashku.

Një analogji kanë edhe dy shoqatat tjera njëra nga Badeni i Austrisë “ 17 Shkurti “ dhe shoqata “ Miqësia Franko - Shqiptare “ nga Franca të cilat për synim kanë përkushtimin të jenë të vendosur me aktivitete të ndryshme shumë dimensione dhe kulturore në trojet etnike dhe njëherësh edhe të kontribuojnë në aktivitetë të integrimit në vendet e tyre në mërgim ku zhvillojnë jetën e tyre.

Ndonëse me një objektiv të përbashkët përfshirë të mbështetë kategoritë e ndryshme sociale shoqatat humanitare bamirëse “ Qatar Qarity “, “ Nënë Tereza “ dhe “ Bereqeti ” dimensionin e ngritisë ekonomike përfshirë familjet nevojtare e kishin primar krahës atij social.

Familjet me bonjak, ato me gjendje më të rëndë ekonomike ishin objektiv i cili përgjatë dekadave të përkushtimit kanë kontribuar në ndryshimin e situatës së tyre socio - ekonomike. Aktivitet humanitare ishin të ndryshme nga mirëqenia deri te vetëdijesimi përfshirë problematika shoqërore dhe shëndetësore.

Bashkëpunimi mes shoqatave dhe shkëmbimi i informacioneve nuk ka munguar ndërsa interesimi i tyre përfshirë të koordinuar dhe bashkëvepruar me institucione përkatëse komunale dhe të nivelit qendror të mirëqenies është shembulli më i mirë që familjet nevojtare të jenë përfshirë nga projekte të ndryshme si individuale, familjare dhe komunitare në fusha të ndryshme të jetës.

Përveç bashkëpunimit mes vete dhe me institucione mbështetja ndërkombëtare edhe në sektorin humanitar është pjesë e pandashme në aktivitet humanitare të shoqatave “ Nënë Tereza ” dhe “ Bereqeti ”.

Në vazhdën e këtyre bashkëpunimeve mes subjekteve humanitare kur fokusohemi te “ Forumi i Aftësisë së Kufizuar ” në vend si rast studimi sikurse edhe te klubi “ Dëshira ” dhe “ Organizata e Pensionistëve ” këto subjekte organizative përveç mbështetjes materiale në projektet e tyre kanë lobimin dhe avokimin për të drejtat dhe aplikimin e ligjit për anëtar të kategorive të tyre për të cilët janë më të zëshëm në mënyrë që mirëqenia institucionale të jetë kushti primar për sigurimin e të hyrave (mjeteve) të rregullta dhe përfitimin e benefiteve të përhershme duke u bazuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës duke i konsideruar ndihmat e herë pas hershme të dobishme për mirëqenien e tyre dhe mbi të gjitha mos u anashkaluar dhe mbetur barrë e familjes si pensionistët po ashtu edhe kategoritë e aftësisë së kufizuar në Kosovë.

“ Rrjeti i grave Kosovare ”, “ Lidhja e Viktimave Civile dhe të Zhdukurve të Kosovës ” dhe “ Shoqata m Multietnike ” si grupe organizative janë organizata të zëshme të cilat specifikohen me objektivat e tyre dhe angazhimin që të kontribuojnë maksimalisht për shtimin e përfitimeve për anëtarët e tyre.

Kështu nga zyrtare të rrjetit të grave Kosovare objektiv sipas tyre është barazia gjinore dhe për këtë në organizatat e tyre të integruara nën një ombrellë atë të rrjetit të grave Kosovare ngritja e zërit për të drejtat grave ka bërë që në të gjitha format e mundshme si përmes tryezave bashkëpunimeve me organizata ndërkombëtare, institucione vendore dhe po ashtu edhe organizata lokale të kontribuojnë që gratë Kosovare të janë të barabarta ligjërisht dhe njëherësh të ketë edhe kuota gjinore në të gjitha fushat e zhvillimit të jetës institucionale.

Përfaqësimi në institucione i kontribuon mirëqenies dhe sigurisë së gruas në Kosovë, ndërsa ngritja e zërit kundër dhunës në familje dhe diskriminimi në punë publike apo private sa i përket gruas Kosovare është problem i cili do zgjidhje të shpejtë me qëllim të parandalimit dhe krijimit të klimës së sigurisë për gratë Kosovare.

Në jetën politike ka vend për përmirësim të gjendjes së gruas në shoqërinë Kosovare ndërsa pozitat udhëheqëse të femrave gradualisht janë duke u shtuar.

Një rol analog për lobim dhe kërkim të kushteve për anëtar dhe familjar të viktimate civile dhe të zhdukurve është i pa ndalur nga lidhja përkatëse gjithnjë duke bashkërenduar aktivitet me institucionale vendore por edhe bashkëpunuar me ndërkombëtarë për mirëqenje të familjeve të viktimate, të sprovuarve nga dhuna shumë dimensionale e luftës së fundit në Kosovë sikurse edhe për të mbështetur të mbijetuarit e dhunës.

Gjithashtu multietniciteti i shoqërisë Kosovare kërkon hapësirë më të madhe në institucionë herë duke e aplikuar edhe si bonus shtesë për përfitime të mundshme materiale, pozita në vendim marrje dhe mirëqenien si diçka të arsyeshme. Megjithatë komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE) në disa raste e konsideron mundësi për avancim të komuniteteve edhe për kundër përkushtimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës për t'iu ofruar kushte normale deri te diskriminimi pozitiv. Shkollimin nuk e konsiderojnë domosdoshmëri për edukim dhe specializim ndërsa punësimin e konsiderojnë të nevojshëm përkrah interesimit të shtuar për mbështetje sociale.

Për aspektin e ngritjes socio - ekonomike të shoqërisë Kosovare bashkëpunimi i odave ekonomike dhe debati për gjetje të mundësive për krijimin e kushteve për investime dhe përmes investimeve të krijuhen kushte për punësim dhe zhvillim njëra nga Odat është ajo Gjermano - Kosovare e cila në agjenten e saj objektiv kishte sjelljen e investorëve Gjerman dhe biznesmen Kosovar nga mërgimi që të hapin mundësi punësimi në një treg ku Kosova konsiderohet si treg i lirë i fuqisë punëtore dhe resurse njerëzore të cilat dita - ditës janë më pak për shkak të lëvizjes së tyre drejt vendeve perëndimore, kryesisht për kushte më të mira për punë dhe jetë.

Bashkëpunimi asnjëherë nuk konsiderohet që është i pa arritur nga përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore. Kjo argumentohet për faktin që Drejtoria e mirëqenies dhe shëndetësisë në Gjilan me zyrtarët e saj duke aplikuar bashkëpunim me biznese kanë arritur që ti nxjerrin nga skemat sociale numër të konsideruar të qytetarëve të Komunës së Gjilanit të cilët kishin aplikuar për mbështetje sociale duke ju ofruar punë tek sektori privat.

Ndërsa në secilën formë të mundshme përveç mbështetjes ligjore me ndihma sociale bashkëpunimi me humanistë dhe shoqata si vendore, ndërkombëtare dhe bashkëkombës i kontribuojnë mirëqenies së rasteve në nevojë duke ua ngrit edhe kushtet për banim si në aspektin individual për familjet nevojtare po ashtu edhe për banimin kolektiv.

Në këtë pikëpamje përveç aspektit socio - ekonomik edhe ai shëndetësore është i trajtuar në drejtorinë përkatëse në Gjilan si rast i studimit të veçantë.

Te secili rast i studimit është konstatuar se ndryshimi socio - ekonomik nuk vjen vetveti. Për tu arrit nevojitet bashkërendimi institucional nga nivelet lokale deri te ato qendrore dhe krijimi i urave të miqësisë me shoqata humanitare brenda dhe jashtë Kosovës, ndërsa kontributi i medias për të ndikuar në ndryshimin e kërkuar është esencial sipas deklarimit të subjekteve hulumtuese të cilët e konsiderojnë median si një shtytës drejt progresit të synuar e që ka rol dominues për faktin që i kontribuon nxitjes së veprimit të duhur për ndryshimin e kërkuar nga shoqëria dhe përbushjen e kërkeseve sipas rregullit, të gjithë të barabartë para ligjit.

Megjithatë vështirësitet përfunksionim vërehen te secili subjekt ku më pak e ku më shumë për shkak të situatës socio - ekonomike dhe situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, kriza globale energjetike dhe ndërhyrja ushtarake e Rusisë në Ukrainë të përcjellë me inflacion i cili ka ndikuar në rënien e standardit të qytetarëve.

Në raste të veçanta ka burime të hyrave më të mëdha sidomos në prag të festave ndërkombëtare, kombëtare, shtetërore dhe fetare, kurse bashkëpunimi mes organizatave ekziston. Ndërsa të gjitha organizatat bashkëpunimin me mediat e kanë thuaja alfa dhe omega të suksesit krahas bashkëpunimit me subjektet donatore me qëllim të prezantimit të aktivitetit dhe përmes kësaj synojnë ndryshimin e situatës socio - ekonomike në Kosovë.

Lidhur me qëndrimet e subjekteve sa i përket aspektit socio - ekonomik dhe medias në pyetësorin e mëposhtëm subjektet e rasteve studimore janë përgjigjur në pyetjet e strukturaura dhe kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me ndikimin e medias në ndryshimin socio - ekonomik në Republikën e Kosovës.

Në grafiket e mëposhtëm prezantohen përgjigjet e subjekteve të rasteve të studimit për pyetjet veç e veç për të ardhur deri te rezultati shprehur në përqindje.




Figura 2.Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin institucional me institucionet shtetërore?

Në pyetjen sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin me institucionet shtetërore ? Subjektet nga rastet e studimit ndajnë qëndrimin e tyre lidhur me pritet e kënaqësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë mes institucioneve shtetërore dhe subjekteve të qytetarëve të intervistuar kryesisht të kategorive të sfiduara. Subjektet në rastet studimore në pyetjen se sa janë të kënaqur me institucionet shtetërore deklarohen se raportet në mes tyre si subjekte dhe institucioneve nxjerrin në pah qëndrimin e tyre se pjesa dërmuese e subjekteve janë deri diku të kënaqur 43% në raport me 36% me deklarim se janë të kënaqur me shërbimet dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore.

Dallimi në mes i të qenit shumë i kënaqur dhe nuk jemi të kënaqur është 79% mes këtyre dy qëndrimeve shprehur në përqindje nga 14% dhe 7%. Të cilët shprehin bindjet e tyre se me një dallim 100% mes të qenit shumë të kënaqur dhe atyre që deklarohen të pa kënaqur. Ndërsa mes të qenit i kënaqur dhe deri diku i kënaqur që rezulton 43% përkatësisht 36% dhe shumë të kënaqur dhe të pakënaqur ka dallim mes shifrave shprehur në përqindje 14% gjegjësisht 7%. Nga të dhënat e fituara përmes përgjigjeve në pyetësor del se përfaqësues të subjekteve të ndryshme të cilat angazhohen për mirëqenien e kategorive të ndryshme shoqërore për ngritje socio - ekonomike janë të kënaqur pjesërisht me bashkëveprimin dhe bashkëpunimin me institucionet e vendit.




Figura 3.Sa jeni të kënaqur me bashkëpunimin me mediumet ?

Të dhënat e fituara përmes pyetësorit më përfaqësuesit e subjekteve (rasteve të studimit) në të cilat ngërthejnë kategori të ndryshme shoqërore prej asociacioneve të aftësisë së kufizuar e deri te odat ekonomike dhe drejtoreve komunale për mirëqenie dhe shëndetësi rezultatet e fituara janë inkurajuese bazuar në faktin që 53% të subjekteve thonë se janë të kënaqur me bashkëpunimin me media, të pasuar me 27% prej tyre të cilët deklarohen se deri diku janë të kënaqur me punën e medias dhe bashkëpunimin bilateral subjekte – media, kurse 20% deklarohen se janë shumë të kënaqur me punën me mediave.

Të dhënat e fituara përmes pyetësorit të strukturuar nxjerrin të rëndësishëm kontributin e medias në ndikimin e medias për ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë bazuar në bashkëpunim për të mirën e përgjithshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit të cilat janë të anëtarësuar në subjekte të caktuara sikurse te rastet e studimit të trajtuar.




Figura 4.Sipas jush a keni vërejtur ndryshim nga sferat e bashkëpunimit me mediumet ?

Se a kanë vërejtur ndryshim në punën e tyre dhe synimet e këruara duke bashkëpunuar me media, subjektet e hulumtuara si raste studimi sjellin informacionet shprehur në përqindje 64% nga ata thonë se janë të kënaqur, të pasuar me 7% shumë të kënaqur dhe 29% deri diku të kënaqur. Të dhënat e fituara nga përgjigjet jepin dëshmi që përfaqësues të subjekteve shpresën, besimin dhe ndikimin e medias e konsiderojnë të rëndësishme për të ndikuar në një apo formë tjeter për të mirën e përgjithshme dhe ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë. Të dhënat argumentohen edhe në aspektin praktik duke u bazuar në kërkjesat e pothuaj të secilit subjekt që secilin aktivitet të tyre e synojnë ta bëjnë publik dhe të jenë sa më afër anëtarësisë së tyre dhe institucioneve me të cilët kërkojnë bashkëpunim dhe mbështetje të përmbrushjeve të ambicieve të tyre.




Figura 5. Sipas jush a ndikojnë mediat në ndryshim socio - ekonomik ?

Në pyetjen a ndikojnë mediat në ndryshimin socio - ekonomik subjektet e hulumtuara në përgjigjet e tyre e nxjerrin median si të rëndësishme për të ndikuar në procesin e ndryshimit socio - ekonomik. Ata sikur e thonë edhe qëndrimin e tyre se cili do qoftë aktivitet nëse nuk ka qenë i përcjellë nga media ka kaluar në heshtje apo fare pak i prezantuar për shkak se vetëm pjesëmarrësit në aktivitet nuk mund të kontribuojnë mjaftueshmë për sensibilizim të problemit apo të çështjes së caktuar. Qëndrimin e tyre të kënaqur lidhur me pyetjen a ndikojnë mediat në ndryshimin socio - ekonomik e dëshmojnë 72% nga të intervistuarit të pasuar me 21 % të cilët deklarojnë se janë të kënaqur deri diku dhe 7% deklarojnë se janë shumë të kënaqur me bindjen e tyre se mediat mund të ndikojnë në ndryshimin socio – ekonomik.




Figura 6. Sipas jush a ndikojnë mediat në përafrimin e bashkëpunimit mes jush dhe institucioneve shtetërore ?

Përgjigja deri të kënaqur shprehur në përqindje me 43% dhe të kënaqur po ashtu 43% subjektet e intervistuara përmes pyetësorit sikur na sjellin në një pozitë që bashkëpunimi duhet i domosdoshëm i fuqishëm dhe i vazhdueshëm mes organizataave dhe medias në mënyrë që porosia të arrijnë deri tek institucionet pa dallim lokale apo qendrore. Ndërsa qëndrimin e tyre prej 14% për mos kënaqësi dhe mohim se mediat mund të kontribuojnë për arritjen e bashkëpunimit mes subjekte dhe institucioneve të vendit pa dallim. Andaj lidhur me këtë qëndrim të argumentuar me qëndrim të përfaqësuesve të subjekteve përmes shifrave konkrete vijmë në përfundim që ndikimi në ndryshimin socio - ekonomik dhe bashkëpunimi mes subjekteve te intervistuara dhe institucioneve shënon përafrim falë kontributit të medias e cila me veprime dhe rol të katalizatorit ndikon në përafrimin mes institucioneve dhe subjekteve të analizuara në hulumtim.




Figura 7. Sipas jush sa janë të pranishme në media aktivitetet e organizatës suaj ?

Lidhur me pranin në media të aktiviteteve të subjekteve gjithashtu janë gjetur të dhënrat shprehur në përqindje me nga 43% në mes atyre të cilët janë deklaruar të kënaqur dhe deri diku të kënaqur dhe po ashtu atyre të cilët thonë se janë shumë të kënaqur ose fare të kënaqure të cilët shprehen në përqindje me nga 7%. Bazuar në përgjigjet paraprake rezultatet janë analoge dhe këtu mund të vihet në përfundim që mediat kryesisht shumicën e aktiviteteve të subjekteve të ndryshme të cilat ishin raste e studimi i përcjellin aktivitet e tyre në përgjithësi. Kështu mund të vijmë në përfundim se mediat duke prezantuar aktivitet e subjekteve të ndryshme shoqërore në mënyrë indirekte ndikojnë në ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë.




Figura 8. Sipas jush a ndikojnë mediat sociale në medien publike dhe komerciale për sensibilizimin e problemeve me të cilat merreni ?

Lidhur me pyetjen a ndikojnë mediat sociale në median publike dhe komerciale për sensibilizimin e problemeve me të cilat merreni ? Subjektet e organizatave të hulumtuara të cilat i janë përgjigjur pyetësorit konsiderojnë që mediat sociale ndikojnë në media publike dhe komerciale duke i bërë publike rastet e ndryshme për ndikimin në ndryshimin socio - ekonomik në Kosovë. Për këtë shprehur në shifra subjektet janë të kënaqura 57% në raport me deri diku të kënaqur me 36% ndërsa 7% mendojnë se mediat sociale nuk ndikojnë në media për sensibilizim të problemeve me të cilën merren ata. Në përgjithësi subjektet e rasteve të studimit e vlerësojnë kontributin e medias sociale në të cilën edhe vetë anëtaret e këtyre subjekteve janë aktiv në media sociale duke përcjellë dhe kontribuar në ndarjen e informatave.




Figura 9. A është media urë lidhëse mes subjektit tuaj dhe donatorëve (afaristë dhe persona fizik) ?

Lidhur me pyetjen a kanë ndikim mediat mes subjekteve dhe donatorëve, subjektet hulumtuese përmes përgjigjeve qartësojnë se 43% prej tyre thonë se mediat nuk kanë ndikim në krijimin e urave lidhëse mes tyre dhe donatorëve të ndryshëm fizik apo juridik apo bë mirës. Ndërsa 36% nga ata thonë se janë deri diku të kënaqur me rolin e medias për të krijuar urë lidhëse mes subjekteve dhe donatorëve, kurse të kënaqur shprehen 14%, ndërsa 7% të subjekteve thonë se janë shumë të kënaqur bazuar në pyetjen se a është media urë lidhëse mes subjektit dhe donatorëve.




Figura 10. A është media urë lidhëse mes subjektit tuaj dhe donatorëve (organizatat e huaja dhe të vendit) ?

Në pyetjen analoge se a mund të jetë media urë lidhëse mes subjektit dhe organizatave ndërkombëtare dhe atyre të vendit pjesa dërmuese e subjekteve kanë qëndrim se mediat nuk kanë ndikim për të krijuar urë lidhëse mes tyre dhe organizatave ndërkombëtare shprehur në përqindje 50%, ndërsa 43% mendojnë se deri diku janë të kënaqur me median që mund të kontribuoj si urë lidhëse mes donatorëve dhe subjekteve, ndërsa lidhur me këtë pyetje 7% thonë se janë shumë të kënaqur me median e cila mund të jetë urë lidhëse mes tyre dhe organizatave donatore të huaja apo ndërkombëtare.




Figura 11. Sa ndikon media në sensibilizimin e opinionit për problemet socio - ekonomike në Kosovë ?

Pyetjes se sa ndikojnë mediat në sensibilizimin e opinionit për probleme socio - ekonomike subjektet hulumtuese kanë qëndrim të matur lidhur rrith kësaj çështje të rëndësishme e cila ndërlidhet me temën e disertacionit e që shprehur në përqindje 43% thonë se deri diku janë të kënaqur karshi 29% shprehen se janë të kënaqur dhe 28% shprehen se janë shumë të kënaqur.




Figura 12. A mendoni se mediat mund të kontribuojnë edhe më shumë në çështjet socio-ekonomike në Kosovë ?

Edhe përkundër përgjigjeve paraprake për kontributin e mediave në ndikimin për ndryshimin socio - ekonomik me qëndrime të qarta megjithatë në pyetjen se a mund të kontribuojnë më shumë mediat në këtë drejtim subjektet e hulumtuara si raste studimi përmes pyetësorit me një përqindje të lartë mendojnë se mediat mund të bëjnë edhe më shumë për ndikimin në ndryshim socio - ekonomik me një përqindje prej 86%, ndërsa 14% nga ato mendojnë se deri diku mediat mund të ndikojnë në ndryshim socio - ekonomik.

